



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë
“Bachelor në Kontabilitet”
Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. As. Dr. Brikena Gjoni Leka

Dr. Valbona Kapllani

Valbona Kapllani
17.04.20

Prill, 2020

TË DHËNA TË PËRGGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT “BACHELOR NË “KONTABILITET”” NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë (UV), e ushtron aktivitetin bazuar në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Ai synon [cit] të ketë ndikim transformues në shoqëri, përmes inovacionit të vazhdueshëm, hulumtimit dhe pjesmarrjes aktive në zhvillimin social dhe ekonomik të vendit.

Programi i studimit Bachelor në Kontabilitet ofrohet nga Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit, i Fakulteti i Ekonomisë, UV.

Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit është krijuar me më datë 16.09.2008 me vendim të Senatit nr. 11.5 me shkresë 11 Prot., datë 16.09.2008. Ai është vazhdimësi e seksionit të Kontabilitetit dhe Financës brenda Departamentit të Biznesit, Fakulteti i Tregtisë krijuar në 1994, njëherazi me krijimin e UV me Vendim të Këshillit të Ministrave nr.105, datë 28.02.1994.

Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në Kontabilitet është hapur me Urdhërin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 270, datë 10.06.2011.

Ky program ka kohëzgjatje normale tre vite akademik, me një total prej 180 ECTS. Ky program është hartuar në përmbushje të misionit të institucionit për nxitjen e njohurive dhe shkencës, përmes punës kërkimore shkencore, punës akademike, aktivitetit krijues dhe bashkëpunues me të tretët.

Hapja e këtij programi mbështetet në strategjinë institucionale të UV. Ai është një program dinamik dhe ka si objekt kryesor formimin e studentëve me dije, aftësi dhe kompetenca profesionale të domosdoshme në funksion të profilizimit të tyre në fushën e kontabilitetit.

Programi ka si qëllim [cit] përgatitjen e profesionistëve të rinj me konceptet bazë teorike e praktike në fushën e kontabilitetit, tregjeve dhe institucioneve financiare të aftë për tu përballur me sfidat dhe nevojat e tregut të punës, për të kontribuar në zhvillimin ekonomik e social të vendit nëpërmjet kërkimit shkencor dhe aplikimit të tij.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit Bachelor në “Kontabilitet”, të ofruar nga Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit, i Fakultetit të Ekonomisë pranë Institucionit të Arsimit të Lartë- Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë (UV), filloi me trajnimin pranë ASCAL, marrjen e dokumentacionit të ofruar nga UV, si dhe ndarjen e punës për përgatitjen e pyetjeve dhe kërkesave për dokumentacion shtesë.

ASCAL bazuar në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”, ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga UV, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm.

Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje Prof.Asoc. Brikena Leka dhe Dr. Valbona Kapllani. Gjatë të gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga menaxherja teknike e ASCAL, Znj. Renata Qatipi.

Në bashkëpunim dhe me specialisten e ASCAL u caktuan datat e vizitës në institucion si dhe u përgatit axhenda e takimeve që do të realizoheshin. Axhenda iu dërgua paraprakisht edhe institucionit. Përpara vizitës në institucion grupi i vlerësimit të jashtëm realizoi një takim me kordinatoren e ASCAL, ku u diskutuan elementë të vlerësimit të programit.

Vizita dy ditore në institucion u zhvillua në datat 24 dhe 25 Shkurt 2020. Gjatë kësaj vizite, GVJ u takua me: Dekanin e Fakultetit të Ekonomisë dhe Përgjegjësen e Departamentit të Financës dhe Kontabilitetit; grupin e vetvlerësimit; pedagogët e aktivizuar në këtë program studimi; përfaqësues të Drejtorisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit Institucional; përfaqësues të Drejtorisë së Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore; përfaqësues të Drejtorisë së Edukimit për ciklin e parë dhe të dytë; studentë të këtij programi studimi; si dhe përfaqësues të sekretarisë mësimore. Gjithashtu u vizituan ambjentet e institucionit ku zhvillohet mësimi për këtë program studimi, si edhe ambjentet e bibliotekës.

Pas vizitës në Institucion, grupi i vlerësimit të jashtëm diskutoi për çështje dhe problematika që dolën gjatë shqyrtimit dhe analizës të materialeve të paraqitura nga institucioni, diskutimeve gjatë ditëve të takimit, si dhe shqyrtimit dhe analizës së materialeve shtesë që iu kërkuan institucionit në ditën e dytë të vizitës. Më tej ky grup filloi punën për hartimin e raportit të vlerësimit të jashtëm.

Në përfundim të këtij procesi, grupi përgatiti dhe dorëzoi draft raportin tek eksperti i ASCAL.

Shënim: Për shkak të Pandemisë së COVID-19, komunikimi me IAL Universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë është bërë vetëm nëpërmjet sistemit AMS, bazuar në Urdhërin e MSHMS Nr. 132 datë 09.03.2020, Urdhërin e MASR Nr. 91 date 09.03.2020, Urdhërin e MSHMS Nr. 190 datë 19.03.2020.

Më datë 02.04.2020, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare me Nr. 34/33 Prot., datë 07.04.2020 “Njoftim për dërgimin e Draft-Raportit të Vlerësimit të Jashtëm”, Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë është njohur me Draft-Raportin e vlerësimit të jashtëm.

UV përcjell zyrtarisht përgjigjen për Draft-Raportin, me shkresë Nr. 559/2 Prot., datë 09.04.2020 “Përcjellje e komenteve mbi draft Raportin e vlerësimit të jashtëm”.

Në këtë dokument institucioni ka disa komente për Draft Raportin e Vlerësimit të jashtëm.

GVJ, pasi u njoh me komentet e UV sqaron si më poshtë:

1. Paragrafi në draft RVJ

Standardi I.3 Kriteri 2

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në dosjen e vetevlerësimit, GVJ konstatoi se për hapjen e programit të studimit Bsc në Kontabilitet, njësia bazë nuk ka kryer një studim të mirëfilltë tregu lokal apo rajonal për të përcaktuar nevojat specifike për specialistë të fushës së kontabilitetit.

Por në takimet e zhvilluara gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se hapja e këtij program studimi është bazuar kryesisht në strategjinë e ofrimit të një larmie diplomash, si edhe në sinjalet që vinin nga bisedat me përfaqësues të ambientit të biznesit. Ndërkohë na u pohua që një studim tregu është realizuar një vit pasi ishte hapur programi i studimit. Por edhe në këtë rast është evidentuar që kërkesat vinin kryesisht nga përfaqësues të institucioneve bankare.

GVJ vlerëson faktin që bankat janë institucione që kanë marrëdhënie me shumë aktorë ekonomikë duke njohur edhe një pjesë të nevojave të tyre, por gjykon se është e nevojshme realizimi i një studimi tregu të dedikuar për programin e studimit, të përditësuar dhe gjithëpërfshirës përsa u takon aktorëve ekonomikë në vend.

Komenti i UV: Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit është duke realizuar një studim tregu për studentët e diplomuar në programin e studimit Bachelor në Kontabilitet, për punësimin e tyre në profilin kontabël. Pamvarësisht se nuk është bërë një studim i mirëfilltë në hapje të degës Bachelor në Kontabilitet, punësimi i studentëve tanë që kanë mbaruar këtë degë, gjurmimi jonë në vazhdimësi dhe përmes pyetsorit në google form, gjithshu kërkesat ligjore në rritje për raportim nga njësitë ekonomike të çdo niveli ka treguar dhe vazhdon të tregojë kërkesat për specialistë të fushës së kontabilitetit.

GVJ: Konstatimet e GVJ qëndrojnë përpos sqarimeve dhe komenteve të reja të dhëna nga UV. Kriteri kërkon që studimi të ishte realizuar para hapjes së këtij programi, gjatë studimeve dhe pas mbarimit të studimeve. Vlerësojmë studimin e tregut që Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit është duke ndërmarrë, pasi është edhe një nga sugjerimet e dhëna prej nesh.

Vlerësimi i këtij kriteri mbetet i pandryshuar.

2. Paragrafi në draft RVJ

Standardi I.5 Kriteri 3

Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit në kuadër të analizës vjetore të departamentit, harton një raport në lidhje me përfitimet që vijnë nga marrëveshjet e bashkëpunimit, si brenda edhe jashtë vendit. Në fokus të veçantë janë përfitimet në rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe përmirësimit të kurrikulës së programit, duke u bazuar në mobilitetet dalëse dhe hyrëse të stafit akademik, stafit administrativ dhe studentëve. Gjatë takimeve, rezultoi se nuk kishte studentë të këtij programi studimi që të kishin kryer mobilitete jashtë vendit, ndërkohë që kishte studentë të programit Bachelor në Financë që kishin kryer mobilitete jashtë vendit, si dhe kishte studentë të huaj që ndiqnin lëndë që ofroheshin nga ky departament në gjuhën angleze dhe italiane.

Komenti i UV: Informimi dhe mundësia për të aplikuar në këto mobilitete u jepet të gjithë studentëve, si atyre të programit Bachelor në Financë dhe në Kontabilitet. Fakti që nuk ka aplikime në këto shkëmbime vjen si pasojë e mos aplikimit nga ana e studentëve, por ne vazhdojmë përpjekjet që studentët e kësaj dege të rrisin interesin për to.

GVJ: Ky kriter është konsideruar i përmbushur, ndërkohë ka qenë konstatim që për këtë degë nuk ka studentë që të kenë kryer mobilitete jashtë vendit. Standardi I.5 është konsideruar “Përmbushet kryesisht”, për mospërmbushje plotësisht të kriterit 4 dhe 5. Për më tepër, Standardi I.5 është vlerësuar “Përmbushet kryesisht” edhe në RVB nga vetë IAL-ja.

Vlerësimi i këtij kriteri mbetet i pandryshuar.

3. Paragrafi në draft RVJ

Standardi I.5 Kriteri 4

Siç u përmend në kriterin 2 të këtij standardi, UV ka një numër marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione dhe biznese vendase për të mundësuar realizimin e praktikave për studentët.

Megjithatë programi i studimit “Bachelor në Kontabilitet” nuk ka të përfshirë në kurrikulën e tij praktikë mësimore të detyrueshme.

Komenti i UV: Në programin Bachelor në Kontabilitet nuk kemi të përfshirë praktikë mësimore, por lëndët e profilit Kontabël dhe në vecanti lënda “Kontabiliteti i Aplikuar” dhe “Kontabiliteti Publik”- trajtojnë raste praktike dhe reale të ndërtimit të Pasqyrave Financiare, hedhjes së faturave tatimore, etj.

GVJ: Jemi në dijeni dhe vlerësojmë faktin që në këto lëndë ofrohet informacion praktik për studentët që të aftësohen për tregun e punës. Megjithatë gjucojmë që një praktikë afatshkurtër pranë një agjenti ekonomik do të ndikonte në rritjen e praktikitetit të studentëve, pasi do të kenë mundësinë të shohin vënien në përdorim operativ të njohurive të marra. Vetë Kriteri 4 ka në fokus këto praktika mësimore. Për më tepër, Standardi I.5 është vlerësuar “Përmbushet kryesisht” edhe në RVB nga vetë IAL-ja.

Vlerësimi i këtij kriteri mbetet i pandryshuar.

4. Paragrafi në draft RVJ

Standardi I.5 Kriteri 5

Duke ju referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe atij të marrë gjatë vizitës në institucion, nuk rezultoi që për vitin akademik 2018-2019 të jetë kryer ndonjë trajnim profesional i mëtijshëm për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.

Por GVJ konstatoi që ndërkohë, UV është duke kontaktuar me punëdhënësit në rajon dhe më gjerë, për të mbledhur të dhëna në lidhje me punësimin e studentëve të diplomuar pranë tij. Kjo do i japë feedback institucionit në lidhje me punësimin e studentëve, nevojat për trajnime të mëtijshme, si dhe për të zgjeruar dhe bërë më funksional rrjetin Alumni.

Komenti i UV: Përpos punës së zyrës Alumni vetë Departamenti kujdeset që të dhënat për punësimin e studentëve tanë të diplomuar ti mbledhin nëpërmjet pyetësorit, interesimit individual dhe kontakteve të vazhdueshme me studentët tanë të cilët më pas zgjedhin të vazhdojnë studimet e mëtijshme në Master Profesional në Kontabilitet dhe në Masterat Shkencorë të ofruar nga Departamenti ynë.

GVJ: Në komentin tuaj është evidentuar c’ka ne kemi thënë në vlerësimin tonë për UV. Ne vlerësojmë përpjekjet që bën Zyra Alumni, Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit, apo edhe struktura të tjera pranë UV, pasi kjo i jep mundësi këtij IAL që në vitet që vijnë të

përmbushë plotësisht këtë kriter. Ritheksojmë që Standardi I.5 është vlerësuar “Përmbushet kryesisht” edhe në RVB nga vetë IAL-ja.

Vlerësimi i këtij kriteri mbetet i pandryshuar.

5. Paragrafi në draft RVJ

Standardi II.1 Kriteri 6

Kurrikula e programit nuk ofron Praktikë Profesionale. GVJ gjykon se shtimi i praktikës profesionale do të rriste aftësitë praktike të studentëve në fushën e kontabilitetit dhe për shkak të numrit të vogël të studentëve kosto e realizimit nuk do të ishin të rëndësishme për UV.

Mungesa e praktikës mësimore në kurrikulën e programit nuk u ngrit si problem nga studentët gjatë takimit, por kur i pyetëm thanë se do të ishte shumë mirë nëse institucioni do të ofronte praktikë gjatë studimeve bachelor.

Komenti i UV: Arsyeja e mospërfshirjes së praktikës mësimore në bachelor ka qenë se:

- Në syllabuset e lëndëve janë planifikuar projektet, detyrat e kursit, rastet e studimit kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Studentët e këtij program zhvillojnë pas një viti praktikën në Mastër Profesional në Kontabilitet.
- Referuar gjurmimit të studentëve pjesa më e madhe punësohen pasi përfundojnë masterin apo gjatë periudhës që janë duke e ndjekur atë.
- Megjithatë njësisia do të ndërmarrë një studim drejtuar studentëve bachelor dhe master që ndjekin një program studimi në Kontabilitet mbi integrimin e praktikës në Bachelor.

GVJ: Për këtë kriter qëndron përgjigja e dhënë në komentin 3 të UV. Shtojmë që ky është një program studimi i plotë Bachelor, në fund të të cilit studentët duhet të zotërojnë njohuritë teorike dhe praktike për tu punësuar. Vlerësojmë nismën e Njesisë për të ndërmarrë një studim me këtë fokus.

Vlerësimi i këtij kriteri mbetet i pandryshuar.

6. Paragrafi në draft RVJ

Standardi II.1

Kriteri 2. Programi i studimit ofron njohuri të veçanta në fushën e financës, duke i formuar studentët në disa profesione dhe specialitete. Kjo vjen si pasojë e faktit që kurrikula e programit “Bachelor në Financë” rezulton shumë e ngjashme me kurrikulën e programit “Bachelor në Kontabilitet” (ndryshojnë vetëm me 5-6 lëndë).

Në kuadër të mundësisë për një llojshmëri specialitetesh GVJ gjykon se do ishte më e përshtatme të kishin një program të përbashkët Bachelor në Financë-Kontabilitet dhe pastaj që ofron mundësinë e specializimit në dy profile Financë dhe Kontabilitet në vitin e tretë.

Kriteri 3. Bazuar në informacioni e paraqitur në RVB rezulton se pas përfundimit të studimeve “Bachelor në Kontabilitet”, institucioni u mundëson studentëve thellimin e studimeve tyre në fushën e kontabilitetit përmes programit Master Profesional në Kontabilitet. Institucioni nuk ofron mundësinë për një program specifik Master i Shkencave në “Kontabilitet”, megjithatë ofrohet programi Master i Shkencave në “Financë” për studentë të këtij programi që duan të vazhdojnë studimet Msc pranë UV. Edhe në këtë rast, duke konsideruar faktin që universiteti duhet të sigurojë vazhdimësinë e studimeve, mbështesim përsëri sugjerimin tonë për një program Bachelor në Financë-Kontabilitet, që në vazhdimësi ju ofron mundësinë e një Masteri të Shkencave në Financë.

Komenti i UV: Studentët e të gjitha degëve Bachelor në FE, UV, për tre semestra zhvillojnë të njëjtat lëndë dhe vetëm në semestrin e dytë të vitit të dytë fillojnë dhe vihen re ndryshimet. Ndërkohë kjo nuk shoqërohet me investime/kosto shtesë nga IAL pasi ne i grupojmë studentët e disa degëve brenda numrit të lejuar për një kurs leksioni.

Ndërkohë studentët e degës Bachelor në Kontabilitet kanë të njëjtat mundësi për të ndjekur Masterat e nivelit të dytë që ofron Departamenti, Masterit të Shkencave në Financë dhe Masterit të Shkencave në Pasuritë e Paluajtshme. Gjithashtu një nga pikat e forta të këtij program studimi është konkurrenca e ulët pasi Programi Bachelor në Kontabilitet ofrohet vetëm nga kjo IAL për të gjithë rajonin jugor të Shqipërisë.

GVJ: Ofrimi i një diplome shumë specifike është avantazh i madh për një IAL kur justifikohet edhe nga numri i kërkesave për këtë Program studimi. Fakti që në tre vitet e fundit vihet re një rënie e numrit të studentëve në këtë program (por edhe në bachelor në financë), si edhe një rënie e numrit të kuotave që IAL i ka kërkuar Ministrisë së Linjës, na nxit të sugjerojmë që për UV do ishte më e përshtatshme zgjerimi i fokusit të diplomës në nivelin Bachelor, në Financë dhe Kontabilitet me mundësinë e ndarjes në profile Financë dhe Kontabilitet në vitin e tretë (meqë kurrikula, stafi akademik dhe gjithçka tjetër është gati). Ky proces do lehtësonte ndërkohë edhe vijimësinë e studimeve për nivelin master shkencor dhe profesional.

Vlerësimi i këtij kriteri mbetet i pandryshuar.

7. Paragrafi në draft RVJ

Standardi II.1 Kriteri 3 Standardi II.2 Kriteri 4

GVJ vlerëson se programi i studimit "Bachelor në Kontabilitet" ofron njohuri të nevojshme e të duhura për t'u specializuar në fushën e kontabilitetit, që përkon edhe me një profesion të kërkuar në botën e biznesit dhe më gjerë. Por gjithashtu konstaton mungesën e lëndës "Auditimi" në kurrikulën e këtij programi studimi. Në takimin me stafin akademik që jep mësim në këtë program, kjo mungesë u justifikua me faktin që elementë të auditimit janë të përfshira në lëndë të tjera.

Por GVJ gjykon, siç u përmend edhe më sipër, se shtimi i një lënde në fushën e auditimit dhe shtimi i praktikës mësimore, do ta bënin kurrikulën e këtij programi më tërheqëse dhe më konkurruese krahasuar me programe të tjera të ngjashme.

Komenti i UV: Përsa i përket përfshirjes së lëndës së Auditimit në programin e studimit Bachelor në Kontabilitet, kjo është menduar dhe ofrohet në Ciklin e dytë Master Profesional në Kontabilitet, gjithsesi këtë rekomandim do ta kemi në konsideratë në momentin e ndryshimit të planeve mësimore.

GVJ: Sugjeruam shtimin e lëndës së Auditimit në këtë program pasi IAL ka përcaktuar në spektrin e objektivave kryesore të programit- specializim në fushën e Auditimit. Gjithashtu ky sugjerim lidhet dhe me fokusin shumë specifik të programit tuaj.

Vlerësimi i këtij kriteri mbetet i pandryshuar.

8. Paragrafi në draft RVJ

Standardi II.4 Kriteri 6 *Megjithatë në disa raste u konstatua se literatura nuk ishte e pesë viteve të fundit ose u konstatua mungesa të vitit të botimit të literaturës bazë dhe ndihmëse në syllabuse dhe në dokumentin e miratimit të literaturë nga Departamenti.*

Sugjerojmë që në syllabus të shtohet viti i botimit të literaturës bazë dhe ndihmëse pasi mungon në një pjesë të mirë të syllabuseve. Gjithashtu viti i botimit të literaturës mungon për një pjesë të mirë të literaturës edhe në dokumentin Miratimi i Literaturës nga Departamenti.

Komenti i UV: Disa nga literaturat bazë të përdorura në këtë program studimi si Parimet e Kontabilitetit dhe Kontabiliteti Financiar janë botime të vitit 2010, por trajtimi kontabël i regjistrimeve dhe regjistrimi i dyfishtë nuk kanë pësuar ndryshime të rëndësishme dhe në literaturat shqip nuk ka libra të botuar 5 vitet e fundit. Ndërkohë literatura e trajtuar në Kontabilitetin e Kostos, Kontabilitetin e Drejtimit, Kontabilitetin Publik janë botime të viteve të fundit. Literatura tjetër që përdoret në këtë program studimi i referohet botimeve të fundit të autorëve shqiptar, pasi literatura ofrohet në gjuhën shqipe. Në syllabuset që mungon viti i botimit do të plotësohen me to.

GVJ: Vlerësojmë dhe mirëkuptojmë gjithë sa më sipër në lidhje me koherencën në literaturë. Kriteri prej 5 vite është përcaktuar nga standardi i vendosur nga ASCAL. Megjithatë ky konstatim për literaturën që nuk i takon 5 viteve të fundit nuk ka ndikuar në vlerësimin tonë final për këtë standard. Viti i botimit dhe informacioni në lidhje me literaturën në IAL duhet të jetë pjesë e çdo syllabusi, ndërkohë ju thoni në komentin tuaj se do e konsideroni për vitin tjetër akademik.

Vlerësimi i këtij kriteri mbetet i pandryshuar.

9. Paragrafi në draft RVJ

Standardi II.4 Kriteri 9

Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në UV, GVJ konstaton se vijon puna për të krijuar ura bashkëpunimi me disa nga agjentët ekonomikë më të rëndësishëm në Vlorë, por edhe më gjerë.

Aktualisht strukturat përkatëse pranë Drejtorisë së Edukimit për Ciklin I dhe II dhe Drejtorisë së Sigurimit të Brendshëm dhe Zhvillimit Institucional po punojnë për mbledhjen e të dhënave në lidhje me numrin e të punësuarve nga UV në këta agjentë ekonomikë, në kuadër edhe të zgjerimit dhe fuqizimit të rrjetit Alumni.

UV ka një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione të ndryshme, nga të cilat mundohet të përfitojnë maksimalisht edhe në kuadër të propozimeve për rritjen e cilësisë së programit të tyre.

Megjithatë ende nuk ka raporte apo analiza formale në lidhje me feedback-un që mund të jetë marrë në funksion të përmirësimit të kurrikulës së programit.

Komenti i UV: Në Raportin e përpiluar pas përfundimit të Workshopit me temë " Studentët dhe tregu i punës", NJSBCVI i ka kushtuar një rëndësi të vecantë rekomandimeve të lëna prej pjesëmarrëseve...[cit]... Dokumenti i mësipërm është një dëshmi e drejtpërdrejtë e feedbackut të marrë prej bashkëpunëtorëve të UV-së me qëllim përmirësimin e kurrikulës së programeve të studimit përfshirë edhe Programin Bachelor në Kontabilitet.

GVJ: Në raportin e GVJ është evidentuar dhe parë me përparësi organizimi për herë të parë i një Workshop-i "Studentë dhe Tregu i punës" në mënyrë që në kurrikulën e këtij programi studimi të reflektohen nevojat dhe problematikat që vijnë nga tregu i punës. Besojmë që këto sugjerime do të konsiderohen nga ky IAL. Të dy pikat që janë sjellë si koment nga SBPC janë evidentuar edhe nga GVJ në përshkrimin për këtë kriter, përveç rastit të praktikës mësimore për arsye se kjo nuk ofrohet në këtë program studimi. Ndërkohë rishkruajmë paragrafin e fundit në këtë kriter në RVJ si më poshtë:

Standardi II.4 Kriteri 9

Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në UV, GVJ konstaton se vijon puna për të krijuar ura bashkëpunimi me disa nga agjentët ekonomikë më të rëndësishëm në Vlorë, por edhe më gjerë.

Aktualisht strukturat përkatëse pranë Drejtorisë së Edukimit për Ciklin I dhe II dhe Drejtorisë së Sigurimit të Brendshëm dhe Zhvillimit Institucional po punojnë për mbledhjen e të dhënave në lidhje me numrin e të punësuarve nga UV në këta agjentë ekonomikë, në kuadër edhe të zgjerimit dhe fuqizimit të rrjetit Alumni.

UV ka një sërë marrëveshesh bashkëpunimi me institucione të ndryshme, nga të cilat mundohet të përfitojnë maksimalisht edhe në kuadër të propozimeve për rritjen e cilësisë së programit të tyre.

UV ka organizuar për herë të parë një workshop: “Studentë dhe Tregu i punës” në Dhjetor 2019 me organizma me të cilët ka marrëveshje bashkëpunimi, për të tërhequr komente dhe sugjerime nga tregu i punës në funksion të përmirësimit të kurrikulës së programit.

Organizimi i këtij workshopi është konsideruar nga GVJ kur ka bërë vlerësimin e këtij kriteri.

Vlerësimi i këtij kriteri mbetet i pandryshuar.

10. Paragrafi në draft RVJ

Standardi II

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II.

Komenti i UV: Në lidhje me vlerësimin e standartit II Departamenti komenton: Meqënëse 3 fusha nga 5 të standartit II janë vlerësuar “Plotësisht” dhe 2 “Kryesisht” shpresojmë në një vlerësim “Plotësisht” të Standartit II. te fundit.

GVJ: GVJ gjykon se shkalla e përmbushjes së standardeve është një vlerësim i kombinuar cilësor dhe sasior. Konstatimet e GVJ qëndrojnë përpos sqarimeve dhe komenteve të reja të dhëna nga UV.

Vlerësimi i këtij standardi mbetet i pandryshuar.

11. Paragrafi në draft RVJ

Standardi III.1 Kriteri 2

Duke ju referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në UV, GVJ konstaton se në vitin 2018 struktura organizative e institucioni është riorganizuar. Si rezultat ndër të tjera është ngritur Njësia e Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional (NJSCVI) në varësi të Drejtorisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit Institucional (DSBCZHI). I gjithë personeli i punësuar pranë kësaj strukture është staf joakademik.

NJSCVI monitoron dhe vlerëson në mënyrë periodike cilësinë në mësimdhënie duke përdorur si mekanizëm kryesor analizën e pyetësorëve të plotësuar nga studentët. Këto të dhëna përpunuara dhe analizuar në formën e një raporti të Drejtorisë përkatëse i dërgohen Rektorit, Dekanit dhe Përgjegjësve të Departamenteve.

NJSCVI ndjek zbatimin e rekomandimeve që bëjnë titullarët si dhe problematikat e ndeshura lidhur me plotësimin e disa pyetjeve të pyetësorit, si për shembull aktualisht po punohej për të nxjerrë një model të përditësuar të pyetësorit. Në takimet e zhvilluara gjatë vizitës në UV, GVJ konstatoi se NJSCVI nuk merret me rishikimin e kurrikulës së programit dhe syllabuseve përkatëse pasi gjykohej se ky proces i takonte një strukture tjetër – Sektorit të Kurrikulave dhe Shërbimit ndaj Studentëve (SKSHS). Ndërkohë që nga takimi me përfaqësues të zyrës SKSHS rezultoi se kjo zyrë merrej me grumbullim dhe katalogimin formal të syllabuseve sipas programeve dhe cikleve të studimit, por nuk merrej me rishikimin e cilësisë së tyre pasi gjykohej se kjo ishte e drejtë dhe përgjegjësi ekskluzive e departamentit përkatës.

Duke ju referuar kësaj situatë, GVJ gjykon se ka nevojë për një ndarje më të qartë të detyrave dhe përgjegjësi në strukturat/njësitë e riorganizuar.

Gjithashtu, GVJ konstaton se nuk janë ende funksionale komisionet e përhershme për sigurimin e cilësisë, të parashikuara tashmë sipas kuadrit rregullator në fuqi.

Komenti i UV: Në UV, procesin e rishikimit të kurrikulave apo cdo proces tjetër i cili ka si qëllim sigurimin e cilësisë së veprimtarisë së UV nuk e shohim si një proces ku përgjegjës është një strukturë e vetme, por gjykojmë se është një përgjegjësi e përbashkët e të gjithë aktorëve të institucionit...[cit]... Duke ju falenderuar për sugjerimin, vlen për tu theksuar se DSBCP duke u mbështetur në aktivitetin një vjeçar të krijimit dhe funksionimit të saj, praktikave më të mira në universitet ndërkombëtare, Kodin e Cilësisë si dhe Standartet për Sigurimin e Cilësisë në IAL, ka propozuar rishikimin e detyrave funksionale të sektorëve nën varësi...

GVJ: Komentet e DCBCP nuk bien ndesh me vlerësimin e bërë nga GVJ. Rishikimi i detyrave dhe përgjegjësi do të qartësoj të drejtat dhe përgjegjësitë e secilës strukturë si dhe të Departamentit të Financë-Kontabilitetit, përgjegjës për këtë program studimi. GVJ beson që në vitet në vijim do të jetë e mundur të vlerësohet ndikimi i tyre në syllabuset dhe kurrikulën për këtë program studimi.

Vlerësimi i këtij kriteri mbetet i pandryshuar.

12. Paragrafi në draft RVJ

Standardi III.4 Kriteri 1

Megjithatë, nga takimet gjatë vizitës në institucion, rezultoi se përmirësimi i vazhdueshëm i mësimdhënies vazhdon të mbetet përgjegjësi e departamentit. NJSBCVI ishte kryesisht e fokusuar në realizimin e pyetësorëve të studentëve..

Komenti i UV: NJSBCVI në kuadër të promovimit të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë përpos realizimit Raportit bazuar në analizën e pyetësorëve të studentëve për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, përdor një sërë instrumentash dhe mekanizmesh të cilat ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në rritjen e cilësisë së programit të studimit...[cit]... Të gjitha aktivitetet e mësipërme dëshmojnë një angazhim të NJSBCVI-së në kuadër promovimit të cilësisë ashtu sikurse është evidentuar edhe prej GVJ-së...

GVJ: Në raportin e GVJ janë evidentuar të gjithë elementët që janë shprehur si argumenta nga DCBCP, por duke qenë se edhe gjatë takimeve në institucion, thelbi i punës së tyre vihej në analizën dhe përpunimin e pyetësorëve, GVJ ka përdorur në këtë kriter shprehjen “kryesisht në realizimin e pyetësorëve të studentëve”.

Vlerësimi i këtij kriteri mbetet i pandryshuar.

13. Paragrafi në draft RVJ

Standardi III.6 Kriteri 4 *GVJ konstaton se në UV nuk zhvillohet asnjë provim me shkrim në mënyrë anonime, me sekretim apo kodifikim.*

Anëtarët e komisionit të provimit janë përgjegjës për mbarëvajtjen e provimit dhe titullari i lëndës për të gjithë procesin deri në afishimin e notës.

Nuk ofrohet survejim i auditorëve me mjete të veçanta ose personel shtesë gjatë provimit. Gjithë përgjegjësinë gjatë zhvillimit të procesit të provimit e kanë anëtarët e komisionit të provimit.

Komenti i UV: Rregullorja e UV-së nuk e parashikon sekretimin si dhe nuk kemi pasur raste të ankesave nga ana e studentëve mbi rezultatet e provimit. Provimet ruhen një semestër në sekretari deri në ardhjen e semestrit pasardhës duke i bërë më të përgjegjshëm pedagogët në rritjen e transparencës së vlerësimit të studentëve.

GVJ: Respektojmë rregulloren dhe pavarësinë UV por në lidhje me mënyrën e kontrollit të dijeve të studentëve Kriteri kërkon që të ruhet anonimati në provim, gjë që në IAL-në tuaj nuk mundësohet. Vlerësojmë teknikën që IAL ndjek për të rritur transparencën në provime.

Vlerësimi i këtij kriteri mbetet i pandryshuar.

14. Paragrafi në draft RVJ

Standardi III.7 Kriteri 9

GVJ konstaton se mbështetja financiare e studentëve ka qenë modeste, pasi këshilli studentor që është edhe struktura përcjellëse e kërkesave të studentëve për financim në UV dhe parashikimin në buxhetin vjetor apo afatmesëm është krijuar rishtaz.

Komenti i UV: Mbështetja financiare e studentëve realizohet vec të tjerash dhe përmes mbështetjes së studentëve ekselentë si dhe studentëve në nevojë, të cilët trajtohen me bursa si dhe nuk paguajnë tarifën e studimit.

GVJ: Vlerësimi i këtij standardi nuk ka lidhje me komentin e bërë nga UV. Vlerësojmë mbështetjen financiare për studentët ekselentë dhe studentët në nevojë. Për më tepër konstatimi ynë përkon me atë që është raportuar nga GVB në RVB për këtë program studimi.

Vlerësimi i këtij kriteri mbetet i pandryshuar.

15. Paragrafi në draft RVJ

Standardi III

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III.

Komenti i UV: Në lidhje me vlerësimin e standartit III Departamenti komenton: Meqënëse 5 fusha nga 8 janë vlerësuar "Plotësisht" dhe 3 "Kryesisht" në këtë standart shpresojmë në një vlerësim "Plotësisht" të Standartit II. te fundit.

GVJ: GVJ gjykon se shkalla e përmbushjes së standardeve është një vlerësim i kombinuar cilësor dhe sasior. Konstatimet e GVJ qëndrojnë përpos sqarimeve dhe komenteve të reja të dhëna nga UV.

Vlerësimi i këtij standardi mbetet i pandryshuar.

16. Paragrafi në draft RVJ

Standardi IV.2 Kriteri 4

Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB si dhe në informacionin e marrë nga takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se aktualisht stafi akademik me kohë të plotë i departamentit të Financës dhe Kontabilitetit, mbulon mesatarisht 3-6 lëndë (në të gjitha programet dhe nivelet e studimit) me një ngarkesë totale orare të që varion nga 1.5 deri në 3 herë ngarkesën bazë të përcaktuar nga VKM përkatëse.

GVJ gjykon se pavarësisht se kjo është tashmë një praktikë e përhapur dhe e pranuar në universitetet publike dhe numri aktual i studentëve në këtë program studimi është i ulët, një ngarkesë e tillë mund të çënojë realizimin cilësor të objektivave të programit të studimit dhe të personelit akademik të angazhuar.

Komenti i UV: Ngarkesa në auditor e stafit akademik të Departamentit të Financës dhe Kontabilitetit është e bazuar në legjislacionin në fuqi enë asnjë rast nuk është shkelur legjislacioni në lidhje me këtë çështje...[cit]...kjo ngarkesë sëbashku me mbingarkesën.....cka mendojmë se është plotësisht e përballeshme nga pedagogët të cilët vec faktit që zhvillojnë lëndë të ngjashme, mbështetur dhe në specializimin e tyre, nuk janë të angazhuar në mësimdhënie në universitete të tjera publike apo private, por gjithë kontributi i tyre është pranë UV...

GVJ: GVJ nuk e ka venë në dyshim ligjshmërinë e ngarkesës apo kapacitetin e stafit akademik, por vlerëson se puna me mbingarkesë mund të çënojë realizimin cilësor të objektivave të programit të studimit dhe të personelit akademik të angazhuar. Konstatimet e GVJ qëndrojnë përpos sqarimeve dhe komenteve të reja të dhëna nga UV.

Vlerësimi i këtij kriteri mbetet i pandryshuar.

17. Paragrafi në draft RVJ

Standardi IV.5 Kriteri 3 dhe 4

Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në takimet e zhvilluara gjatë vizitës në UV, GVJ konstatoi se platforma UVMS është e organizuar për të ofruar akses të dedikuar për të gjitha kategoritë e përdoruesve të planifikuar në këtë platformë.

Aktualisht shkëmbimet e informacionit ndërmjet përdoruesve të platformës përqendrohen kryesisht në përdorimin e platformës për konsultimin e informacioneve apo dokumenteve si orari mësimor, programi mësimor, lëndët, listat e notave, krediteve, plotësimi dhe grumbullimi i pyetësorëve/anketimeve të ndryshme, fatura për tarifa regjistrimi etj. Përdorimi i platformës për aktivitete të tjera administrimi është relativisht i kufizuar ose mungon fare.

Komenti i UV: UV ka një sistem të manaxhimit të informacionit shumë efikas që ka filluar të përdoret nga pedagogët që në vitin 2009-2010. Ai është një ndihmesë shumë e madhe si për studentët ashtu edhe për pedagogët. Fakti që në situatën e Covid 19 i gjithë universiteti, dhe vecanërisht Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit po realizon mësimin online është falë vënies në dispozicion të gjithë udhëzuesave nga IT dhe bërjes efektive të platformës për mësimin online në një kohë rekord..[cit]...

GVJ: GVJ vlerëson faktin që UV tashmë e ka funksional 100% sistemin e manaxhimit të informacionit. Por GVJ në vlerësimin e mësipërm të kriterit 4 të këtij standardi është bazuar në informacionin e marrë nga dokumentacioni i paraqitur dhe takimet e organizuara gjatë vizitës në institucion. Konstatimet e GVJ qëndrojnë përpos sqarimeve dhe komenteve të reja të dhëna nga UV.

Vlerësimi i këtij kriteri mbetet i pandryshuar.

18. Paragrafi në draft RVJ

Standardi V

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V.

Komenti i UV: Meqënëse në këtë standard, 4 nga 6 fusha janë vlerësuar “Plotësisht” dhe 2 “Kryesisht” besojmë dhe shpresojmë për një vlerësim “Plotësisht” të Standartit V...[cit]...

GVJ: GVJ gjykon se shkalla e përmbushjes së standardeve është një vlerësim i kombinuar cilësor dhe sasior. Konstatimet e GVJ qëndrojnë përpos sqarimeve dhe komenteve të reja të dhëna nga UV.

Vlerësimi i këtij standardi mbetet i pandryshuar.

19. Paragrafi në draft RVJ

Standardi VI.1 Kriteri 1

Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se në UV Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë realizohet kryesisht nga Njësia e Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional (NJSCVI) me 3 specialistë, pranë Drejtorisë së Sigurimit të Cilësisë dhe Zhvillimit Institucional (DSCIZHI). E krijuar në vitin 2016 sipas vendimit të Senatit Akademik të UV, struktura aktuale e NJSCVI është rezultat i riorganizimit të strukturës organizative të vitit 2018.

Hartimi dhe zhvillimi i politikave për sigurimin e brendshëm të cilësisë është përgjegjësi kryesore e drejtuesit të DSCIZHI. Gjithashtu, rezulton se ky drejtues ka për detyrë edhe zhvillimin e një sistemi raportimi të UV, si dhe pjesëmarrjen në rishikimin e kurrikulave dhe programeve aktuale të studimit dhe në vlerësimin e propozimeve për programet e reja.

GVJ nuk konstatoi ndonjë politikë të posaçme të kësaj drejtorie përveç asaj lidhur me analizën e pyetësorëve të studentëve.

Statuti i UV parashikon edhe ngritjen e Komisioneve të Përherëshme të Sigurimit të Cilësisë në nivel universiteti dhe njësie kryesore. Gjatë takimit me përfaqësues të kësaj Drejtorie, GVJ konstatoi se këto komisione nuk janë plotësuar ende dhe se rregullorja e funksionimit të kësaj Drejtorie është në proces miratimi nga Senati Akademik.

Komenti i UV: UV gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj përpiket t'i sigurojë stafit dhe studentëve shërbime cilësore në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të cilësisë duke ngritur një sistem efektiv të sigurimit të cilësisë, i cili udhëheq aktivitetet akademike dhe funksionet administrative në institucion. Si një detyrim ligjor që rrjedh drejtpërdrejt prej Ligjit të Arsimit të Lartë Nr. 80/2015, pika 1, Institucioni ka hartuar politika si dhe ka ngritur struktura në funksion të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.....[cit]..... Tjetër politikë sic edhe është përmendur më lartë, është propozimi nga kjo drejtori e politikës së përfshirjes së palëve të jashtme në sigurimin e cilësisë nëpërmjet organizimit të Workshopit "Studentët dhe tregu i punës..."

GVJ: Në vlerësimin e dhënë nga GVJ janë marrë parasysh dokumentat e sipërcituar, si dhe është vënë në dukje mosplotësimi i disa komisioneve dhe puna ende në proces për miratimin e rregullores të funksionimit të Drejtorisë përkatëse. Konstatimet e GVJ qëndrojnë përpos sqarimeve dhe komenteve të reja të dhëna nga UV.

Vlerësimi i këtij kriteri mbetet i pandryshuar.

20. Paragrafi në draft RVJ

Standardi VI.1 Kriteri 2

Njësia e Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional rezulton e krijuar rishtazi, pas riorganizimit të strukturës organizative të UV në vitin 2018. Funksionimi dhe organizimi i saj bazohet në statutin e UV dhe është ende në proces plotësimi i rregullores dhe i strategjisë përkatëse të aktivitetit. Aktualisht

Komenti i UV: Në komisionet e Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë për çdo njësi Kryesore dhe në nivel Institucioni, studentët përfaqësohen me një anëtar në çdo komision...[cit]...

Si pjesë e strategjisë institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, është edhe përfshirja e bashkëpunëtorëve dhe ekspertëve të jashtëm 13 nëpërmjet organizimit të tryezave të rumbullakta ...[cit]... Aktualisht strukturat përkatëse pranë Drejtorisë së Edukimit për Ciklin I dhe II dhe Drejtorisë së Sigurimit të Brendshëm dhe Zhvillimit Institucional po punojnë për mbledhjen e të dhënave në lidhje me numrin e të punësuarve nga UV në këta agjentë ekonomikë, në kuadër edhe të zgjerimit dhe fuqizimit të rrjetit Alumni.....

GVJ: GVJ vlerëson angazhimin e strukturave përkatëse megjithë mungesën e eksperiencës dhe veçanërisht punën aktuale për mbledhjen e të dhënave nga agjentë ekonomikë, alumni etj. Megjithatë vlerësimi i dhënë mësipër nga GVJ është bazuar në informacionin e marrë nga dokumentacioni i paraqitur dhe takimet e organizuara gjatë vizitës në institucion (emëruesi i përbashkët i të cilave ishte analiza e pyetësorëve). Konstatimet e GVJ qëndrojnë përpos sqarimeve dhe komenteve të reja të dhëna nga UV.

Vlerësimi i këtij kriteri mbetet i pandryshuar.

21. Paragrafi në draft RVJ

Standardi VI.1 Kriteri 3

UV i është nënshtruar procesit të vlerësimit të jashtëm nga ekspertët e ASCAL për akreditimin institucional dhe ka marrë vlerësimin përfundimtar pozitiv, të shoqëruar me disa rekomandime, nga Bordi i Akreditimit. Në përgjigje të rekomandimeve, UV ka hartuar dhe miratuar nga strukturat përkatëse planin e masave për plotësimin e këtyre rekomandimeve. GVJ konstaton se me riorganizimin e vitit 2018 janë realizuar një pjesë e këtyre rekomandimeve, si dhe vlerëson angazhimin e të gjitha strukturave të UV për plotësimin e pjesës së mbetur.

GVJ nuk konstatoi përdorime të vlerësimeve analitike krahasuese apo të instrumenteve të tjera në funksion të plotësimin të këtij kriteri. Gjithashtu vlerëson se sistemi i raportimit aktual që përdor UV ka nevojë për një harmonizim dhe strukturim më të përshtatshëm për ta bërë atë më të lexueshëm.

Komenti i UV: NJSBCVI si një prej strukturave të angazhuara në procesin e përmirësimit të cilësisë ka monitoruar vazhdimisht dhe ka raportuar tek Rektori në mënyrë periodike (raporti 3-mujor) mbi realizimin e rekomandimeve të lëna prej BA. Gjithashtu, raporte krahasuese janë realizuar dhe prej Njësive kryesore. Duke qenë se institucioni është në fazë akreditimi institucional periodik, raporti i vetëvlerësimit do të përmbajë dhe një analizë krahasuese mbi plotësimin e standarteve.

GVJ: GVJ vlerëson angazhimin e strukturave përkatëse për punën që do të bëjnë për të përfshirë në raportin e ardhshëm një analizë krahasuese mbi plotësimin e standardeve. Megjithatë vlerësimi i dhënë mësipër nga GVJ është bazuar në informacionin e marrë nga dokumentacioni i paraqitur dhe takimet e organizuara gjatë vizitës në institucion (emëruesi i përbashkët i të cilave mbetet analiza e pyetësorëve). Konstatimet e GVJ qëndrojnë përpos sqarimeve dhe komenteve të reja të dhëna nga UV.

Vlerësimi i këtij kriteri mbetet i pandryshuar.

22. Paragrafi në draft RVJ

Standardi VI.1 Kriteri 4

Aktiviteti i Njësies së Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional bazohet në planin vjetor të Drejtorisë përkatëse, me një sistem raportimi gjashtëmujor dhe kryesisht në formën e një raporti analize mbi rezultatet e pyetësorit të studentëve për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo program studimi në UV.

Në takimet e zhvilluara gjatë vizitës në UV, GVJ konstatoi se NJSCVI nuk merret me rishikimin e kurrikulës së programit dhe syllabuseve përkatëse pasi gjykohej se ky proces i takonte një strukturë tjetër – Sektorit të Kurrikulave dhe Shërbimit ndaj Studentëve (SKSHS). Ndërkohë që nga takimi me përfaqësues të zyrës SKSHS rezultoi se kjo zyrë merrej me grumbullim dhe katalogimin formal të syllabuseve sipas programeve dhe cikleve të studimit, por nuk merrej me rishikimin e cilësisë së tyre pasi gjykohej se kjo ishte e drejtë dhe përgjegjësi ekskluzive e departamentit përkatës.

Duke ju referuar kësaj situate, GVJ gjykon se ka nevojë për një ndarje më të qartë të detyrave dhe përgjegjësive në strukturat/njësitet e riorganizuar. Mungesa e eksperiencës në rastin e strukturave të krijuara rishtaz, si dhe mbështetja e aktivitetit kryesisht në analizën e rezultateve të pyetësorit të studentëve në gjykimin tonë vështirëson krijimin e një kulture cilësie në rang institucioni.

Komenti i UV: ...[cit]...NJSCVI raporton në mënyrë periodike për aktivitetin e saj pranë titullareve të institucionit, ku hollësisht përshkruhen aktivitetet e realizuara në përputhje me planin vjetor të punës. Cdo aktivitet analizohet i detajuar për sa i përket periudhës së parashikuar, veprimtarive të ndërmarra në kuadër të realizimit të tij, vështirësive të hasura si dhe niveli i përbushjes së aktivitetit.

Rritja e Kulturës së Cilësisë si një proces i vazhduar në UV sigurohet nëpërmjet të një sërë aktivitetesh sikurse janë përmendur edhe më sipër, të tilla si...[cit]...

GVJ: GVJ vlerëson angazhimin e strukturave përkatëse pavarësisht eksperiencës së kufizuar, por në takimet e organizuara gjatë vizitës në institucion u konstatua nevoja për një ndarje më të qartë të detyrave dhe përgjegjësive në strukturat/njësitet e riorganizuar. Vlerësimi i dhënë mësipër nga GVJ për këtë kriter është bazuar në faktin se kriteri thekson qartësinë e politikave dhe periodicitetin e procedurave për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë.

Vlerësimi i këtij kriteri mbetet i pandryshuar.

23. Paragrafi në draft RVJ

Standardi VI.3 Kriteri 1 dhe 2

Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se në UV aktiviteti i Njësies së Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional (NJSCVI) bazohet në planin vjetor të Drejtorisë përkatëse, me një sistem raportimi gjashtëmujor dhe kryesisht në formën e një raporti analize mbi rezultatet e pyetësorit të studentëve për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi në UV.

Aktualisht pyetësori është uniform për të gjitha programet e studimit që ofron UV dhe Njësia është duke shqyrtuar mundësinë e realizimit të pyetësorëve të dedikuar sipas fushave akademike dhe cikleve të studimit. Vlerësimet e NJSCVI janë pjesë e informacionit të paraqitur në dosjen e vetëvlerësimit të institucionit si dhe përdoren nga njësitet bazë dhe strukturat e tjera në analizat vjetore përkatëse.

Siç u përmend edhe më parë, mbështetja e aktivitetit të vlerësimit të brendshëm kryesisht në analizën e rezultateve të pyetësorit të studentëve në gjykimin tonë jep një vlerësim jo të plotë dhe të pamjaftueshëm të ecures së programit të studimit dhe aspekteve të tjera të lidhura me të.

Komenti i UV: Përpos sqarimit mbi mënyrën e raportimit të NJSCVI- së të komentuar më lartë, vlerësimi i brendshëm i ecures së programit të studimit dhe aspekteve të tjera të lidhura me të nuk mbështetet vetëm në Raportin e analizës së pyetësorëve të studentëve por gjithashtu në ...[cit]...

Të gjithë dokumentat e sipër cituar shërbejnë Për të vlerësuar ecurinë e programit të studimit dhe aspekteve të tjera të lidhura me të, duke e bërë të larmishëm procesin.

GVJ: Vlerësimi i dhënë mësipër nga GVJ për këtë kriter është bazuar në faktin se kriteri thekson përdorim e metodave/instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit. Sqarimet dhe komentet e dhëna rishtaz nga UV lidhen me elementë tashmë të marrë parasysh në vlerësim nga GVJ .

Vlerësimi i këtij kriteri mbetet i pandryshuar.

24. Paragrafi në draft RVJ

Standardi VI.3 Kriteri 4

Duke ju referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në UV, GVJ nuk konstatoi ndonjë përdorim sistematik të metodave apo instrumentave të tjerë të tërthortë për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit.

GVJ gjykon se mospërdorimi i metodave dhe instrumentave të tjerë alternativë në vlerësim, nisur dhe nga mungesa e eksperiencës së strukturave të krijuara rishtaz, çënon cilësinë e procesit të vlerësimit.

GVJ vlerëson se duhet të formalizohet dhe bëhet traditë eksperiencia e organizimeve të tilla si workshopi me temë “Studentët dhe tregu i punës” i vitit 2019, rezultat i bashkëpunimit të disa strukturave të UV, me përfaqësues të institucioneve publike dhe private, ekspertë dhe Alumni.

Komenti i UV: Në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë përdor edhe metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, të tipit:

- Informacioni i përpunuar prej Sektorit të Këshillimit të Studentëve dhe Alumni-t20 Statistikat mbi punësimin e studentëve dhe lloji i punës dhe karriera e tyre, janë një tregues mbi cilësinë e programeve të Studimit të ofruar prej këtij universiteti.
- Ashtu sikurse është përmendur dhe vlerësuar edhe prej GVJ-së organizimi i takimeve me bashkëpunëtorë, ekspertë të jashtëm dhe Alumni.

Sigurisht që këto dy instrumenta të tërthorta nuk janë shteruese për vlerësimin e programit të studimit, por janë dëshmi e përpjekjeve pozitive të UV-së për përdorimin sistematik të metodave apo instrumentave të tjerë të tërthortë për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit...[cit]...

GVJ: GVJ vlerëson punën e bërë nga strukturat përkatëse në organizimin e workshopit shumë dimensional “Studentët dhe tregu i punës” dhe rekomandon që kjo eksperiencë të kthehet në traditë. Vlerësimi i dhënë nga GVJ për këtë standard nuk bazohet në pritshmërinë për shterimin e instrumentave lidhur me procesin e vlerësimit, por në informacionin e marrë nga dokumentacioni i paraqitur dhe takimet e organizuara gjatë vizitës në institucion (emëruesi i përbashkët i të cilave mbetet analiza e pyetësorëve apo puna ende në proces për përdorimin instrumentave të tjerë). Konstatimet e GVJ qëndrojnë përpos sqarimeve dhe komenteve të reja të dhëna nga UV.

Vlerësimi i këtij kriteri mbetet i pandryshuar.

25. Paragrafi në draft RVJ

Standardi VI.5 Kriteri 4

GVJ nuk konstatoi ndonjë sistem vlerësimi të posaçëm për matjen e efektivitetit dhe ndikimit të këtyre veprimtarive për përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit. GVJ gjykon se një sistem monitorimi i formalizuar dhe i strukturuar në mënyrë të përshtatshme do të garantojë efektivitetin e veprimtarive të realizuara në kuadër të përmirësimit të cilësisë të programit të studimit.

Komenti i UV: Në Raportin e Analizës së Pyetësorëve në Seksionin e Rekomandimeve dhe përfundimeve një rëndësi të vecantë i kushtohet realizmit të një analize krahasuese midis rezultateve të dy viteve akademike 2017-2018 dhe 2018-2019, qëllimi i së cilës është matja e efektivitetit dhe impaktit të veprimave të ndërmarra në kuadër të përmirësimit të cilësë fal implementimit të planit të masave të miratur një vit më parë...[cit]...Përpos monitorimit të efektivitet të veprimtarisë në kuadër të përmirësimit, Institucioni ka për objektivi përmirësimin edhe të vet instrumentave të përdorura për përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit si psh: ngritja e grupit AdHoc për përmirësimin e Pyetësorit të Vlerësimit të Cilësë së mësimdhënies së programit të studimit, si dhe krijimin e instrumentave të rinj, ku vlen për tu theksuar se për herë të parë është përpiluar Pyetësori për vlerësimin e cilësisë së shërbimeve ndihmës akademike dhe Administrative sëbashku me procedurën përkatëse...[cit]...

GVJ: GVJ vlerëson punën e bërë nga struktura përkatëse pavarësisht eksperiencës së kufizuar. Vlerësimi i dhënë mësipër nga GVJ për këtë kriter është bazuar në faktin se kriteri thekson vlerësimin dhe sigurimin e efektivitetit dhe impaktit të veprimtarive monitoruese. Sqarimet dhe komentet e dhëna rishtaz nga UV lidhen me elementë tashmë të marrë parasysh në vlerësim nga GVJ.

Vlerësimi i këtij kriteri mbetet i pandryshuar.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Kontabilitet”

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi I.1				
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Bazuar në informacioni e paraqitur në RVB dhe informacionit të marrë gjatë vizitës në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë (UV), GVJ konkludon se ky institucion ofron programe studimi të cilat janë në shërbim të shoqërisë, ekonomisë, politikës dhe zhvillimit të qëndrueshëm afatgjatë lokal, rajonal dhe kombëtar. Programi i studimit “Bachelor në Kontabilitet” është i hartuar në harmoni me Ligjin 80/2015 të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor për IAL-të në Shqipëri .			
Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Duke ju referuar planit strategjik të UV, GVJ konstaton se [cit]: <i>institucioni ka si objektiv thellimin e traditave më të mira universitare shqiptare, si dhe të kontribuojë në thellimin e lirisë akademike dhe dëshirës për ndjekjen e studimeve universitare. Ai synon të ketë ndikim transformues në shoqëri, përmes inovacionit të vazhdueshëm, hulumtimit dhe pjesëmarrjes aktive në zhvillimin social dhe ekonomik të vendit.</i> [Referenca: Evidenca B- Plani strategjik 2018-2024. pdf]			
Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit “Bachelor në Kontabilitet” është program i Ciklit të parë të studimeve dhe ofrohet me kohëzgjatje normale 3 vite akademike, me një total prej 180 kredite (ECTS). Ky program është hartuar mbështetur në përmbushje të misionit të institucionit për nxitjen e njohurive dhe shkencës, përmes punës kërkimore shkencore, punës akademike, aktivitetit krijues dhe bashkëpunues me të tretët. [Referenca: Evidenca A- Statuti i UV-së.pdf] ; 1.4_Rregullore e programit të studimit Bachelor në Kontabilitet.pdf]			
Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Programi i studimit “Bachelor në Kontabilitet” është një program që synon të pajisë studentët me aftësi teorike dhe praktike në një fushë të kërkuar në tregun e punës. Këndvështrimi i Institucionit është që ta shohë programin si një program dinamik, në zhvillim të vazhdueshëm duke ju përshtatur zhvillimeve dhe prioritetëve lokale, rajonale dhe kombëtare. Të gjitha ndryshimet dhe përshtatjet në program bëhen në përputhje me kriteret e kartës së Bolonjës. [Referenca: Evidenca B- Plani strategjik 2018-2024.pdf] ; Evidenca C- Rregullore UV-së e ndryshuar.pdf]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2				
Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	<p>Duke ju referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe atij të marrë gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se programi “Bachelor në Kontabilitet” është hartuar dhe ofrohet në <i>kuadër të strategjisë së UV</i> e cila ka në fokus përmirësimin e cilësisë në të gjithë aktivitetet e tij.</p> <p>Hapja e këtij programi studimi është bazuar në propozimin e ofruar nga njësia bazë, Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit, i cili ka si mision përgatitjen dhe formimin e studentëve të aftë në fushën e financës dhe kontabilitetit në përputhje me trendin e tregut të punës.</p> <p><i>[Refe:1.1_Plani strategjik_Departamentit të Financës dhe Kontabilitetit.pdf]</i></p>			
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	<p>Programi “Bachelor në Kontabilitet” ofrohet në përputhje me statutin e UV dhe kuadrin rregullator në fuqi. Në <i>Statutin dhe Rregulloren e UV</i> përcaktohen qartë drejtimit kryesore të veprimtarisë së tij në [cit]: <i>mësimdhënie bashkëkohore, formim të specialistëve të lartë në përputhje me prioritetet dhe zhvillimin e vendit, si dhe programe gjithëpërfshirëse aktivitetesh për aftësimin dhe zhvillimin e studentëve.</i></p> <p>Programi i studimit ka për qëllim përmbushjen e nevojave thelbësore të qytetarëve shqiptarë në përputhje me kërkesat e tregut.</p>			
Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.	<p>GVJ, referuar RVB si dhe informacionit të marrë gjatë vizitës në institucion, vlerëson se emërtimi dhe organizimi i programit të studimit “Bachelor në Kontabilitet” është në përputhje me drejtimit akademike të përcaktuara në dokumentet themelore të UV.</p> <p>Ky program studimi zhvillohet në fushën e Kontabilitetit dhe është në përgjegjësinë e departamentit të Financës dhe Kontabilitetit. Departamenti është i strukturuar në dy grupe mësimore: grupi mësimor i Financës dhe grupi mësimor i Kontabilitetit, në funksion edhe të dy diplomave që ofron ky departament në nivelin Bachelor: “Bachelor në Financë” dhe “Bachelor në Kontabilitet”.</p> <p><i>[Referenca: 2.1_Rregullore e Departamentit të Financës dhe Kontabilitetit.pdf]</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3	
Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuara qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat	<p>Programi i studimit Bsc në “Kontabilitet” ka si objektivi thelbësor [cit] <i>formimin e studentëve që përfshin dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale të domosdoshme në funksion të profilizimit të tyre në fushën e kontabilitetit. Njohuritë e fituara në këtë program i aftësojnë studentët për</i></p>

profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.	<p>të qenë konkurrues në treg, si në sektorin publik, ashtu edhe atë privat.</p> <p>GVJ gjykon se objektivi për këtë program studimi është i formuluar qartë dhe në përputhje me qëllimin dhe misionin e UV.</p> <p><i>[Referenca: 1.4_Regullore e programit të studimit Bachelor në Kontabilitet.pdf]</i></p>			
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në dosjen e vetevlerësimit, GVJ konstatoi se për hapjen e programit të studimit Bsc në Kontabilitet, njësia bazë nuk ka kryer një studim të mirëfilltë tregu lokal apo rajonal për të përcaktuar nevojat specifike për specialistë të fushës së kontabilitetit.</p> <p>Por në takimet e zhvilluara gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se hapja e këtij program studimi është bazuar kryesisht në strategjinë e ofrimit të një larmie diplomash, si edhe në sinjalet që vinin nga bisedat me përfaqësues të ambientit të biznesit. Ndërkohë na u pohua që një studim tregu është realizuar një vit pasi ishte hapur programi i studimit. Por edhe në këtë rast është evidentuar që kërkesat vinin kryesisht nga përfaqësues të institucioneve bankare.</p> <p>GVJ vlerëson faktin që bankat janë institucione që kanë marrëdhënie me shumë aktorë ekonomikë duke njohur edhe një pjesë të nevojave të tyre, por gjykon se është e nevojshme realizimi i një studimi tregu të dedikuar për programin e studimit, të përditësuar dhe gjithëpërfshirës përsa u takon aktorëve ekonomikë në vend.</p>			
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet, garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathësisë e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>GVJ konstaton se programi i studimit Bsc në Kontabilitet është strukturuar sipas kriterëve të <i>ligjit të arsimit të lartë 80/2015</i>, sipas objektivave të institucionit dhe perceptimit që ka institucioni për nevojat e tregut të punës. Në lidhje me përmbajtjen e programit në funksion të përgjigjes së nevojave të tregut, mendojmë se ky program “Bachelor në Kontabilitet” përgjithësisht përgatit studentë të formuar në fushën e kontabilitetit.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca C- Rregullore UV-së e ndryshuar.pdf; 1.4_ Rregullore e programit të studimit Bachelor në Kontabilitet.pdf]</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi I.4

Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>	<p>Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë (UV) është krijuar me vendim të Këshillit të Ministrave dt 28.02.1994. Ky institucion, bazuar në përvojën dhe kapacitetet njerëzore dhe fizike, ofron të tre programet e studimeve. Fakulteti i Ekonomisë është një nga fakultetet më të mëdha dhe më të vjetër të UV. Ai përbëhet nga tre departamente:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit, • Departamenti i Ekonomisë dhe

- Departamenti i Biznesit.

Personeli Akademik Efektiv (PAE) në rang fakulteti për tre vitet e fundit përbëhet nga:

PAE /Viti akademik	2017-2018	2018-2019	2019-2020
Profesor	1	1	1
Profesor te Asociuar	7	7	7
Doktor/Docent	16	18	20
Msc.	12	7	5

Personeli Akademik Efektiv (PAE) në nivel Departamenti përgjegjës për tre vitet e fundit përbëhet nga:

PAE /Viti akademik	2017-2018	2018-2019	2019-2020
Profesor	0	0	0
Profesor te Asociuar	1	1	1
Doktor/Docent	4	6	6
Msc.	6	3	3

[Referenca: [RVB-Bachelor në Kontabilitet.pdf](#) -Tabelat 1.1-1.3 Numri i personelit akademik etj.; vizita në institucion]

Programi “Bachelor në Kontabilitet” ofrohet nga Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit. GVJ konstaton se stafi i këtij departamenti dhe veçanërisht stafi i angazhuar në këtë program studimi demonstroi se ka përvojën, kapacitet dhe burimet e duhura në fushën akademike për të ofruar këtë program studimi. Në këtë program për vitin akademik 2019-2020 janë angazhuar 28 pedagogë si staf akademik (PAE & PAK), ku 5 janë të kategorisë Profesor, 15 mbajnë gradën Doktor, ndërsa 8 pedagogët e tjerë janë në vazhdim të kualifikimeve të mëtejshme.

Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.

Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë

Fusha që mbulon ky program studimi përputhet me fushën akademike e kërkimore të Fakultetit të Ekonomisë.

Klasifikimi/ kodifikimi i programit të studimit është bërë në përputhje me direktivat dhe udhëzimet kombëtare dhe evropiane.

Fusha që mbulon ky program studimi përputhet tërësisht me fushën akademike e kërkimore të Departamentit të Financës dhe Kontabilitetit, i cili ka si mision kryesor përgatitjen dhe formimin e studentëve në fushën e Financës dhe fushën e Kontabilitetit.

Mbështetur në dokumentacionin e ofruar nga Institucioni, si dhe nga takimet e zhvilluara, Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit mbështetet edhe nga departamentet e tjera në ofrimin e programit, pasi ky program është ndërdisiplinor.

[Referenca: [1.1_Plani strategjik_Departamentit të Financës dhe Kontabilitetit.pdf](#); [1.3_Plani strategjik i programit të studimit Bachelor në Kontabilitet.pdf](#); [1.4_Rregullore e programit të studimit Bachelor në Kontabilitet.pdf](#); [Informacion shtese.pdf](#)]

këtë përputhje.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.5	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	<p>Në funksion të realizimit të programit të studimit, institucioni ka hartuar një sërë rregulloresh dhe dokumentash, përmes të cilëve mbikqyr zhvillimin e tij. Pëmes këtyre dokumentave, ndahen detyrat dhe përgjegjësitë midis njësive dhe zyrave përgjegjëse. Njësia bazë ku zhvillohet programi është departamenti i Financës dhe Kontabilitetit, i mbështetur nga departamenti i Biznesit dhe ai i Ekonomiksisht. Gjithashtu në proces përfshihen një sërë zyrash për sigurimin e brendshëm të cilësisë dhe sektori i projekteve dhe marrëdhëniet me jashtë, për kurrikulat dhe zhvillimin e karrierës dhe kujdesin ndaj studentit, si dhe këshilltari akademik për studentët.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca C- Rregullore UV-së e ndryshuar.pdf; 1.5_Organigrama UV Ismail Qemali.pdf; 2.1_Rregullore e Departamentit të Financës dhe Kontabilitetit.pdf; 1.4_Rregullore e programit të studimit Bachelor në Kontabilitet.pdf]</i></p>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.	<p>GVJ vlerëson se UV ka në fokus të punës së tij vendosjen e marrëdhënieve të bashkëpunimit me institucione homologe jashtë vendit, duke mundur nënshkrimin e një sërë marrëveshesh me Universitete në shtete të tjera. Aktualisht këto marrëveshje janë kryesisht në kuadër të programit Erasmus + dhe Mevlana.</p> <p>Përfitimet kryesore nga këto marrëveshje konsistojnë në mobilitete për trajnim të stafit akademik, administrativ dhe studentëve, mobilitete për mësimdhënie të stafit akademik, mobilitete për të vazhduar studimet për një semestër pranë një IAL-je në një shtet tjetër, etj.</p> <p>Ndërkohë janë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi edhe me një numër biznesesh dhe institucionesh brenda vendit, kryesisht për të siguruar praktika profesionale për studentët.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca J- Raporti vjetor i UV për vitin 2018-2019.pdf; 5.5_Marrveshje me Raiffeisen Bank Sha.pdf]</i></p>
Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	<p>Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit në kuadër të analizës vjetore të departamentit, harton një raport në lidhje me përfitimet që vijnë nga marrëveshjet e bashkëpunimit, si brenda edhe jashtë vendit.</p> <p>Në fokus të veçantë janë përfitimet në rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe përmirësimit të kurrikulës së programit, duke u bazuar në mobilitetet dalëse dhe hyrëse të stafit akademik, stafit administrativ dhe studentëve.</p>

	<p>Gjatë takimeve, rezultoi se nuk kishte studentë të këtij programi studimi që të kishin kryer mobilitete jashtë vendit, ndërkohë që kishte studentë të programit Bachelor në Financë që kishin kryer mobilitete jashtë vendit, si dhe kishte studentë të huaj që ndiqnin lëndë që ofroheshin nga ky departament në gjuhën angleze dhe italiane.</p> <p><i>[Referenca: 2.12_Raporti vjetor 2018-2019 i Departamentit të Financës dhe Kontabilitetit.pdf]</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>Siç u përmend në kriterin 2 të këtij standardi, UV ka një numër marrëveshesh bashkëpunimi me institucione dhe biznese vendase për të mundësuar realizimin e praktikave për studentët.</p> <p>Megjithatë programi i studimit “Bachelor në Kontabilitet” nuk ka të përfshirë në kurrikulën e tij praktikë mësimore të detyrueshme.</p> <p><i>[Referenca: 1.2_Plani Mësimor i Prog.stud. Bachelor Kontabilitet_2019 - 2020.pdf]</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtjshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Duke ju referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe atij të marrë gjatë vizitës në institucion, nuk rezultoi që për vitin akademik 2018-2019 të jetë kryer ndonjë trajnim profesional i mëtjshëm për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p> <p>Por GVJ konstatoi që ndërkohë, UV është duke kontaktuar me punëdhënësit në rajon dhe më gjerë, për të mbledhur të dhëna në lidhje me punësimin e studentëve të diplomuar pranë tij. Kjo do i japë feedback institucionit në lidhje me punësimin e studentëve, nevojat për trajnime të mëtjshme, si dhe për të zgjeruar dhe bërë më funksional rrjetin Alumni.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

<p>Standardi II.1 Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjisllacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Kontabilitet organizohet sipas ligjit të arsimit të lartë, në lëndë e module ku secila vlerësohet me kredite sipas sistemit ECTS. Programi i studimit është i organizuar në përputhje me legjisllacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>

<p>Krediteve (ECTS).</p> <p>Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p> <p>Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Programi i studimit realizohet për 3 vite akademike, i organizuar në 6 semestra (2 për çdo vit). Programi në total ka 180 kredite. Lëndët janë të ndara sipas kategorive referuar përcaktimeve ligjore. Struktura e programit është në përputhje të plotë me Ligjin e Arsimit të Lartë dhe aktet nënligjore përkatëse, duke përfshirë një tërësi lëndësh formuese dhe specializuese për studentët. Lëndët janë ndarë sipas kategorizimit ligjor në lëndë bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese dhe detyrimet përmblylëse (të evidentuara në kriterin 1 të këtij standardi):</p> <p>Kategorinë A- Lëndë Bazë me 32 ECTS zënë 18% të krediteve (brenda kufijve ligjorë 15%-20% të krediteve);</p> <p>Kategorinë B- Lëndë Karakterizuese me 99 ECTS zënë 55% të krediteve brenda kufijve 50%-55% të krediteve);</p> <p>Kategorinë C- Lëndë Ndërdisiplinore me 24 ECTS zënë 13% të krediteve brenda kufijve 12%-15% të krediteve);</p> <p>Kategorinë D- Lëndë Plotësuese me 19 ECTS zënë 11% të krediteve (brenda kufirit 10%-15% të krediteve);</p> <p>Kategorinë E- Detyrime Përmblylëse (Punimi i diplomës/Provim i përgjithshëm formimi) me 6 ECTS zënë 3% të krediteve (brenda kufijve 3%-5% të krediteve);</p> <p>GVJ gjykon se përfshirja e lëndëve në secilën kategori është në përputhje me fokusin e çdo lënde, si dhe pesha e lëndëve për secilën kategori është në përputhje me kriteret e përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p> <p>Secila nga lëndët e kurrikulës së programit ka të përcaktuar ngarkesën në kredite, në varësi edhe të llojit të kategorizimit përkatës. Gjithashtu programi i studimit është i shpërndarë me ngarkesat përkatëse sipas formave të zhvillimit të njohurive: leksione, seminare, laboratore dhe temë diplome/ provim i përgjithshëm.</p> <p>Kurrikula e programit nuk ofron Praktikë Profesionale. GVJ gjykon se shtimi i praktikës profesionale do të rriste aftësitë praktike të studentëve në fushën e kontabilitetit dhe për shkak të numrit të vogël të studentëve kosto e realizimit nuk do të ishin të rëndësishme për UV.</p> <p>Mungesa e praktikës mësimore në kurrikulën e programit nuk u ngrit si problem nga studentët gjatë takimit, por kur i pyetëm thanë se do të ishte shumë mirë nëse institucioni do të ofronte praktikë gjatë studimeve bachelor.</p> <p><i>[Referenca: 1.2_Plani Mësimor i Prog.stud. Bachelor Kontabilitet_2019 - 2020.pdf; 1.6_ Permbledhese e syllabuseve te prog. stud. Bachelor ne Kontabilitet Viti Akademik 2019 - 2020.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesioneve e specialitetesh.</p>	<p>Programi i studimit “Bachelor në Kontabilitet” ka një fokus shumë specifik, kështu që edhe formimi i shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesioneve dhe specialitetesh është relativisht i kufizuar, pasi janë profesione që lidhen vetëm me profilin Kontabël.</p> <p>Programi i studimit ofron njohuri të veçanta në fushën e financës, duke i formuar studentët në disa profesione dhe specialitete. Kjo vjen si pasojë e faktit që kurrikula e programit “Bachelor në Financë” rezulton shumë e</p>

	<p>ngjashme me kurrikulën e programit “Bachelor në Kontabilitet” (ndryshojnë vetëm me 5-6 lëndë).</p> <p>Në kuadër të mundësisë për një llojshmëri specialitetesh GVJ gjykon se do ishte më e përshtatme të kishin një program të përbashkët Bachelor në Financë-Kontabilitet dhe pastaj që ofron mundësinë e specializimit në dy profile Financë dhe Kontabilitet në vitin e tretë.</p> <p>Gjithashtu, në kuadër më të gjerë ndërdisiplinor ky program studimi ofron njohuri në fushën e ekonomisë, marketingut, biznesit, matematikës, etj, megjithatë këto janë kryesisht njohuri të përgjithshme.</p> <p><i>[Referenca: 1.2_Plani Mësimor i Prog.stud. Bachelor në Kontabilitet_2019 - 2020.pdf; 1.6_ Përmbledhëse e syllabuseve të prog. stud. Bachelor në Kontabilitet Viti Akademik 2019 - 2020.pdf]</i></p>			
<p>Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuar në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p> <p>Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>GVJ vlerëson se programi i studimit “Bachelor në Kontabilitet” ofron njohuri të nevojshme e të duhura për t’u specializuar në fushën e kontabilitetit, që përkon edhe me një profesion të kërkuar në botën e biznesit dhe më gjerë. Por gjithashtu konstaton mungesën e lëndës “Auditimi” në kurrikulën e këtij programi studimi. Në takimin me stafin akademik që jep mësim në këtë program, kjo mungesë u justifikua me faktin që elementë të auditimit janë të përfshira në lëndë të tjera.</p> <p>Bazuar në informacioni e paraqitur në RVB rezulton se pas përfundimit të studimeve “Bachelor në Kontabilitet”, institucioni u mundëson studentëve thellimin e studimeve tyre në fushën e kontabilitetit përmes programit Master Profesional në Kontabilitet. Institucioni nuk ofron mundësinë për një program specifik Master i Shkencave në “Kontabilitet”, megjithatë ofrohet programi Master i Shkencave në “Financë” për studentë të këtij programi që duan të vazhdojnë studimet Msc pranë UV.</p> <p>Edhe në këtë rast, duke konsideruar faktin që universiteti duhet të sigurojë vazhdimësinë e studimeve, mbështesim përsëri sugjerimin tonë për një program Bachelor në Financë-Kontabilitet, që në vazhdimësi ju ofron mundësinë e një Masteri të Shkencave në Financë.</p> <p>Pyetjes sonë në takime se përse nuk IAL nuk kishte hapur një Msc në “Kontabilitet”, iu përgjigjën që nuk i kanë burimet njerëzore për të ofruar një program të tillë. Mendojmë që në këtë vendim ndikon edhe numri në rënie i studentëve që regjistrohen në programin Bachelor në Kontabilitet (2016- 46 studentë; 2017- 19 studentë; 2018-13 studentë dhe 2019- 11 studentë), si dhe niveli i ulët i mesatares së studentëve në hyrje.</p> <p>Në takime u evidentua që rritja e mesatares së pranimit në Universitete në këto dy vitet e fundit nga Qeveria, ka ndikuar në rënien e numrit të regjistruarve në këto programe.</p> <p>GVJ gjykon se njohuritë, aftësitë dhe kompetencat e parashikuara në këtë program studimi u mundësojnë studentëve një zhvillim të specializuar për fushën e kontabilitetit dhe financës të nivelit bachelor. <i>[Referenca: 1.1_Plani strategjik_Departamentit të Financës dhe Kontabilitetit.pdf]</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

			X	
--	--	--	----------	--

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p> <p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p> <p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p> <p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në informacionin e paraqitur në faqen zyrtare web të UV, si dhe informacionet e marra në takimet gjatë vizitës, GVJ konstaton se njësia kryesore dhe njësia bazë përgjegjës për programin e studimit përmbushin të gjitha detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p> <p>Njësia kryesore, ofruese për këtë program studimi është Fakulteti i Ekonomisë, si pjesë e Universitetit të Vlorës. Fakulteti përbëhet nga 3 departamente:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit; - Departamenti i Biznesit; - Departamenti i Ekonomiksit. <p>Njësia bazë, përgjegjëse për ofrimin e këtij programi studimi është <i>Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit</i>. Ky departament në përputhje me ligjin për arsimin e lartë, është i organizuar në dy grupe mësimore, që emërtohen edhe sipas dy specialiteteve të programeve Bachelor që ofron: <i>Grupi mësimor i Financës dhe Grupi mësimor i Kontabilitetit</i>.</p> <p>Departamenti i Biznesit dhe departamenti i Ekonomiksit mbështesin në realizimin e programit të studimeve “Bachelor në Kontabilitet”, duke zhvilluar lëndët e fushave përkatëse.</p> <p>Departamenti Financës dhe Kontabilitetit për vitin akademik 2019-2020 përbëhet nga 10 staf akademik efektiv (PAE), nga të cilët:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 1 Profesor i Asociuar, - 6 Doktor - 3 Msc. <p>Nga shqyrtimi i informacionit të paraqitur në RVB dhe dokumentacionit të dërguar pas vizitës në institucion, rezultoi se në këtë program studimi zhvillohen gjithsej 37 lëndë (përfshirë lëndët me zgjedhje). Duke qenë se lëndët janë multidisiplinore, një pjesë e tyre mbulohen nga departamente të tjera të Fakultetit të Ekonomisë dhe të Fakulteteve të tjera. Në këtë program studimi janë të angazhuar 16 PAE nga departamentet e tjera të FE të UV, ndërsa jashtë FE janë angazhuar 10 pedagogë.</p> <p>GVJ konstaton se pedagogët e angazhuar në këtë program studimi plotësojnë kushtet e kërkuara nga Ligji i arsimit të Lartë për të dhënë mësim në Institucionet e Arsimit të Lartë. Kurrikula e këtij programi mbulohet kryesisht me staf akademik të brendshëm (PAE dhe PAK). Gjatë vitit akademik 2019-2020, në këtë program studimi janë angazhuar 28 pedagogë si staf akademik, nga të cilët 28 personel akademik me kohë të plotë dhe 0</p>

	<p>personel akademik me kohë të pjesshme (pra 100% e stafit të angazhuar në program janë staf akademik i brendshëm i UV).</p> <p>Pothuajse e njëjta situatë vihet re edhe për vitet e mëparëshme akademike, kur për vitin akademik 2018-2019 janë angazhuar 30 pedagogë si staf akademik, nga të cilët 28 personel akademik me kohë të plotë dhe 2 personel akademik me kohë të pjesshme (pra 93% e stafit të angazhuar në program janë staf akademik i brendshëm i UV), ndërsa për vitin akademik 2017-2018 janë angazhuar 29 pedagogë si staf akademik, nga të cilët 28 personel akademik me kohë të plotë dhe 1 personel akademik me kohë të pjesshme (pra 97% e stafit të angazhuar në program janë staf akademik i brendshëm i UV).</p> <p><i>[Referenca: RVB-Bachelor në Kontabilitet.pdf -Tabelat 1.1-1.3 Numri i personelit akademik etj.; Informacion shtesë.pdf; vizita në institucion]</i></p>			
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinator i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p>	<p>GVJ konstatonon se Fakulteti i Ekonomisë, në zbatim të <i>ligjit të Arsimit të Lartë nr. 80/2015, nenit 77 të Statutit të UV dhe nenit 85 të Rregullores së UV</i> ka përcaktuar një koordinator për programin e studimit “Bachelor në Kontabilitet”. Duke ju referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe atij të marrë gjatë takimeve në institucion rezultoi se ky koordinator është përgjegjës për promovimin e programeve të studimit, si dhe koordinon marrëdhëniet mes studentëve dhe departamentit, në bashkëpunim të ngushtë me përgjegjësen e Departamentit të Financës dhe Kontabilitetit. <i>[Referenca: 2.3_Kordinatori i Programit të Studimit.pdf]</i></p> <p>Megjithëse ky program studimi nuk ka të përfshirë në kurrikul praktikën profesionale, nga takimet e zhvilluara gjatë vizitës në UV rezultoi se sipas mundësisë, pedagogët u ofronin studentëve të interesuar kryerjen e praktikave profesionale.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi II.3 Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.</p>	
<p>Kriteret</p> <p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p> <p>Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p> <p>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar si dhe diskutimet me pedagogët e programit të studimit gjatë vizitës në Institucion konstatoi se informacionet për elementët e rëndësishëm të programeve të studimeve janë publike dhe të mundshme për t’u aksesuar lirisht. Linja e informacionit lëviz sipas hierarkisë, duke marrë si input dokumentat kryesore në nivel Institucional, ku përfshihen, ligje, vendime, udhëzime rregullore, statute.</p> <p>Njësia kryesore dhe veçanërisht njësia bazë përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të dytë disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin dhe strukturën e programeve të studimit. Ato njohin detyrimet ligjore si dhe statutin dhe rregulloren e UV. Ndërkohë ky</p>

<p>Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p> <p>Kriteri 4. Programet e studimit përbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>informacion është i njohur edhe për stafin e departamentit që përcakton edhe kurrikulën dhe përmbajtjen e syllabuseve të këtij program studimi.</p> <p>Programi i studimit është i organizuar në lëndë, module, praktikë e veprimtari formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. Kjo gjen pasqyrim në planin mësimor të programit të studimit, i cili është i strukturuar dhe detajuar në përputhje me objektivat e tij.</p> <p>Programi i studimit “Bachelor në Kontabilitet” zgjat për një periudhë akademike 3 vjeçare (koha normale), i ndarë në 6 semestra (2 semestra në vit), me një total prej 180 ETC.</p> <p>Kurrikula e tij konsiston në 37 lëndë (përfshirë lëndët me zgjedhje), të cilat kategorizohen në një nga pesë kategoritë kryesore që përcakton Ligji për Arsimin e Lartë, në funksion të formimit të studentëve në profilin e kontabilitetit.</p> <p>Kategorinë A- Lëndë Bazë me 32 ECTS zënë 18% të krediteve (brenda kufijve ligjor 15%-20% të krediteve);</p> <p>Kategorinë B- Lëndë Karakterizuese me 99 ECTS zënë 55% të krediteve brenda kufijve 50%-55% të krediteve);</p> <p>Kategorinë C- Lëndë Ndërdisciplinore me 24 ECTS zënë 13% të krediteve brenda kufijve 12%-15% të krediteve);</p> <p>Kategorinë D- Lëndë Plotësuese me 19 ECTS zënë 11% të krediteve (brenda kufirit 10%-15% të krediteve);</p> <p>Kategorinë E- Detyrime Përmbyllëse (Punimi i diplomës/Provimi i përgjithshëm formimi) me 6 ECTS zënë 3% të krediteve (brenda kufijve 3%-5% të krediteve);</p> <p>Ky program studimi nuk ka të përfshirë Praktikë profesionale në kurrikulën e tij.</p> <p>Nga shqyrtimi i informacionit të paraqitur në RVB konstatohet se plani mësimor për çdo lëndë të kurrikulës së këtij programi studimi është i organizuar në mënyrë të tillë që të ofrojë informacion në lidhje me ngarkesën mësimore, orët në auditor dhe jashtë auditorit, ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit. Në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator të UV, plani mësimor hartohet nga pedagogët e gruplëndëve nën drejtimin e përgjegjëses së departamentit të Financës dhe Kontabilitetit, për të vijuar më pas me miratimin nga titullari i institucionit.</p> <p>Vlerësimi i vazhduar, në përgjithsi përbën 20-30% të totalit të pikëve (vlerësimi i vazhduar fillon nga 0% dhe arrin deri në 50%). Ai konsiston në dy elementë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Aktivizimi dhe pjesëmarrja në veprimtaritë mësimore në auditor; ▪ Kontrolli i dijeve ku përfshihen: provimi i ndërmjetëm ose detyra e kursit. Detyrat e kursit mund të jenë individuale ose në grupe 2-3 studentë duke nxitur në këtë mënyrë punën në grup dhe të menduarit kritik, por duke respektuar autonominë e studentit. <p>Për frekuentimin e studentëve IAL ka vendosur:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Për leksionet detyrimi është 75%;
--	--

	<ul style="list-style-type: none"> - Për seminarët detyrimi është 75%; - Për praktikat nuk aplikohet. <p><i>[Referenca: Evidenca A- Statuti i UV-së.pdf; Evidenca C- Rregullore UV-se e ndryshuar.pdf; 1.4_Rregullore e programit të studimit Bachelor në Kontabilitet.pdf] [Referenca: 1.2_Plani Mësimor i Prog.stud. Bachelor Kontabilitet_2019 -2020.pdf; 1.6_ Permbledhese e syllabuseve të prog. stud. Bachelor në Kontabilitet Viti Akademik 2019 - 2020.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>GVJ gjykon se, njëjloj si në kriterin e mësipërm, ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve, për profilizim në fushën e kontabilitetit.</p> <p>Pranimi i studentëve në programin Bachelor në Kontabilitet realizohet në përputhje me nenin 74 të ligjit 80/2015 të arsimit të lartë, në udhëzimet e përvitshme të MASR, në kriteret e parashikuara në nenin 39 të rregullores së UV, si dhe në kriteret e propozuara nga njësia bazë dhe të miratuara nga senati i UV.</p> <p>Senati i UV ka miratuar si kriter pranimi notën mesatare të tre viteve të studimit dhe të provimeve të maturës shtetërore, që përbëjnë 100% të vlerësimit.</p> <p>Kuotat e kërkuara dhe të miratuara janë 80, ndërkohë që numri i studentëve të pranuar është shumë më i vogël. Në takim na u konfirmua që kjo vjen nga vënia e kriterit të mesatares 6,5 të përcaktuar me VKM nr. 295, datë 10.05.2019 për të vazhduar studimet e larta në këtë degë.</p> <p><i>[Referenca: 1.4_ Rregullore e programit të studimit Bachelor në Kontabilitet.pdf; 2.5_Procedurat e pranimit të studentëve të rinj.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabusët e detajuar) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Nga shqyrtimi i informacionit të paraqitur në RVB dhe informacionit të marrë në takimet e zhvilluara gjatë vizitës në UV, rezultoi se për të gjitha lëndët e programeve të studimit paraqitej një syllabus i detajuar, i cili kontrollohej dhe miratohej nga përgjegjësi i grup lëndëve dhe nga përgjegjësi i departamentit.</p> <p>Në syllabusin e çdo lënde jepet informacion për:</p> <ul style="list-style-type: none"> - pedagogët që do të zhvillojnë lëndën, titujt që zotërojnë dhe adresat e emailit, ngarkesa e ndarë në leksione dhe seminare, numri i krediteve, programi ku zhvillohet lënda, tipologjia, kodi dhe nëse lënda është e detyrueshme apo me zgjedhje. - Në brendinë e tij, çdo syllabus ofron përmbledhjen dhe qëllimin e lëndës që do të realizohet si dhe objektivin kryesor të shoqëruar nga termat kyç. Informacioni që ofrohet në këtë pjesë u jep mundësinë studentëve dhe gjithë të interesuarve për të kuptuar fokusin kryesor të lëndës, duke evidentuar që në fillim të lëndës pritjet e tyre prej saj. - Programi përmban temat që do të zhvillohen në çdo orë mësimi, si dhe - literaturën e detyrueshme dhe literaturën e rekomanduar për çdo

	<p>temë. Kjo u jep mundësi studentëve që të konsultojnë literaturën e nevojshme për ezaurimin e koncepteve kyç në çdo temë.</p> <p>Në çdo syllabus janë të përcaktuar të gjithë elementët që kërkohen nga Shtojca Nr. 2 e VKM Nr. 41, datë 24.01.2008 “Për elementët e programeve të studimit”.</p> <p><i>Sugjerojmë një unifikim të formatit të syllabuseve për Institucionin, pasi bie në sy që për disa lëndë syllabuset janë shumë më pak të detajuara (duke mos përfshirë të gjithë elementët që u përmenden më lart). Këto u takojnë zakonisht lëndëve që mbulohej nga departamente jashtë Fakultetit të Ekonomisë.</i></p> <p><i>[Referenca: 1.6_ Përmbledhese e syllabuseve të prog. stud. Bachelor në Kontabilitet Viti Akademik 2019 - 2020.pdf]</i></p>			
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Në takimet e zhvilluara gjatë vizitës në UV rezultoi se programet përmirësohen dhe përditësohen në fillim të çdo viti akademik, pas analizës vjetore që bëhet në Departament.</p> <p>GVJ konstatoi se stafi akademik i përfshirë në këtë program studimi, nëpërmjet rishikimit vjetor të syllabuseve të lëndës synonte reflektimin e ndryshimeve si pasojë e koherencës në literaturë; sugjerimeve nga ekspertë jashtë UV; përfshirjen e eksperiencave më të mira ndërkombëtare, si dhe sugjerimet e studentëve përsa ishte e mundur.</p> <p>GVJ gjykon se ky proces ndikon në rritjen e cilësisë së syllabusit dhe mësimnxënies, duke ndikuar pozitivisht në formimin e studentëve.</p> <p><i>[Referenca: 1.7_Praktika e ndryshimit të planeve mesimore.pdf]</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi II.4 Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënies dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>Referuar <i>ligjit nr. 80/2015 për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor</i> në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Institucioni ka konceptuar këtë program studimi me kohështrirje akademike tre vjeçare, të ndarë në gjashtë semestra (dy semestra në vit akademik); <p>Vlerësimi i lëndëve dhe punimit përmyllës së studimeve (diplomë ose provim) janë vlerësuar me ECTS, në përputhje me peshën që i takon çdo grup lëndësh sipas tipologjisë së tyre, në një total prej 180 kredite.</p>
<p>Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri,</p>	<p>GVJ vlerëson se emërtimi dhe përmbajtja e veprimtarive, si dhe finalizimi me një temë diplome apo një provim përfundimtar kanë në fokus thellimin</p>

aftësi dhe/ose punësim të studentëve.	<p>e njohurive dhe aftësive të studentëve.</p> <p>Njohuritë e fituara janë të përshtatshme për t'u punësuar si pranë sektorit publik, ashtu edhe atij privat.</p> <p>Gjithashtu GVJ gjykon se shtimi i praktikës profesionale do të ndikonte në zbatimin praktik të njohurive të fituara në këtë program studimi si dhe do të rriste interesin e tyre për të.</p>
<p>Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe aftësimi profesional.</p>	<p>Referuar informacionit të paraqitur në RVB, GVJ vlerëson se në këtë program studimi lëndët janë shpërndarë në vite akademike, si dhe në semestrat përkatës për çdo vit në mënyrë të tillë që të kenë vijueshmëri, të hedhin themelet e formimit në fushën e kontabilitetit dhe pastaj të thellojnë më tej këtë formim.</p> <p>Lëndët që krijojnë më qartësisht profilin e këtij programi kryesisht zhvillohen në vitin e tretë akademik, si gjatë semestrit të parë, ashtu edhe të dytë. <i>[Referenca: 1.2_Plani Mësimor i Prog.stud. Bachelor Kontabilitet_2019 -2020.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>GVJ konstaton se struktura e programit, lëndët, ngarkesa në kredite është në përputhje me profilin e programit në fushën e kontabilitetit. Njohuritë e ofruara në këtë program studimi janë të mjaftueshme për të formuar një specialist të fushës përsa i takon njohurive të parashikuara në nivelin e studimeve Bachelor.</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Teori (leksione) 1200 orë; ▪ Praktikë (seminare/laboratore/praktike profesionale) 645 orë; ▪ Raporti teori (1200 orë) / Praktikë (645 orë) është 1.9:1. <p>Por GVJ gjykon, siç u përmend edhe më sipër, se shtimi i një lënde në fushën e auditimit dhe shtimi i praktikës mësimore, do ta bënin kurrikulën e këtij programi më tërheqëse dhe më konkurruese krahasuar me programe të tjera të ngjashme. <i>[Referenca: 1.2_Plani Mësimor i Prog.stud. Bachelor Kontabilitet_2019 -2020.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>GVJ konstaton se ndarja e lëndëve në këtë program studimi është bërë sipas veprimtarive formuese të përcaktuara në legjislacion dhe në funksion të formimit teorik dhe praktik të studentëve.</p> <p>Pedagogët e lëndëve mundohen të ilustrojnë me shembuj praktikë njohuritë teorike.</p> <p>Ky program u jep mundësinë studentëve të tranferojnë studimet në program të njëjtë ose të ngjashëm në universitete të tjera brenda dhe jashtë vendit. Koherenca e kurrikulës si dhe njehsimi i tyre bazuar në sistemin evropian të tranferimit të krediteve lehtëson procesin e transferimeve dhe të mobiliteteve të studentëve në institucione të tjera. Megjithatë, për këtë program studimi nuk kishte pasur studentë që të kishin zhvilluar mobilitete në Institucione jashtë vendit.</p> <p>Formimi i studentëve është i përshtatshëm që studentët të punësohen pranë institucioneve publike ose private.</p>
<p>Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të</p>	<p>Nga shqyrtimi i informacionit të paraqitur në RVB dhe informacionit të marrë në takimet e zhvilluara gjatë vizitës në UV, rezultoi se programet e</p>

<p>vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>lëndëve përditësohen për të reflektuar ndryshimet që diktojnë ndryshimet e kushteve ekonomike, eksperiencat më të mira ndërkombëtare, nevojat e studentëve. Ky ndryshim reflektohet edhe në përditësimin e literaturës së detyruar dhe ndihmëse.</p> <p>Megjithatë në disa raste u konstatua se literatura nuk ishte e pesë viteve të fundit ose u konstatua mungesa të vitit të botimit të literaturës bazë dhe ndihmëse në syllabuse dhe në dokumentin e miratimit të literaturë nga Departamenti.</p> <p>Sugjerojmë që në syllabus të shtohet viti i botimit të literaturës bazë dhe ndihmëse pasi mungon në një pjesë të mirë të syllabuseve. Gjithashtu viti i botimit të literaturës mungon për një pjesë të mirë të literaturës edhe në dokumentin <i>Miratimi i Literaturës nga Departamenti</i>. [Referenca: 1.6_Përmbledhëse e syllabuseve të prog. stud. Bachelor në Kontabilitet Viti Akademik 2019 - 2020.pdf]</p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p> <p>Kriteri 8. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>GVJ konstaton se lëndët që zhvillohen në këtë program studimi, si dhe syllabuset përkatës u ofrojnë studentëve mundësinë e përfitimit të dijeve, aftësive dhe kompetencave që nevojiten për një program studimi të ciklit të parë - niveli Bachelor. Megjithatë GVJ gjykon se duhet të merren parasysh sugjerimet në kriteret e mësipërme të këtij standardi.</p> <p>GVJ gjykon se përmbajtja e këtij programi studimi u mundëson studentëve vijimin e mëtejshëm të studimeve në nivelin Master.</p> <p>Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit ofron programin Master Profesional në Kontabilitet, që është vazhdim i drejtpërdrejtë i studimeve të këtij programi, por ndërkohë studentët kanë mundësinë të ndjekin studimet edhe në programet Master Profesional në Financë dhe Msc në Financë. Ky institucion nuk ofron Msc në Kontabilitet. Kurrikula e programit u mundëson studentëve të vazhdojnë studimet në Msc në Kontabilitet në insitucione të tjera të arsimit të lartë, në vend që ofrojnë një program të tillë.</p> <p>Përfundimi i këtij program studimi, u mundëson studentëve edhe vijimin e kualifikimeve të tjera për marrjen e titujve profesionalë në fushën e kontabilitetit si Kontabël i Miratuar, Auditues Ligjor etj.</p>
<p>Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në UV, GVJ konstaton se vijon puna për të krijuar ura bashkëpunimi me disa nga agjentët ekonomikë më të rëndësishëm në Vlorë, por edhe më gjerë.</p> <p>Aktualisht strukturat përkatëse pranë Drejtorisë së Edukimit për Ciklin I dhe II dhe Drejtorisë së Sigurimit të Brendshëm dhe Zhvillimit Institucional po punojnë për mbledhjen e të dhënave në lidhje me numrin e të punësuarve nga UV në këta agjentë ekonomikë, në kuadër edhe të zgjerimit dhe fuqizimit të rrjetit Alumni.</p> <p>UV ka një sërë marrëveshesh bashkëpunimi me institucione të ndryshme, nga të cilat mundohet të përfitojnë maksimalisht edhe në kuadër të propozimeve për rritjen e cilësisë së programit të tyre.</p> <p>UV ka organizuar për herë të parë një workshop: “Studentë dhe Tregu i</p>

	punës” në Dhjetor 2019 me organizma me të cilët ka marrëveshje bashkëpunimi, për të tërhequr komente dhe sugjerime nga tregu i punës në funksion të përmirësimit të kurrikulës së programit. [Referenca: Evidenca J-Raporti vjetor i UV per vitin 2018-2019.pdf; 5.5_Marrveshje me Raiffeisen Bank Sha.pdf]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.5	
Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në dokumentacionin shoqëruar, GVJ konstaton se personeli akademik me kohë të plotë dhe ai me kohë të pjesshme i këtij programi studimi kryen veprimtari të mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbime në mbështetje dhe zhvillim të institucionit, këshillime për studentët etj, në pajtim të plotë me legjislacionin në fuqi dhe kuadrin rregullator të UV.</p> <p>Personeli akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme që angazhohet në mësimdhënie në këtë program studimi ka titujt dhe gradat sipas legjislacionit në fuqi.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p> <p>Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Konkretisht GVJ konstaton se personeli akademik që angazhohet në këtë program studimi ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për të dhënë mësim në “Bachelor në Kontabilitet”.</p> <p>Numri dhe kualifikimi i stafit të angazhuar në këtë program studimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> për vitin akademik 2019-2020 është: Janë të angazhuar 28 pedagogë si staf akademik PAE nga të cilët: <ul style="list-style-type: none"> - 1 Profesor - 4 Profesor i Asocuar - 15 Doktor i Shkencave - 8 Msc Raporti është 100% PAE. për vitin akademik 2018-2019 është: Janë të angazhuar 30 pedagogë si staf akademik - 28 PAE dhe 2 PAK, nga të cilët: <ul style="list-style-type: none"> - 1 Profesor - 3 Profesor i Asocuar - 15 Doktor i Shkencave - 11 Msc Raporti është 93% PAE dhe 7% PAK. për vitin akademik 2017-2018 është: Janë të angazhuar 29 pedagogë si staf akademik - 28 PAE dhe 1 PAK, nga

	<p>të cilët:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 1 Profesor - 3 Profesor i Asocuar - 6 Doktor i Shkencave - 19 Msc <p>Raporti është 97% PAE dhe 3% PAK.</p> <p>Në të tre vitet e fundit akademike vihet re një qëndrueshmëri e stafit mësimdhënës në këtë program studimi. Stafi akademik ka investuar në fushën e kërkimit shkencor duke u rritur numri i pedagogëve me gradën shkencore Doktor.</p> <p>Fusha akademike-shkencore e pedagogëve përputhet me lëndët në të cilët ata angazhohen në këtë program studimi. <i>[Referenca: Informacion shtesë.pdf; 2.13_Cv stafi për programin e studimit Bachelor në Kontabilitet_2016 - 2020.pdf]</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se UV ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh me Institucione Publike dhe Private. Megjithatë këto marrëveshje janë kryesisht në funksion të kryerjes së praktikës mësimore për studentë të Masterit.</p> <p>Duke ju referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në UV, konstatohet se në përfundim të studimeve realizohet punimi i diplomës për studentë me mesatare të lartë. Në këtë rast departamenti i Financës dhe Kontabilitetit përcakton një personel akademik si drejtues të punimit të diplomës.</p> <p>Departamenti ka përcaktuar edhe një koordinator për marrëdhëniet me studentët për programin e studimit “Bachelor në Kontabilitet”, që shërben edhe si këshillues akademik i tyre por edhe për problematika të ndryshme që mund të ndeshin studentët, si për shembull për strukturën e orarit mësimor. <i>[Referenca: Evidenca J- Raporti vjetor i UV per vitin 2018-2019.pdf; 5.5_Marrveshje me Raiffeisen Bank Sha.pdf; 2.3_Kordinatori i Programit te Studimit.pdf]</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi angazhimin e personelit ndihmës në funksion të këtij programi studimi. Aktualisht në shërbim të këtij programi ka një një laborator mësimor ku mund të zhvillohen orët e laboratoreve të përfshira në kurrikulën e programit. Gjatë vizitës në laborator, personeli ndihmës mësimor shkencor konfirmoi frekuentimin e laboratorit nga studentët edhe për përgatitje detyrash kursi dhe përgatitje diplome, por kryesisht nga studentët e programit master. <i>[Referenca: 1.5_ Organigrama UV Ismail Qmali.pdf]</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në dokumentacionin shoqërues, GVJ konstaton se UV ka hartuar dhe miratuar më datë 13.01.2020 udhëzuesin mbi zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies. Në këtë udhëzues vihet theksi në mësimdhënien me “studentin qendër” duke konsideruar përvojat më të mira të UV dhe institucioneve të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare. Gjithashtu, vëmendje i kushtohet përdorimit të teknologjisë së informacionit (TIK) në mësimdhënie si dhe mekanizma të tjerë bashkëkohore (platforma) në funksion të fushës së studimit për secilën njësi përbërëse të UV. <i>[Referenca: Evidenca N- Udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>Duke ju referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në UV, GVJ konstaton se në vitin 2018 struktura organizative e institucioni është riorganizuar. Si rezultat ndër të tjera është ngritur Njësia e Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional (NJSCVI) në varësi të Drejtorisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit Institucional (DSBCZHI). I gjithë personeli i punësuar pranë kësaj strukture është staf joakademik.</p> <p>NJSCVI monitoron dhe vlerëson në mënyrë periodike cilësinë në mësimdhënie duke përdorur si mekanizëm kryesor analizën e pyetësorëve të plotësuar nga studentët. Këto të dhëna përpunuara dhe analizuar në formën e një raporti të Drejtorisë përkatëse i dërgohen Rektorit, Dekanit dhe Përgjegjësve të Departamenteve.</p> <p>NJSCVI ndjek zbatimin e rekomandimeve që bëjnë titullarët si dhe problematikat e ndeshura lidhur me plotësimin e disa pyetjeve të pyetësorit, si për shembull aktualisht po punohej për të nxjerrë një model të përditësuar të pyetësorit.</p> <p>Në takimet e zhvilluara gjatë vizitës në UV, GVJ konstatoi se NJSCVI nuk merret me rishikimin e kurrikulës së programit dhe syllabuseve përkatëse pasi gjykohej se ky proces i takonte një strukture tjetër – Sektorit të Kurrikulave dhe Shërbimit ndaj Studentëve (SKSHS). Ndërkohë që nga takimi me përfaqësues të zyrës SKSHS rezultoi se kjo zyrë merrej me grumbullim dhe katalogimin formal të syllabuseve sipas programeve dhe cikleve të studimit, por nuk merrej me rishikimin e cilësisë së tyre pasi gjykohej se kjo ishte e drejtë dhe përgjegjësi ekskluzive e departamentit përkatës.</p> <p>Duke ju referuar kësaj situate, GVJ gjykon se ka nevojë për një ndarje më të qartë të detyrave dhe përgjegjësi në strukturat/njësitë e riorganizuar.</p> <p>Gjithashtu, GVJ konstaton se nuk janë ende funksionale komisionet e përhershme për sigurimin e cilësisë, të parashikuara tashmë sipas kuadrit rregullator në fuqi. <i>[Referenca: 1.5_ Organigrama UV Ismail Qmali.pdf; 3.2_Vendim senati Nr.84 dt. 12.12.2016.pdf; 3.3_Vendim senati Nr 8 date</i></p>

	14.02.2018.pdf			
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	GVJ konstaton se studentët përfshihen në vlerësimin e metodave të mësimdhënies dhe vlerësimit të dijeve nëpërmjet plotësimit të pyetësorit. Pyetësori është individual, anonim dhe plotësohet përpara se studenti të mësojë notën e provimit. Gjithashtu institucioni ka caktuar një këshilltar akademik për këtë program studimi, i cili është në kontakt të vazhdueshëm me studentët për problematikat dhe ankesat që shfaqin këta të fundit. Këshilltari akademik evidenton dhe transmeton problematikat dhe sugjerimet e studentëve pranë stafit akademik të Departamentit të Financës dhe Kontabilitetit. <i>[Referenca: Format pyetësori-Dokumentat shtesë pdf; 5.6_Kordinatori i Programit Akademik.pdf]</i>			
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	NJSCVI dhe Drejtoria përkatëse e publikojnë edhe në faqen zyrtare web të UV raportin e analizës së pyetësorëve duke evidentuar konkluzionet dhe problematikat kryesore që kanë dalë nga përpunimi i pyetësorëve. Raporti i analizës së pyetësorëve me emra individualë lëndësh dhe pedagogësh i dërgohen vetëm Rektorit, Dekanit dhe Përgjegjësve të Departamenteve. Në mbledhjen e radhës, ku merr pjesë i gjithë stafi akademik i departamentit, përgjegjësja prezanton raportin me rezultatet e pyetësorëve sipas lëndëve dhe pedagogëve. <i>[Referenca: 5.6_Kordinatori i Programit Akademik.pdf]</i>			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.	Bazuar në informacione e paraqitur në RVB dhe informacione të marrë në takimet gjatë vizitës në UV, rezultoi se në fund të çdo viti Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit, që është edhe përgjegjës për programin “Bachelor në Kontabilitet”, organizon një mbledhje për Analizën Vjetore të punës së Departamentit. Përgjegjësja e Departamentit bën edhe vlerësimin e performancës së secilit anëtar të departamentit. GVJ konstaton se UV promovon praktikën më të mirë për të nxitur rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe formimit të studentëve në këtë program studimi. Vitet e fundit UV ka filluar rimbursimin e shpenzimeve të konferencave shkencore dhe artikujve shkencorë në kuadër të rritjes së aktivitetit kërkimor dhe shkencor të stafit akademik. <i>[Referenca: 2.12_Raporti vjetor 2018-2019 i Departamentit të Financës dhe Kontabilitetit.pdf]</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.2	
Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikën më të mirë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet,	Nga shqyrtimi i informacionit të paraqitur në RVB dhe dokumentacionit shoqëruar rezultoi se format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive në këtë program studimi janë leksionet, seminarët, laboratorët dhe detyrat e kursit.

<p>seminaret, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Gjithashtu konstatohet se institucioni nxit edhe zhvillimin e orëve të hapura me specialistë të fushës të ftuar.</p> <p>Duke ju referuar planit mësimor të programit të miratuar rezulton se realizohen:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Leksione 1200 orë mësimore; - Seminare 630 orë mësimore; - Laboratorë 15 orë mësimore; - Në total 1845 orë mësimore. <p>Laboratorë janë të parashikuara vetëm në një lëndë, në lëndën Kontabilitet i Aplikuar që zhvillohet gjatë semestrit të dytë, të vitit të tretë akademik.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Detyra dhe orë jashtë auditorit 2655 orë. <p>Në syllabuset e çdo lënde është i përfshirë informacioni në lidhje me numrin e orëve të leksioneve, seminareve dhe laboratorëve. Në syllabus është e përcaktuar edhe mënyra e vlerësimit me pikë dhe notë të studentëve (vlerësimit të vazhduar dhe vlerësimit final), si dhe detyrimet për frekuentim të lëndës. <i>[Referenca: 3.15.1_Leksion i hapur_Natasha Ahmetaj.pdf; 3.15_Leksion i hapur_Louis Delcart.pdf; 1.2_Plani Mesimor i Prog.stud. Bachelor Kontabilitet_2019 -2020.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p>	<p>Gjatë vizitës në Institucion doli në pah se personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi i përgjigjet nevojave të studentëve me orë konsultimi kur këta të fundit kanë nevojë.</p> <p>Analiza e përpunimit të pyetësorëve nxjerr në pah nevoja të studentëve dhe ndryshime në metoda dhe mundësi alternative të mësimdhënies dhe mësimnxënies, kështu që është një instrument shumë i mirë që është përdorur dhe që veçanërisht duhet të përdoret në të ardhmen, edhe me këtë fokus.</p> <p>Gjithashtu një pjesë e personelit akademik ofrohet për mësimdhënie në gjuhën angleze dhe italiane për studentë të huaj që dëshirojnë të kryejnë studime (mobilitete) pranë UV në kuadër të marrëveshjeve dhe projekteve me Institucione të tjera ndërkombëtare. Kjo punë bëhet vullnetarisht nga pedagogët, por e gjykonjnë si element që ndikon në ngritjen e tyre profesionale.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Në takimet gjatë vizitës në UV, GVJ konstaton investime në pajisje teknologjike në funksion të lehtësimit të punës së stafit akademik, si dhe të rritjes së cilësisë së mësimdhënies. Ndërkohë që institucioni ka hartuar një udhëzues mbi zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies, i cili e vë theksin në përmirësimin e kompetencave didaktike, si dhe në një proces mësimdhënie dhe vlerësimi me në qendër studentin.</p> <p>Pedagogët që kanë realizuar mobilitete në institucione ndërkombëtare janë munduar të sjellin teknikat, metodat dhe literaturat që kanë konsideruar me shumë vlerë në funksion të rritjes së nivelit të mësimdhënies dhe formimit të studentit. Gjithashtu pedagogëve të rinj u ofrohet trajnim për pedagogjinë në mësimdhënie, pranë Fakultetit të Edukimit të UV. <i>[Referenca: Evidenca N-Udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve.pdf]</i></p>

<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Bazuar në informacion e paraqitur në RVB dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në UV, GVJ konkludon se personeli akademik i angazhuar në programin e studimit “Bachelor në Kontabilitet” përmbush kërkesat ligjore në fuqi për të dhënë mësim në ciklin e parë të studimeve. Përzgjedhja e stafit akademik është bërë konform të gjitha procedurave që përcakton ligji dhe institucioni, si dhe mbështetur në kërkesat nga njësia bazë që është përgjegjëse për këtë program studimi.</p> <p>GVJ konstaton se përzgjedhja e bërë ka përmbushur nevojat e departamentit, në funksion të realizimit të një apo disa lëndëve në programet e studimit që mbulon departamenti i Financës dhe Kontabilitetit. Gjithashtu rezulton se fusha kërkimore shkencore e personelit akademik është në përputhje me programin e studimit, si dhe me natyrën dhe specifikat e lëndëve ku janë të angazhuar. <i>[Referenca: 2.13_Cv staf i për programin e studimit Bachelor në Kontabilitet_2016 - 2020.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p> <p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimi.</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi nxit studentët që gjatë orëve të mësimi të përfshihen sa më shumë, duke ofruar edhe sugjerime në funksion të përmirësimit të cilësisë së programit.</p> <p>Feedback-u më i mirë prej tyre merret nëpërmjet analizës së pyetësorëve i sqaruar edhe në kriteret e mësipërme.</p> <p>Një alternativë tjetër për të përfshirë studentët në këtë proces është nëpërmjet kontakteve të tyre me këshilltarin akademik.</p> <p>Duke ju referuar planit strategjik të programit të studimeve “Bachelor në Kontabilitet”, GVJ konstaton se nxitet ndërthurja e metodave tradicionale dhe moderne të mësimdhënies, duke e vënë fokusin në përfshirjen sa më të madhe të studentëve në diskutime si gjatë orëve të leksioneve, ashtu edhe seminareve.</p> <p>Edhe gjatë takimit me studentë të këtij programi në institucion doli në pah interesi i tyre për këtë argument dhe vëmendja që i kushton institucioni. Për shembull në pyetësorin e studentëve është përfshirë një pyetje me këtë fokus dhe në raportin mbi rezultatin e pyetësorëve për vitin akademik 2018-2019, një nga vërejtjet e studentëve është mos inkurajimi i diskutimit në klasë apo mendimit kritik. Pavarësisht se ky është konkluzion në rang institucioni dhe jo specifikisht për programin “Bachelor në Kontabilitet” GVJ vlerëson kujdesin e UV mbi këtë çështje. <i>[Referenca: 1.3_Plani strategjik i programit të studimit Bachelor në Kontabilitet.pdf; Evidenca L- Raport mbi rezultatet e pyetësorit studentor për vitin akademik 2018-2019.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Bazuar në informacioni e paraqitur në RVB dhe informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në UV, rezulton se përmirësimi i cilësisë së këtij programi studimi ka në fokus autonominë e studentit.</p> <p>Studenti, që në fillim të zhvillimit të lëndës, njihet me mënyrën e vlerësimit të dijeve të tij, duke ndarë veç pikët për vlerësimin e vazhduar dhe atë përfundimtar. Studentët nxiten që gjatë orëve të leksioneve dhe seminareve të përfshihen në diskutime duke e bërë të nxëniti interaktiv dhe kritik, ndërkohë që zhvillojnë detyra kursi si individuale, ashtu edhe në grupe të vogla 2-3 studentë. Kjo nxit edhe punën në grup.</p> <p>Studentët ndiqen nga stafi akademik, nga stafi ndihmës si dhe nga</p>

	koordinatori apo këshilluesi akademik. Ata komunikojnë vazhdimisht nëpërmjet adresave të tyre elektronike zyrtare. Informacioni për ta në lidhje me pikët, notat, kreditet ofrohet nga sistemi i menaxhimit të informacionit mësimor të UV (ndryshe platforma UVMS), me akses individual.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Ky program studimi zhvillohet në ambientet e godinës A, ku zhvillon programet e tij departamenti i Financës dhe Kontabilitetit. GVJ konstaton se këto ambiente janë të mjaftueshme, si numër dhe si sipërfaqe për të zhvilluar leksionet, seminarët, laboratorët si dhe konsultimet studentëve të këtij programi studimi, për më tepër që është një grup me pak studentë. Ambientet ku zhvillohet mësimi janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht nga personeli i sektorit të shërbimeve.
Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.	GVJ vlerëson se UV ofron për këtë program studimi ambiente funksionale për zhvillimin e leksioneve dhe seminareve, si dhe laboratoreve në lëndën që ka të përfshirë në syllabus orë laborator. Sallat janë të pajisura me mjetet e nevojshme bazë për zhvillimin e mësimin. Megjithatë jo në të gjitha sallat objekt i vizitës ishin të instaluar kompjuterë dhe projektorë, në takimin me studentët u konstatua se sipas nevojës pajisjet teknologjike sillen nga vetë pedagogu për zhvillimin e mësimin. Gjithashtu GVJ konstaton se në funksion të studentëve është edhe biblioteka fizike dhe on-line, e cila ka kapacitetin e duhur si dhe literaturën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.
Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.	Të gjithë studentët dhe stafi akademik në këtë program studimi në funksion të realizimit të procesit mësimor, shfrytëzojnë: - Platformën dixhitale: Sistemin e menaxhimit të informacionit mësimor të UV (UVMS); - Adresat elektronike zyrtare të stafit akademik dhe studentëve (emer.mbiemer@univlori.edu.al) lehtësojnë komunikimin e vazhdueshëm ndërmjet tyre për të gjithë komponentët e procesit mësimor; - Godina A ku zhvillohet mësimi për këtë program studimi është e mbuluar me sistem wi-fi duke lehtësuar aktivitetin e studentëve dhe pedagogëve;

	<p>- Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit ka në përdorim në godinën A një sallë laboratorit që u vjen në ndihmë studentëve si për lëndën e Kontabilitetit të Aplikuar, ashtu edhe për të realizuar punime diplome, detyra kursi, etj. Megjithatë, programet e instaluar në kompjuterat e këtij laboratorit janë në versionin demo duke kufizuar aksesin në to.</p> <p>Referuar sa më lart, mbështetet procesi mësimor duke lehtësuar komunikimin me studentët dhe marrjen e informacionit pavarësisht vendndodhjes së tij gjeografike.</p>
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i informacionit të paraqitur në RVB dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në UV, rezulton se në syllabusin e çdo lënde është përcaktuar literatura bazë dhe ndihmëse në gjuhën shqipe, që është edhe gjuha e këtij programi studimi. Botimet janë të autorëve shqiptarë, por edhe përkthime në shqip të autorëve të huaj. Literatura kryesisht është fizike. Krahas literaturës në gjuhën shqipe, studentëve u sugjerohet edhe literaturë ndihmëse në gjuhë të huaj (kryesisht në gjuhën angleze) në funksion të thellimit të njohurive të fushës. <i>[Referenca: 1.6_ Përmbledhëse e syllabuseve të prog. stud. Bachelor në Kontabilitet Viti Akademik 2019 - 2020.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p> <p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Biblioteka ofron literaturë të shumëllojshme për programet e ndryshme që ofron UV. Gjatë vizitës në Institucion u vëzhguan raftet ku ndodhej literatura që mund të përdoret nga studentët të këtij programi studimi. Konstatohet se literatura e vënë në dispozicion është e bollshme, kryesisht ishin blerje të vitit 2016, pra në përgjithësi literaturë jo e pesë viteve të fundit. Hapësira e bibliotekës si dhe numri i kompjuterave në përdorim është i mjaftueshëm për studentët të këtij programi.</p> <p>Aktualisht botimet mund të aksesohen vetëm fizikisht dhe jo online pasi biblioteka nuk është e dixhitalizuar, por po punohet për ta realizuar edhe këtë proces. Ndërkohë studentët kanë mundësi të përdorin bibliotekën on-line “ULIBRARY” që ofrohet në të gjithë institucionet e arsimit të lartë publik në vend. <i>[Referenca: Botimet në Bibliotekë- Dokumentat shtesë.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion u konstatua se ky program studimi ka një laborator kompjuterash në dispozicion i cili përdoret nga studentët gjatë zhvillimit të lëndës: Kontabilitet i Aplikuar, si dhe për të realizuar detyrat e kursit dhe punimin përmbyllës të diplomës.</p>
<p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p> <p>Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin</p>	<p>GVJ konstaton se personeli akademik dhe studentët përdorin platformën UVMS, ku kanë llogaritë individuale. Kjo platformë lehtëson komunikimin ndërmjet tyre. Pedagogët kanë mundësinë të upload-ojnë materiale në funksion të lehtësimit të procesit mësimor.</p> <p>Gjatë takimit studentët thanë se informacioni që ata merrnin në platformë kishte të bënte kryesisht me elementët që lidheshin me vlerësimin e dijeve të tyre (pikë dhe nota), si dhe shlyerje të detyrimeve financiare ndaj UV.</p> <p>Pjesë e komunikimit të brendshëm mund të konsiderohet edhe komunikimi ndërmjet pedagogëve dhe studentëve nëpërmjet adresave elektronike zyrtare</p>

elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.	individuale. <i>[Referenca: Vizita në Institucion]</i>			
Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	Në rregulloren e programit të studimit “Bachelor në Kontabilitet” përcaktohet që studenti në varësi të notës mesatare të arritur gjatë tre viteve të studimit (realisht përkon me mesataren e 5 semestrave të parë të programit) mund të përmbyllë studimet me realizimin e një punimi diplome. Studentit që i lind e drejta të bëjë një punim diplome, më pas bën një kërkesë në sekretari ku propozon edhe emrin e pedagogut udhëheqës. Pedagogu udhëheqës i punimit miratohet nga përgjegjësjë e departamentit. Pedagogu udhëheqës gjatë gjithë kohëzgjatjes së përgatitjes së diplomës orienton dhe këshillon studentin në mënyrë që të realizohet një punim sa më cilësor dhe dinjitoz.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4	
Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimin të cilësisë së mësimdhënies.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe atë të marrë në takimet gjatë vizitës në UV, konstatohet se institucioni ka ngritur në vitin 2018 strukturën e Drejtorisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit Institucional (DSBCZHI), ku një nga nga sektorët është Njësia e Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësimin Institucional (NJSCVI). Aktualisht janë ende në proces ngritja e komisioneve të përhershme, sipas kuadrit rregullator të përcaktuar dhe miratimi nga Senati Akademik i detyrave dhe përgjegjësjë për drejtorinë dhe sektorët e saj. NJSCVI ka si funksion përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies në bashkëpunim me Departamentin përgjegjës. Megjithatë, nga takimet gjatë vizitës në institucion, rezultoi se përmirësimi i vazhdueshëm i mësimdhënies vazhdon të mbetet përgjegjësi e departamentit. NJSCVI ishte kryesisht e fokusuar në realizimin e pyetësorëve të studentëve. <i>[Referenca: 1.5_ Organigrama UV Ismail Qmali.pdf; 3.3_Vendim senati Nr 8 date 14.02.2018.pdf; 3.4_Vendim Senati nr. 52 datë 20.04.2017.pdf]</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron. Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e	GVJ konstaton se Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit si njësi bazë përgjegjëse për këtë program studimi, në bashkëpunim të ngushtë me grupin mësimor të Kontabilitetit kanë si fokus kryesor rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes së personelit akademik dhe studentëve për cilësinë e këtij programi. Departamenti dhe grupi mësimor përkatës mbështeten në punën e tyre, në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies nga zyra e NJSCVI. GVJ vlerëson se pedagogët e departamentit janë të angazhuar në

<p>metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>përditësimin dhe përmirësimin e syllabuseve të lëndëve të këtij programi, si dhe teknikave dhe metodave inovative të mësimdhënies.</p> <p>Përzgjedhja e stafit dhe përcaktimi i lëndëve ku do angazhohen është bazuar në kompetencat dhe profesionalizmin përkatës.</p> <p>Gjithashtu, analiza e punës vjetore të departamentit është në funksion të përmirësimit të cilësisë së programit.</p> <p>Duke ju referuar udhëzuesit mbi zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies, të hartuar dhe miratuar nga UV më datë 13.01.2020, konstatohet se institucioni nxit dhe promovon mësimdhënien me “studentin qendër” duke konsideruar përvojat më të mira të UV dhe institucioneve të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p>Gjithashtu vihet theksi në përdorimin e TIK në mësimdhënie, si dhe mekanizma të tjerë bashkëkohorë (platforma) në funksion të fushës së studimit për secilën njësi përbërëse të UV.</p> <p>GVJ konstaton se UV nxit stafin akademik dhe administrativ që në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione të ndryshme ndërkombëtare të aplikojë për mobilitete dhe trajnime, duke ndikuar në përthithjen dhe adaptimin e metodave inovative në procesin mësimor.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca N-Udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p> <p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe atë të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion konstatohet se UV është i angazhuar në rritjen e numrit të projekteve dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione ndërkombëtare. Pjesëmarrja në këto projekte ndikon në trajnimin e stafit akademik dhe administrativ. Këto projekte i nxisin realizimin e studimeve shkencore të përbashkëta (rajonale) duke ndikuar në rritjen e cilësisë së kërkimit shkencor.</p> <p>Në planin e punës të NJSCVI parashikohej që për këtë vit akademik të vazhdojë organizimi i trajnimeve për shkrim projektesh si për stafin akademik, edhe për stafin administrativ. Gjithashtu, NJSCVI punon për të nxitur edhe përfshirjen e studentëve, veçanërisht të atyre që kanë eksperiencë të mëparshme nga programet Erasmus +.</p> <p>GVJ konstaton se UV investon në financimin e konferencave dhe artikujve shkencorë të stafit akademik, në funksion të rritjes së kompetencave të tyre shkencore dhe mësimdhënëse. <i>[Referenca: Evidenca D- Strategjia e Ndërkombëtarizimit.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p> <p>Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe atë të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion konstatohet se stafi akademik i mbështetur edhe nga stafi administrativ ndihmës janë përgjegjës dhe angazhohen në mënyrë aktive në realizimin e një programi sa më cilësor dhe formues.</p> <p>Në mbledhjet e grupeve mësimore, si dhe të departamentit diskutohet për përmirësimin e syllabuseve, përshtatjen e tyre me nevojat e tregut si dhe me përdorimin e metodave të reja të mësimdhënies. Stafi akademik sjell eksperiencë pozitive të cilat eksperimentohen dhe në qoftë se kanë</p>

testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	feedback pozitiv (veçanërisht nga studentët) adaptohen edhe nga pedagogë të tjerë. GVJ vlerëson bashkëbisedimet me studentët, gjatë orëve të mësimit dhe më gjerë, si dhe kontaktet e tyre më këshilluesin akademik, si një instrument shumë i mirë për të testuar përdorimin e teknikave dhe metodave të reja.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.5	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Kriteret dhe mënyra e testimit dhe vlerësimit të njohurive përcaktohen në rregulloren e programit “Bachelor në Kontabilitet”, rregulloren e Departamentit të Financës dhe Kontabilitetit dhe rregulloren e UV.</p> <p>GVJ konston se të gjitha këto dokumenta janë të publikuar në faqen zyrtare ëeb të UV dhe mund të aksesohen lehtësisht nga studentët që ditën e parë që vendosin të fillojnë studimet në programin “Bachelor në Kontabilitet”. Mënyrat e kontrollit të dijeve dhe vlerësimit përcaktohet në syllabusin e çdo lënde dhe i bëhen të njohura studentit në fillim të procesit mësimor nga pedagogu i lëndës.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca C- Rregullore UV-se e ndryshuar.pdf; 2.1_Regullore e Departamentit të Financës dhe Kontabilitetit.pdf; 1.6_ Përmbledhese e syllabuseve të prog. stud. Bachelor në Kontabilitet Viti Akademik 2019 - 2020.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p> <p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Studentët njihen me format e kontrollit të dijeve në rregulloret e përmendura në kriterin e mësipërm.</p> <p>Përveç mundësisë për t’u njohur me format e kontrollit të dijeve nëpërmjet informacionit në rregulloret në faqen zyrtare ëeb të UV, në fillim të çdo lënde studentëve ju paraqitet syllabusi i lëndës nga titullari i saj.</p> <p>Duke ju referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe atij të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se në syllabus janë përcaktuar qartë mënyra dhe format kryesore të kontrollit për vlerësimin e nivelit të dijeve që studenti ka përvetësuar gjatë zhvillimit lëndës.</p> <p>Vlerësimi në pjesën më të madhe të lëndëve ndahet në Vlerësim të Vazhduar dhe Vlerësim përfundimtar. Vlerësimi i vazhduar, në përgjithsi përbën 20-30% të totalit të pikëve (vlerësimi i vazhduar fillon nga 0% dhe arrin deri në 50%). Ai konsiston në dy elementë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Aktivizimi dhe pjesëmarrja në veprimtaritë mësimore në auditor; ▪ Kontrolli i dijeve ku përfshihen: provimi i ndërmjetëm ose detyra e kursit. Detyrat e kursit mund të jenë individuale ose në grupe 2-3 studentë duke nxitur në këtë mënyrë punën në grup dhe të menduarit

	<p>kritik, por duke respektuar autonominë e studentit.</p> <p>Tezat e provimit hartohen nga titullari i modulit dhe miratohen nga përgjegjësi i departamentit. Në ndihmë për studentin vjen dhe platforma UVMS ku studenti gjen informacion për vlerësimin e vazhduar, detyrimet përpara dhënies së provimit, vlerësimin përfundimtar, si dhe notën përkatëse.</p> <p>Studenti ka të drejtën e ankimit nëse është i pakënaqur me vlerësimin e bërë. Kërkesa e tij shqyrtohet dhe i jepet përgjigje brenda 48 orësh.</p> <p>Nga takimi me studentët u konstatua se studentët ishin të kënaqur me faktin që përgjigja për notën e provimit jepej brenda 48 orësh dhe ndërkohë bëhej edhe rishikimi i provimit brenda 48 orësh nga dorëzimi i kërkesës për rishikim.</p> <p>[Referenca: Evidenca C- Rregullore UV-se e ndryshuar.pdf; 2.1_Regullore e Departamentit të Financës dhe Kontabilitetit.pdf; 1.4_Rregullore e programit të studimit Bachelor në Kontabilitet.pdf; 1.6_Përmbledhëse e syllabuseve të prog. stud. Bachelor në Kontabilitet Viti Akademik 2019 - 2020.pdf]</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6	
Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.	<p>Bazuar në <i>Rregulloren e UV dhe rregulloren e programit “Bachelor në Kontabilitet”</i>, testimi dhe vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.</p> <p>Viti akademik lidhur me testimin e njohurive konsiston në tre semestra, ku ka mundësi vlerësimi njohurish për studentët: semestri i vjeshtës, semestri i pranverës dhe semestri i verës.</p> <p>Dekani ka të drejtën që në situata të veçanta, të përcaktuara në rregulloret e mësipërme dhe kryesisht me kërkesë të studentëve, të hapë sezona shtesë gjatë vitit akademik për të shlyer: provime të ndërmjetme, provime përfundimtare, provim përfundimtar në mbyllje të studimeve Bachelor dhe mbrojtje teme diplome.</p>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	<p>GVJ konstaton se testimi dhe vlerësimi i studentëve është një proces, të cilit i kushtohet rëndësi në këtë institucion.</p> <p>Institucioni ka përcaktuar kritere dhe procedura që ndiqen në vlerësimin e studentëve që të minimizohen format e ndryshme të abuzimit.</p> <p>Institucioni nuk ka vënë akoma në zbatim sisteme elektronike të vlerësimit. Është duke u diskutuar korrigjimi elektronik i provimeve, pasi stafi akademik e mbështet këtë metodë në funksion të korrigjimit të shpejtë të tyre, shmangien e subjektivizmit në vlerësim, si dhe zvogëlimit të marzhit të gabimit njerëzor në korrigjim.</p>
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i	<i>Rregullorja e programit “Bachelor në Kontabilitet”</i> ka të përcaktuar qartë

<p>njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>që komisionet e provimeve të lëndëve kanë në përmbajtje të tyre dy anëtarë (staf akademik), ku njëri prej tyre është titullari i lëndës.</p> <p>Komisioni i provimit të diplomës përbëhet nga pesë anëtarë.</p> <p>Komisionet e provimeve përcaktohen nga Përgjegjësi i Departamentit të Financë-Kontabilitetit.</p>
<p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>GVJ konstaton se në UV nuk zhvillohet asnjë provim me shkrim në mënyrë anonime, me sekretim apo kodifikim.</p> <p>Anëtarët e komisionit të provimit janë përgjegjës për mbarëvajtjen e provimit dhe titullari i lëndës për të gjithë procesin deri në afishimin e notës. Nuk ofrohet survejim i auditorëve me mjete të veçanta ose personel shtesë gjatë provimit. Gjithë përgjegjësinë gjatë zhvillimit të procesit të provimit e kanë anëtarët e komisionit të provimit.</p> <p><i>[Referenca: Vizita në Institucion]</i></p>
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Duke ju referuar takimeve të zhvilluara gjatë vizitës në UV, GVJ konstaton se për shkak se vlerësimi i studentit ndahet në vlerësim të vazhduar dhe përfundimtar, në vlerësimin e vazhduar studentit merren në konsideratë një sërë komentesh dhe opinionesh që pedagogu i ka gjykuar të nevojshme për të përmirësuar nivelin e përthithjes së informacionit që ofrohet në lëndë nga studentit.</p> <p>GVL vlerëson se komente dhe këshilla të ngjashme mund të ofrohen edhe pas provimit final të lëndës, por gjykon se marrin shumë më tepër kuptim kur ato jepen gjatë vlerësimit të vazhduar. Të gjithë komentet dhe këshillat e dhëna ndikojnë në përmirësimin e studentit për të ardhmen, si dhe për të rritur profesionalizmin e tij.</p>
<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.</p>	<p>Në syllabusin e çdo lëndë që u prezantohet studentëve ditën e parë të fillimit të lëndës, përfshihen edhe elementë që lidhen me shmangien e plagjiaturës, si dhe kopjimin në detyra apo provime.</p> <p>Gjithashtu në <i>Kodin e Etikës së UV dhe Rregulloren e Etikës së Kërkimit Shkencor dhe Publikimit në UV</i> janë të përcaktuara dispozita që dënojnë sjellje që lidhen me plagjiaturën, kopjimin dhe mashtrimin gjatë procesit mësimor.</p> <p>Pedagogët që janë anëtarë të komisionit të provimit kanë përgjegjësinë që gjatë provimit të mos kopjohet.</p>
<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>GVJ konstaton se vlerësimi i dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritën e çdo studentit. Rezultatet e kontrollit të dijeve, bazuar në <i>rregulloren e programit "Bachelor në Kontabilitet"</i>, dorëzohen brenda 48 orëve nga data e provimit.</p> <p>Në takimin me studentë u konfirmua që ata i merrnin përgjigjet e provimeve brenda 48 orëve. Në raste të veçanta kur pedagogët nuk arrinin të bënin korrigjimin e testeve brenda kësaj kohe, studentët lajmëroheshin në kohë dhe maksimumi i vonësës ishte 1-2 ditë.</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për</p>	<p>GVJ konstaton se nëpërmjet platformës UVMS, studentit merr informacion në lidhje me vlerësimin e vazhduar, vlerësimin përfundimtar me pikë dhe notën përfundimtare. I gjithë ky proces është transparent.</p>

<p>rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p> <p>Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Në rast se studenti është i pakënaqur me vlerësimin e bërë, ai ka të drejtën e ankimit.</p> <p>Bazuar <i>në rregulloren e UV dhe të programit të studimit “Bachelor në Kontabilitet”</i>, si fillim studenti ka të drejtë të konsultojë bashkë me lektorin e lëndës provimin e korrigjuar dhe të marrë të gjithë sqarimet e duhura për vlerësimin. Nëse nuk bie dakort me lektorin e lëndës, atëherë brenda 48 orësh nga data e rezultateve duhet të dorëzojë një ankesë me shkrim pranë përgjegjësit të departamentit. Ky i fundit ndërmerr të gjithë veprimet për sqarimin e studentit dhe kur nuk arrihet në një zgjidhje për situatën e krijuar vihet në dijeni Dekani i Fakultetit Ekonomik.</p> <p>Dekani ngre një komision ad-hoc për verifikimin e pretendimeve që ngre studenti. Komisioni ad-hoc merr vendimin në lidhje me vlerësimin e studentit dhe ky vlerësim është përfundimtar.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca C- Rregullore UV-se e ndryshuar.pdf; 2.1_Regullore e Departamentit të Financës dhe Kontabilitetit.pdf; 1.4_ Rregullore e programit të studimit Bachelor në Kontabilitet..pdf]</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p>Standardi III.7 Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Programi i studimit “Bachelor në Kontabilitet” është konceptuar të zhvillohet në 3 vite akademike. Lëndët e përfshira në këtë program janë të disiplinave të ndryshme duke ndikuar edhe në ndërdisiplinarinizimin e këtij programi.</p> <p>Duke ju referuar <i>planit mësimor të programit të studimit “Bachelor në Kontabilitet”</i> konstatohet se veprimtaritë formuese të programit: puna në auditor dhe jashtë tij janë përcaktuar në funksion të formimit të studentëve, në zhvillimin e aftësive profesionale dhe të veçanta të tyre.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>GVJ konstaton se ky program studimi garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit pasi në kurrikulën e tij janë të përfshirë lëndë të këtyrë fushave, në kategorinë e lëndëve plotësuese.</p> <p>Në kurrikulën e këtij program studimi, në kategorinë e lëndëve plotësuese përfshihen lëndët: kontabilitet i aplikuar, teknologji informacioni dhe komunikimi në ekonomi, shkrim akademik, gjuhë e huaj (të ndryshme - me zgjedhje). <i>[Referenca: 1.2_Plani Mësimor i Prog.stud. Bachelor Kontabilitet_2019 -2020.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo</p>	<p>Nga takimet e zhvilluara gjatë vizitës në UV, rezultoi se kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti analizohen me studentët gjatë bashkëbisedimit në auditor, në diskutimet e tyre me koordinatoren e programit, si dhe në</p>

<p>lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p>	<p>vlerësimin që rezulton nga plotësimi dhe përpunimi i pyetësorëve. Gjithashtu konstatohet se institucioni ka filluar të përfshijë në këtë vlerësim edhe rrjetin Alumni me ish studentë të UV, duke synuar zgjerimin e këtij rrjeti dhe rritjen e rolit të tij në UV. Kështu në 2019 është zhvilluar një workshop “Studentët dhe tregu i punës” me pjesëmarrje të Alumni. Ish studentë tashmë të punësuar pranë institucioneve publike dhe private sollën sugjerimet e tyre në përmirësimin e cilësisë së kurrikulës së programit. [Referenca:6.4_Relacion mbi workshopin me temë Studentët dhe Tregu i Punës.pdf]</p>
<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.</p> <p>Kriteri 5. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Nga takimet e zhvilluara gjatë vizitës në UV, rezultoi se në përfundim të çdo lënde pedagogu realizon një seancë konsultuese, gjatë së cilës orientohen studentët në lidhje me çështjet ku do të përqëndrohet përgatitja e tyre për provimin përfundimtar. Gjatë kësaj seance trajtohen çështje apo koncepte ku studentët mund të kenë hasur vështirësi, struktura e përgjithshme e tezës dhe udhëzime të tjera lidhur me natyrën e pyetjeve dhe familjarizimin me situatën e provimit përfundimtar.</p> <p>GVJ konstaton se UV nxit realizimin e orëve të hapura me studentët me ekspertë të fushave të ndryshme. Në këtë kuadër, Fakulteti Ekonomik, Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit, në bashkëpunim me zyrën e Burimeve Njerëzore ftojnë personalitete dhe ekspertë të ekonomisë për të organizuar orë të hapura mbi zhvillimet e reja në ekonomi. [Referenca: 3.15.1_ Leksion i hapur_Natasha Ahmetaj.pdf]; 3.15_ Leksion i hapur_Louis Delcart.pdf]</p>
<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Institucioni ka vënë në dispozicion të këtij programi studimi në godinën A një laborator ku zhvillohen kryesisht orë praktike në funksion të lëndës së Kontabilitetit të Aplikuar.</p> <p>Laboratori mund të përdoret nga studentët për përgatitjen e detyrave të kursit dhe për punimet e diplomës.</p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.</p> <p>Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.</p> <p>Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në atë të marrë në takimet gjatë vizitës në UV, konkludohet se në përgjithësi, por edhe në veçanti në këtë program studimi vihet theksi tek autonomia apo puna e pavarur e studentit. GVJ konstatoi se nxitet puna në grup e studentëve në përgatitjen e detyrave të kursit (2-3 studentë) dhe se gjatë orëve të mësimin analizohen raste studimorë nga tregu shqiptar apo i huaj, të mbështetura nga diskutimet në grup që ndikojnë në formimin e studentëve.</p> <p>GVJ konstaton se UV nxit zhvillimin e ideve inovatore dhe studimet kërkimore e shkencore të studentëve nëpërmjet organizimit të konferencave studentore.</p> <p>Gjithashtu në fokus të Sektorit të Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë është përfshirja e studentëve në projektet e ndryshme të UV. Për shembull ata janë përfshirë në projektin Integrated Sustainable Development of Southern Coastal Region financiar nga Giz Albania.</p> <p>GVJ konstaton se mbështetja financiare e studentëve ka qenë modeste, pasi këshilli studentor që është edhe struktura përcjellëse e kërkesave të studentëve për financim në UV dhe parashikimin në buxhetin vjetor apo afatmesëm është krijuar rishtaz.</p>

<p>Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe atë të marrë në takimet gjatë vizitës në UV, konstatohet se Sektori i Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë ka për qëllim rritjen e bashkëpunimit me institucione ndërkombëtare. Në kuadër të këtyre bashkëpunimeve, përfshirë edhe projektet ndërkombëtare realizohen një numër mobilitetesh në mësimdhënie dhe trajnime të cilët kanë mundësuar shkëmbimin e përvojës dhe përfitimin e praktikave, të cilat përgjithësisht adaptohen nga personeli akademik pas rikthimit në institucion. Gjithashtu konsiderohen edhe eksperiencat e studentëve që kanë realizuar mobilitete jashtë.</p> <p>Në këtë program studimi nuk kishte studentë që të kishin kryer mobilitete jashtë vendit, por kishte studentë që kishin kryer mobilitete dhe vazhdonin një nga programet që ofronte departamenti i Financës dhe Kontabilitetit (psh Bachelor në Financë).</p> <p>Në takimin me studentët e programit të studimit, gjatë vizitës në institucion, pyetjes që ju bë studentëve se përse nuk kanë preferuar të kryejnë mobilitete, ata iu përgjigjën se e kishin të vështirë procesin; kishin mangësi në njohjen e gjuhës angleze në nivel të lartë; si dhe për shkak të mos-ekuivalentimit/humbjes së krediteve në rast të mospërputhjes së programeve me shkollat pritëse etj. <i>[Referenca: Evidenca D- Strategjia e Ndërkombëtarizimit.pdf; Evidenca H- Rregullore per implementimin e ICM-ve.pdf]</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi III.8</p> <p>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe atë të marrë në takimet gjatë vizitës në UV, konstatohet se procedura e provimit final ose mbrojta e diplomës përcaktohen në rregulloren e programit të studimit “Bachelor në Kontabilitet”.</p> <p>Kjo rregullore është e publikuar në faqen zyrtare ëeb të UV ku studentët mund të aksesojnë të gjithë materialin e nevojshëm në lidhje me procesin e diplomimit.</p> <p>Për çdo pyetje apo paqartësi ata mund të diskutojnë me kordinatorin e programit si edhe stafin akademik të departamentit për të marrë sqarimet e nevojshme.</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së</p>	<p>GVJ konstatoi se pedagogu udhëheqës, pedagogët e departamentit dhe sekretaria mësimore informon studentët e këtij programi në lidhje me udhëzime e materiale në funksion të realizimit dhe mbrojtjes së diplomës, si dhe përgatitjes për provimin final.</p> <p>Në rastin e mbrojtjes së diplomës, studenti udhëzohet për temën e zgjedhur, metodologjinë e përdorur dhe literaturën, deri në përfundimin e</p>

<p>diplomës.</p> <p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>saj. Kurse në rastin e provimit, studentëve u ofrohet banka e pyetjeve për t'u përgatitur.</p> <p>Në provimin final testohen njohuritë profesionale të dhëna gjatë tri viteve akademike të këtij programi studimi.</p> <p>Në rregulloren e këtij programi studimi është përcaktuar që banka e pyetjeve do të jetë nga lëndët me kodin FIN përveç atyre me zgjedhje, duke përfshirë 10-15 pyetje për çdo lëndë. <i>[Referenca: 1.4_ Rregullore e programit të studimit Bachelor në Kontabilitet.pdf; 3.23_Procedurë Diplomimi.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/diplomave.</p> <p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Pedagogu udhëheqës dhe pedagogët e departamentit në rastin kur studenti përfundon studimet duke mbrojtur diplomë, e udhëzojnë për temën e zgjedhur, metodologjinë e përdorur dhe literaturën, deri në përfundimin e saj. Kurse në rastin kur përfundimi i studimeve bëhet me provim, studentëve u ofrohet banka e pyetjeve për t'u përgatitur, minimalisht 2 muaj para datës së provimit.</p> <p>Studentit që përgatit diplomë, i vihet në dispozicion laboratorit ku janë të instaluar programet MS Office, Finance 5 dhe SPSS në mënyrë që t'i lehtësohet ky proces.</p> <p>Ndërkohë UV u siguron studentëve që përgatisin diplomë, bazën e të dhënave në sajë të marrëveshjeve që ky institucion ka me institucionet publike dhe private në qytetin e Vlorës.</p>
<p>Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe atij të marrë në takimet gjatë vizitës në UV, rezultoi se udhëheqësi i diplomës asiston studentin në fushën e tij të kërkimit dhe realizimit të punimit, që nga miratimi i tij si drejtues punimi dhe deri në fazën përmbyllëse të tij. Ai udhëzon studentin në lidhje me literaturën e konsultuar, metodologjinë e punimit dhe analizën e të dhënave. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton punimin përpara mbrojtjes finale, duke përgatitur dhe dorëzuar edhe një vlerësim me shkrim për të. Vlerësimi i pedagogut udhëheqës është një komponent i rëndësishëm në vlerësimin final të studentit. <i>[Referenca: 1.4_ Rregullore e programit të studimit Bachelor në Kontabilitet.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Provimi përfundimtar në mbyllje të studimeve “Bachelor në Kontabilitet” është provim me gojë, që jepet para një jurie me 5 anëtarë. Në përfundim të përgjigjeve për pyetjet që janë në tezën që zgjedh studentin, secili prej anëtarëve të komisionit bën vlerësim me notë dhe nota përfundimtare është një mesatare aritmetike e notave të secilit anëtar të jurisë.</p> <p>Mbrojtja e diplomës bëhet me prezantim para jurisë. Në përfundim pas ezaurimit të seancës së pyetjeve dhe komenteve, mbështetur në prezantimin e punimit, vlerave të tij si dhe vlerësimit të udhëheqësit, komisioni vendos notën finale me të cilën vlerëson punimin e diplomës.</p> <p><i>[Referenca: 1.4_ Rregullore e programit të studimit Bachelor në Kontabilitet.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>GVJ konstaton se në përfundim të studimeve në programin “Bachelor në Kontabilitet”, mbasi studentin ka përfunduar të gjitha detyrimet e programit të studimit, si dhe detyrimet financiare ndaj UV pajiset me diplomën përkatëse, suplementin e diplomës dhe listën e notave sipas</p>

Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	formatit të miratuar nga MASR. Suplementi i diplomës është në përputhje me kërkesat e hapësirës evropiane të arsimit të lartë. Me kërkesë të studentëve vihet në dispozicion të tyre kurrikula e plotë me syllabuset për të gjitha lëndët e përfshira në programin e studimit. [Referenca: 3.24_Model diplome bachelor në kontabilitet_opt.pdf; 2.11_Suplementi i diplomës Bachelor në Kontabilitet_opt.pdf]			
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.	Dokumentacioni i studentëve ruhet nga UV për një periudhë të pacaktuar që nga koha e regjistrimit në programin e studimit deri në përfundim të studimeve. Regjistri i studentëve plotësohet elektronikisht dhe në formë të shkruar dhe mbahet në ruajtje të përhershme. Çdo dokumentacion është i arkivuar në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësimor-shkencor dhe administrativ.	Duke ju referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe atij të marrë gjatë vizitës në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë (UV), GVJ konkludon se struktura përgjegjëse për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit të angazhuar në programin e studimit “Bachelor në Kontabilitet” është sektori i Burimeve Njerëzore dhe Protokoll Arkivës - në varësi të Drejtorisë së Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore. Gjatë vizitës pranë kësaj strukture, të riorganizuar sipas vendimit për strukturën organizative të UV nr.8/2018 të Senatit Akademik përkatës, GVJ konstatoi se sektori i Burimeve Njerëzore dhe Protokoll Arkivës mban të dhëna në formën e dosjeve personale (format letër) për të gjithë personelin me kohë të plotë ose me kontratë dhe i përditëson ato sipas nevojës.
Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.	Bazuar në informacionin e dosjes së vetëvlerësimit, faqen web të universitetit dhe në informacionin e siguruar nga vizita në institucion, GVJ konstatoi se procedurat e rekrutimit të personelit akademik janë në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe statutin e UV.
Kriteri 3. Institucioni harton	Kriteret e përgjithshme dhe specifike të rekrutimit të personelit akademik

<p>procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p> <p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë për zgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>publikohen në faqen zyrtare ëeb të universitetit dhe janë në përputhje me specifikat e programit të studimit. Në publikim paraqiten edhe procedurat e nevojshme në rast ankimimi, në përputhje me kuadrin ligjor dhe statutin e UV.</p> <p>Nga verifikimi me zgjedhje i dy dosjeve personale pranë sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Protokoll Arkivës, GVJ konstatoi plotësinë e tyre dhe se në përfundim të procesit të rekrutimit dokumenti i publikuar me kriteret e punësimit (për një të punësuar rishtaz) bëhet pjesë e dosjes personale të arkivuar pranë sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Protokoll Arkivës. Gjithashtu gjatë kësaj vizite GVJ siguroi listën e plotë të përditësuar të stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi gjatë tre viteve të fundit. <i>[Referenca: Evidenca A- Statuti i UV-së.pdf; Evidenca C- Rregullore UV-se e ndryshuar.pdf; RVB-Bachelor në Kontabilitet.pdf; 1.5_Organigrama UV Ismail Qemali.pdf; 3.17_Procedure punesimi.pdf; vizita në institucion]</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi IV.2</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efçente dhe efektive</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>Bazuar në informacionin e dosjes së vetëvlerësimit, takimet e realizuara dhe informacionet e marra gjatë vizitës në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë (UV), GVJ konstatoi se institucioni është i angazhuar në krijimin e një mjedisi të përshtatshëm pune dhe me mundësi të barabarta për të gjithë personelin e angazhuar në programin e studimit “Bachelor në Kontabilitet”.</p> <p>Godina në të cilën zhvillohen aktivitetet mësimore dhe të tjera, të këtij programi studimi është e ristrukturuar dhe e pajisur me infrastrukturën e nevojshme për një realizim sa më profesional dhe efçent të detyrave nga personeli i angazhuar në këtë program. <i>[Referenca: Evidenca A- Statuti i UV-së.pdf; Evidenca C- Rregullore UV-se e ndryshuar.pdf; Evidenca E- Kodi i Etikës.pdf; Evidenca Infrastruktura.PDF; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>Programi i studimit “Bachelor në Kontabilitet” administrohet nga Departamenti i Financë - Kontabilitetit, i Fakultetit të Ekonomisë të UV. Në takimin me stafin akademik të programit të studimit, GVJ konstatoi angazhimin dhe mbështetjen e UV për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik nëpërmjet përfshirjes në marrëveshje bashkëpunimi dhe shkëmbimi me institucione partnere ndërkombëtare dhe kombëtare në nivel kërkimi, mësimdhënieje dhe projektesh të ngjashme.</p> <p>Gjithashtu, gjatë këtij takimi stafi akademik dëshmoi edhe për mbështetjen financiare të marrë për pjesëmarrje në konferenca shkencore dhe publikime në revista shkencore në përputhje me statutin e institucionit. <i>[Referenca: 2.1_Rregullore e Departamentit te Finances dhe Kontabilitetit.PDF; 2.12_Raporti</i></p>

	<i>vjetor 2018-2019 i Departamentit te Finances dhe Kontabilitetit.PDF; 1.3_Plani strategjik i programit te studimit Bachelor ne Kontabilitet.PDF; vizita në institucion]</i>			
Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB si dhe në informacionin e marrë nga takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se aktualisht UV nuk organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies dhe përdorimit të teknologjive të reja me qëllim kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor. Nisur nga moshja mesatare e stafit akademik dhe jo akademik, si dhe nevoja për të përballuar ngarkesë mësimore dhe jo mësimore të rëndësishme, GVJ gjykon si të domosdoshme organizimin e programeve specifike për metodat e mësimdhënies dhe përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm të tyre.			
Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB si dhe në informacionin e marrë nga takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se aktualisht stafi akademik me kohë të plotë i departamentit të Financës dhe Kontabilitetit, mbulon mesatarisht 3-6 lëndë (në të gjitha programet dhe nivelet e studimit) me një ngarkesë totale orare të që varion nga 1.5 deri në 3 herë ngarkesën bazë të përcaktuar nga VKM përkatëse. GVJ gjykon se pavarësisht se kjo është tashmë një praktikë e përhapur dhe e pranuar në universitetet publike dhe numri aktual i studentëve në këtë program studimi është i ulët, një ngarkesë e tillë mund të çënojë realizimin cilësor të objektivave të programit të studimit dhe të personelit akademik të angazhuar. [Referenca: RVB-Bachelor në Kontabilitet.pdf -Tabela 4 Ngarkesa totale e personelit akademik etj; 1.2_Plani Mesimor i Prog.stud. Bachelor Kontabilitet_2019 -2020.PDF; 4.2.1 Evidence e realiz. te kohes vjetore te punes.PDF; 4.2_ Evidence e planif. te kohes vjetore te punes.PDF; vizita në institucion]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	GVJ konstatoi se programi i studimit “Bachelor në Kontabilitet” i zhvillon aktivitetet mësimore në godinën e Fakultetit të Ekonomisë të UV, të rikonstruktuar rishtazi dhe të pajisur me infrastrukturën e nevojshme për një mësimdhënie dhe mësimnxënie sa më cilësore. Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB si dhe në informacionin e marrë nga takimet me stafin akademik dhe studentët e këtij programi studimi, gjatë vizitës në institucion, GVJ konfirmoi se mësimi zhvillohej gjatë ditëve të javës, në orarin 8.00-14.00. Gjithashtu në
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa,	

<p>laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>takime u deklarua se për shkak të numrit të vogël të studentëve në këtë program studimi bashkoheshin leksionet e përbashkëta me programet e tjera të nivelit bachelor dhe pedagog të njëjtë.</p> <p>Studentët konfirmuan që leksionet dhe prezantimet e tjera zhvilloheshin duke përdorur edhe mjete audiovizive të cilat disponoheshin nga pedagogu i departamentit përkatës përgjegjës për mbulimin e lëndës. <i>[Referenca: RVB-Bachelor në Kontabilitet.pdf; Evidenca Infrastruktura.PDF; vizita në institucion]</i></p>			
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, ateliet apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p> <p>Kriteri 4. Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se në funksion të programit të studimit “Bachelor në Kontabilitet” shërben një laborator kompjuterash me të paktën 25 vende pune aktive.</p> <p>Pranë këtij laborator studentët ushtrohen në programe aplikative si “Financa 5” dhe SPSS si dhe mund ta përdorin për realizimin e detyrave të kursit të parashikuara në lëndë të ndryshme të programit të studimit.</p> <p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB si dhe në informacionin e marrë nga takimet me stafin akademik dhe studentët e këtij programi studimi, gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se përdorimi aktiv i laboratorit është i kufizuar pasi programet e sipërcituara janë në versionin “demo”. <i>[Referenca: RVB-Bachelor në Kontabilitet.pdf; Evidenca Infrastruktura.PDF; vizita në institucion]</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.</p>	<p>Aktualisht programi i studimit “Bachelor në Kontabilitet” nuk parashikon në planin mësimor të miratuar zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.</p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p> <p>Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë</p>	<p>Duke ju referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se UV vë në dispozicion të gjithë studentëve të regjistruar pranë këtij universiteti bibliotekën e organizuar në disa ambiente kundrejt një anëtarësimi me kartelë identifikimi me foto.</p> <p>Studentët e Fakultetit të Ekonomisë frekuentojnë kryesisht sallën A të Bibliotekës, e cila ndodhet pranë ambienteve ku zhvillohet edhe procesi mësimor i këtij programi studimi.</p>

<p>ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Nga vizita në këtë bibliotekë dhe informacioni i marrë më pas, rezultoi se biblioteka disponon literaturë fizike të nevojshme në mbështetje të këtij programi studimi dhe të programeve të tjera të Fakultetit të Ekonomisë si: tekste mësimore bazë në gjuhën shqipe; tekste mësimore dhe materiale ndihmëse në gjuhë të huaj; botime e monografi të UV; libra, revista dhe botime të institucioneve të tjera; e cila mund të shfrytëzohet njëlloj nga të gjithë studentët dhe stafi i universitetit. <i>[Referenca: Evidenca A- Statuti i UV-së.pdf; Evidenca C- Rregullore UV-se e ndryshuar.pdf; RVB-Bachelor në Kontabilitet.pdf; Evidenca Infrastruktura.PDF; 4.4_Informacion mbi funksionimin e bibliotekes.pdf; vizita në institucion]</i></p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Aktualisht UV është pjesë e projektit të MASR për ofrimin e shërbimeve të bibliotekës on-line për universitetet publike “ULIBRARY”. Përmes adresës http://ulibrary.rash.al/, studentët mund të kërkojnë për artikuj, studime, apo botime të tjera sipas fushës së interesit bazuar në identifikimin e përzgjedhur në universitetin ku janë regjistruar. <i>[Referenca: 4.3_Manuali i aksesit online te bibliotekes.PDF; https://univlora.edu.al/biblioteka/]</i></p>			
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe nga vizita në bibliotekë, GVJ konstatoi se Salla A e bibliotekës nuk është e pajisur me programe kompjuterike dhe një pjesë e literaturës është ende në proces katalogimi manual. GVJ gjykon se mungesa e një sistemi të përshtatshëm katalogimi të bibliotekës vështirëson shfrytëzimin e saj pa kufizime nga ana e studentëve.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB si dhe në informacionin e marrë nga takimet me stafin akademik të Departamentit të Financës dhe Kontabilitetit, GVJ konkludon se institucioni nuk ka një plan të detajuar për shtimin e zërave/titujve në fondin e bibliotekës por ndjek një procedurë përditësimi sipas mundësisë (disponibilitetit buxhetor). Zakonisht një herë në vit njësitë bazë përcjellin kërkesat e stafit të tyre lidhur me titujt për të cilët kanë interes.</p> <p>GVJ gjykon se hartimi i një plani të detajuar dhe organizuar për shtimin e zërave të bibliotekës në funksion të programeve të studimit mundëson shfrytëzimin optimal të fondeve buxhetore në dispozicion.</p>			
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>GVJ konstaton se oraret e shërbimit të bibliotekës (nga e hëna-të premtë dhe orari 8.00-20.00) janë në përputhje me nevojat e studentëve të këtij program studimi por edhe të studentëve të tjerë të UV.</p> <p><i>[Referenca: https://univlora.edu.al/biblioteka/; vizita në institucion]</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik,

financiar e administrativ për programet e studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në takimet e zhvilluara gjatë vizitës në UV, GVJ konstaton se sekretaria mësimore pranë departamentit të Financës dhe Kontabilitetit është struktura që administrojnë të gjithë informacionin lidhur me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim për këtë program studimi. Gjatë vizitës në sekretari GVJ verifikoi me zgjedhje dosjen e plotë të dy studentëve të programit të studimit “Bachelor në Kontabilitet” dhe përdorimin e regjistrave përkatës sipas kërkesave të kuadrit ligjor në fuqi.</p> <p>Gjithashtu, GVJ konstatoi se UV përdor dhe një sistem të kompjuterizuar të menaxhimit të informacionit UMVS (ndryshe platforma UMVS), i cili funksionon në bazë të moduleve dhe ofrimit të shërbimeve sipas kategorive të ndryshme të përdoruesve. Aktualisht pjesa më funksionale e platformës UMVS është moduli i studentëve. Manuali i përdorimit i publikuar në faqen web të UV, sqaron përdorimin e platformës nga ana e studentëve, ndërsa Sektori i Shërbimeve Teknologjike dhe Zhvillimit (në varësi të Drejtorisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit Institucional) kujdeset për mirëfunksionimin e kësaj platforme dhe përdorimin e autorizuar nga ana e përdoruesve.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca A- Statuti i UV-së.pdf; Evidenca C- Rregullore UV-se e ndryshuar.pdf; RVB-Bachelor në Kontabilitet.pdf; 1.4_ Rregullore e programit të studimit Bachelor në Kontabilitet.PDF; 2.5_Procedurat e pranimit të studentëve të rinj.PDF; 3.20_Manual për përdorimin e struktureve të teknologjisë së informacionit_opt.pdf; 5.7_Vendim i Senatit, Nr. 101, date 06.12.2017.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Duke ju referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe të marrë në takimet gjatë vizitës në UV, GVJ konstatoi se administrimi i informacionit për personelin e angazhuar në programin e studimit “Bachelor në Kontabilitet” realizohet kryesisht nga sektori i Burimeve Njerëzore dhe Protokoll Arkivës në formën e dosjes personale të personelit. Ndërsa Sektori i Promovimit Akademik dhe Botimeve Shkencore - në varësi të Zv. Rektorit për Kërkimin Shkencor dhe Zhvillimin Institucional, së bashku me njësinë bazë përkatëse merret me administrimin e informacionit lidhur me aktivitetin shkencor të personelit akademik.</p> <p>Platforma UVMS parashikon një modul për këtë lloj informacioni por ky modul nuk është ende funksional. <i>[Referenca: RVB-Bachelor në Kontabilitet.pdf; 3.20_Manual për përdorimin e struktureve të teknologjisë së informacionit_opt.pdf; 3.8_Shkresa Nr. 2051 date 14.02.2018.PDF; 5.7_Vendim i Senatit, Nr. 101, date 06.12.2017.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p> <p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në takimet e zhvilluara gjatë vizitës në UV, GVJ konstatoi se platforma UVMS është e organizuar për të ofruar akses të dedikuar për të gjitha kategoritë e përdoruesve të planifikuar në këtë platformë.</p> <p>Aktualisht shkëmbimet e informacionit ndërmjet përdoruesve të platformës përqendrohen kryesisht në përdorimin e platformës për konsultimin e informacioneve apo dokumenteve si orari mësimor, programi mësimor,</p>

module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	lëndët, listat e notave, krediteve, plotësimi dhe grumbullimi i pyetësorëve/anketimeve të ndryshme, fatura për tarifa regjistrimi etj. Përdorimi i platformës për aktivitete të tjera administrimi është relativisht i kufizuar ose mungon fare. [Referenca: RVB-Bachelor në Kontabilitet.pdf; 3.20_Manual per perdorimin e struktures se teknologjise se informacionit_opt.pdf; 5.7_Vendim i Senatit, Nr. 101, date 06.12.2017.pdf; vizita në institucion]			
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	GVJ vlerëson se nëse platforma UVMS do të plotësohet dhe funksionojë me të gjitha modulet e saj të parashikuara në versionin e plotë do të arrijë të garantojë monitorimin në kohë reale të aktivitetit akademik dhe administrativ si dhe do të mundësojë raportime dhe statistika të plota sipas nevojës. Gjithashtu GVJ konstaton se monitorimi i aktivitetit akademik dhe administrativ vijon sipas strukturave të përmendura më sipër (kriteri 1 dhe 2 i këtij standardi) dhe se mungojnë analiza statistikore për ecurinë akademike dhe administrative, përveç pyetësorëve me opinione të studentëve. [Referenca: RVB-Bachelor në Kontabilitet.pdf; 3.20_Manual per perdorimin e struktures se teknologjise se informacionit_opt.pdf; 3.8_Shkresa Nr. 2051 date 14.02.2018.PDF; 5.7_Vendim i Senatit, Nr. 101, date 06.12.2017.pdf; vizita në institucion]			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Në takimin me përfaqësuesen e Sektorit të Shërbimeve Teknologjike dhe Zhvillimit, gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se funksionimi i kufizuar i faqes zyrtare web të UV, ishte i përkohëshëm për shkak të një përditësimi të rëndësishëm që pritej të përfundonte brenda muajit mars. Aktualisht faqja web e UV ofron informacion në dy gjuhë (shqip dhe anglisht) për të gjitha programet e studimit, personelin, aktivitetet e ndryshme etj. [Referenca: https://univlora.edu.al/fakulteti-i-ekonomise/]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.6	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në takimet e zhvilluara gjatë vizitës në UV, GVJ konstatoi se institucioni nuk harton raporte financiare të kostove sipas programeve të studimit por vetëm në nivel universiteti dhe për periudha vjetore që përkohjnë me vitin buxhetor, i cili fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Raportet financiare janë kryesisht në formën e situacioneve vjetore për shpenzimet e kryera dhe të akt-rakordimeve për të ardhurat me degën e thesarit. Raportet përgatiten nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse dhe janë pjesë e raportit vjetor që miratohet nga Bordi i Administrimit dhe Senati Akademik i UV. Në këto raporte theksohet se “...kostoja e një studenti mbi bazën e të cilës referohet vendosja e tarifave të shkollimit që duhet të paguajë një student rezulton më e lartë se në Universitetet e tjera Rajonale...” por nuk sqarohet se sa është kjo kosto në vlera monetare dhe si është përlllogaritur. [Referenca: Evidenca I- Raporti vjetor i UV per vitin 2017-2018.pdf; Evidenca J- Raporti vjetor i UV per

	viti 2018-2019.pdf ; 2.12_Raporti vjetor 2018-2019 i Departamentit te Finances dhe Kontabilitetit.PDF ; 4.1_Projekt Buxheti i Fakultetit te Ekonomise 2020-2021.PDF ; 4.5_Te dhena per kostot e programit te studimit.pdf ; Informacion shtese.pdf ; vizita në institucion]
Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.	Sipas statutit të UV projektbuxheti i vitit pasardhës hartohet nga Administratori i UV në përputhje me propozimet e bëra prej njërive kryesore dhe njërive bazë dhe në zbatim të planit buxhetor afatmesëm të miratuar nga Bordi i Administrimit i UV. Në takimin me stafin akademik të programit, GVJ konfirmoi se njëria bazë si pjesë të analizës vjetore përfshin dhe propozimet për parashikime financiare në funksion të programeve të studimit lidhur me investime në pajisje, infrastrukturë, pasurim literature etj. Në raportet financiare të sipërcituara shpenzimet janë të klasifikuara kryesisht sipas natyrës së tyre, ndërsa të ardhurat janë të klasifikuara sipas burimeve të parashikuara të financimit si: buxheti i shtetit, pagesat e studentëve, të ardhura nga shërbimet dhe veprimtari të tjera si dhe të ardhura nga donacione etj. [Referenca: Evidenca A- Statuti i UV-së.pdf ; 2.12_Raporti vjetor 2018-2019 i Departamentit te Finances dhe Kontabilitetit.PDF ; 4.1_Projekt Buxheti i Fakultetit te Ekonomise 2020-2021.PDF ; 4.5_Te dhena per kostot e programit te studimit.pdf ; Informacion shtese.pdf ; vizita në institucion]
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.	Duke ju referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në UV, GVJ konstatoi se institucioni i nënshtrohet auditimit të përvitshëm nga Sektori i Auditit të Brendshëm në varësi të Bordit të Administrimit të UV. Raportet e auditimit të brendshëm kryesisht fokusohen në vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm si dhe vlerësimin e pajtueshmërisë së veprimtarisë së institucionit dhe njërive përbërëse me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi. Përsa i takon auditimit të jashtëm, nga verifikimi i faqes web të Kontrollit të Lartë të Shtetit nuk rezultoi ndonjë auditim i publikuar mbi UV për periudhën 2017-2019. [Referenca: RVB Bachelor në Kontabilitet.PDF ; 4.5_Te dhena per kostot e programit te studimit.pdf ; Informacion shtese.pdf ; vizita në institucion]
Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në informacionin e marrë gjatë vizitës në UV, GVJ konstatoi se institucioni nuk harton raporte financiare në mbyllje të një cikli të plotë studimi tre vjeçar, por në raportet e analizës vjetore në nivel institucioni analizohen të ardhurat dhe shpenzimet mbi bazë viti buxhetor dhe bëhet edhe një analizë krahasuese e realizimit të tyre kundrejt shumave të buxhetuara më parë. [Referenca: Evidenca I- Raporti vjetor i UV per vitin 2017-2018.pdf ; Evidenca J- Raporti vjetor i UV per vitin 2018-2019.pdf ; 4.5_Te dhena per kostot e programit te studimit.pdf ; Informacion shtese.pdf ; vizita në institucion]
Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të	Sipas statutit të UV burimet e financimit të universitetit janë: buxheti i shtetit; pagesat e studentëve për arsimimin; të ardhurat për shërbimet e kryera; të ardhurat e krijuara nga marrëdhëniet me palët e treta; donacione dhe burime të tjera ligjore financimi; si dhe të ardhurat nga veprimtari kërkimore shkencore.

mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.	<p>Udhëzimi i MF “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit” përcakton se fondet e buxhetit të shtetit për arsimin e lartë janë në formën e grantit që për çdo universitet shpërndahet në fillim të vitit buxhetor nga MASR. Më pas universitetet nëpërmjet organeve kolegjiale e detajojnë këtë grant sipas njësive shpenzuese dhe zërave përkatës të buxhetit të planifikuar prej tyre. Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në informacionin e marrë gjatë vizitës në UV, GVJ konstatoi se për periudhën 2017-2019 ecuria e të ardhurave të realizuara paraqitet si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Viti 2017 rreth 27% fonde të UV dhe 73% granti nga MASR; ▪ Viti 2018 rreth 32% fonde të UV dhe 64% granti nga MASR; ▪ Viti 2019 rreth 24% fonde të UV dhe 76% granti nga MASR. <p>[Referenca: Evidenca A- Statuti i UV-së.pdf; 4.1_Projekt Buxheti i Fakultetit te Ekonomise 2020-2021.PDF; 4.5_Te dhena per kostot e programit te studimit.pdf; Informacion shtese.pdf; vizita në institucion]</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p> <p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p> <p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në informacionin e marrë gjatë vizitës në institucion dhe nga faqja ëeb zyrtare e UV, GVJ konkludon se politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin akademik të studentëve janë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e tjera rregullatore.</p> <p>Barazia e të drejtave për kandidatët dhe studentët e programit të studimit garantohej edhe nga kërkesat (nenet) specifike të statutit të UV dhe të rregulloreve respektive të njësive bazë. Pranë Departamentit të Financës dhe Kontabilitetit ngrihet një komision që merret me përlllogaritjen e pikëve për çdo kandidat për student dhe hartimin e listës së fituesve bazuar në pikët e grumbulluara sipas programeve të studimit.</p> <p>Në takimin me studentët e këtij programi studimi dhe nga faqja web e UV, GVJ konstatoi se procedurat dhe kriteret e përdorura në përzgjedhjen e studentëve, në vlerësimin përgjatë ciklit të studimeve e</p>

<p>ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>më pas, deri në diplomim, janë lehtësisht të kuptueshme dhe të disponueshme për të gjithë të interesuarit. <i>[Referenca: Evidenca A- Statuti i UV-së.pdf; Evidenca C- Rregullore UV-se e ndryshuar.pdf; 2.1_Regullore e Departamentit te Finances dhe Kontabilitetit.PDF; 1.4_ Rregullore e programit te studimit Bachelor ne Kontabilitet.PDF; https://univlora.edu.al/fakulteti-i-ekonomise; vizita në institucion]</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p> <p>Kriteri 5. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p> <p>Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion dhe nga praktika lidhur me pranimin e studentëve të rinj për vitin akademik 2019-2020, GVJ konstaton se UV harton dhe publikon kriteret e veçanta dhe të përgjithshme për përzgjedhjen e kandidatëve për pranim sipas secilit program dhe cikël studimesh, çdo vit dhe në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.</p> <p>Parashikohen gjithashtu kuota për studentët e huaj dhe kategori të caktuara në përputhje me VKM përkatëse.</p> <p>Informimi i të gjithë të interesuarve në lidhje me UV, programet e studimit dhe kriteret e pranimin në to, aktivitetet promovuese të UV dhe të tjera, realizohet nga specialistët e Sektorit të Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë, strukturë në varësi të Drejtorisë së Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore. Këta specialistë kujdesen edhe për publikimin e të gjithë informacionit zyrtar të përditësuar në faqen ëeb të UV, mediat lokale të komunikimit, rrjetet sociale etj. Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se kjo strukturë sëbashku me Sektorin e Këshillimit dhe Karrierës, Alumnit koordinojnë punën për informimin e publikut të gjerë nëpërmjet organizmit të takimeve me maturanët e qarkut të Vlorës, pranë shkollave (kur kjo ishte e mundur) apo qendrave rinore, bashkëpunimit me Drejtorinë Arsimore Rajonale Vlorë, organizimit të Open Day në ambientet e UV etj. <i>[Referenca: RVB-Bachelor në Kontabilitet.pdf; 2.5_Procedurat e pranimin te studenteve te rinj.PDF; 3.8_Shkresa Nr. 2051 date 14.02.2018.PDF; 5.1_Vendimi Senati nr 19 date 19.04.2018.pdf; vizita në institucion]</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi V.2 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Duke ju referuar informacionit të paraqitur në RVB, të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion dhe të paraqitur në faqen zyrtare ëeb të UV, GVJ konkludon se në dispozicion të studentëve vihet informacion i plotë lidhur me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të tyre si dhe lidhur me procedurat e njohjes së kualifikimeve të mëparëshme në rast transferimi studimesh. Këto kritere dhe procedura janë pjesë e Rregullores së UV, e cila është e publikuar në faqen zyrtare ëeb të</p>

<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>institucionit.</p> <p>Procedurat e njohjes së kualifikimeve të mëparshme në rast transferimi studimesh përfshijnë vlerësimin e dosjes së studentit aplikant për transferim, nga ana e një komisioni ad-hoc me tre anëtarë që shqyrton dhe vlerëson dosjen për efekt ekuivalentimi të krediteve në përputhje me udhëzimet ligjore në fuqi.</p> <p>Studentët e programit të studimit “Bachelor në Kontabilitet” informohen në lidhje me programin e studimit, organizimin e vitit akademik dhe kuadrin rregullator përkatës që në momentin e regjistrimit pranë UV, si dhe më pas në mënyrë të vazhdueshme nga stafi akademik i Departamentit të Financës dhe Kontabilitetit, nga sekretaria mësimore e departamentit, nëpërmjet platformës UVMS si dhe nga strukturat e tjera ndihmëse të UV. <i>[Referenca: Evidenca A- Statuti i UV-së.pdf; Evidenca C-Rregullore UV-se e ndryshuar.pdf; 1.4_ Rregullore e programit te studimit Bachelor ne Kontabilitet.PDF; 2.1_Rregullore e Departamentit te Finances dhe Kontabilitetit.PDF; 2.6_Procedure transferimi dhe ekuivalentimit.PDF; https://univlora.edu.al/fakultetieconomise; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p> <p>Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Studentët informohen mbi kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive në programin e studimit nëpërmjet rregullores së programit të studimit, syllabuseve të lëndëve të publikuara në platformën UVMS dhe prezantimit të pedagogut përkatës në orën e parë të mësimit, si dhe nga sekretaria mësimore e departamentit.</p> <p>Në takimin me studentët e këtij programi studimi, GVJ konstatoi se studentët ishin të informuar lidhur me kriteret dhe procedurat e diplomimit të këtij programi studimi. Në përputhje me Rregulloren e UV dhe rregulloren e programit të studimit “Bachelor në Kontabilitet”, procedura e diplomimit varet nga nota mesatare e arritur nga studenti. Komisioni ad-hoc i ngritur nga përgjegjëse e departamentit bën fillimisht verifikimin e transkripteve bazuar në listën e studentëve të përgatitur nga sekretaria mësimore.</p> <p>Aktualisht ky program studimi parashikon që studentët me mesatare mbi 9 të përgatisin një punim diplome të udhëhequr nga pedagogu i propozuar prej studentit dhe i miratuar nga përgjegjëse e departamentit. Studentët e tjerë i nënshtrohen një provimi diplome bazuar në një bankë pyetjesh që përfshin testimin e njohurive të marra gjatë tre viteve të programit të studimit. Banka e pyetjeve përgatitet nga stafi akademik i Departamentit përgjegjës për programin e studimit pas miratimit nga Dekani i FE, u vihet në dispozicion studentëve jo më vonë se dy muaj para datës së parashikuar të provimit për diplomim. Shlyerja e detyrimeve të programit të studimit dhe çdo detyrimi financiar dhe tjetër ndaj UV, është kusht i domosdoshëm për të vijuar me procesin e diplomimit.</p> <p><i>[Referenca: 1.4_ Rregullore e programit te studimit Bachelor ne Kontabilitet.PDF; 2.1_Rregullore e Departamentit te Finances dhe Kontabilitetit.PDF; 3.23_Procedure Diplomimi.pdf; 5.3_Vendim Senati nr. 09 date 26.01.2017.PDF; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë</p>	<p>Duke ju referuar informacionit të paraqitur në RVB, të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion dhe të paraqitur në faqen zyrtare ëeb të UV,</p>

periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	GVJ konstaton se UV realizon aktivitete si “open day”, takime me institucione të tjera publike dhe private, merr pjesë në panairë pune, realizon publikime në median lokale, rrjetet sociale dhe shpërndan fletëpalosje për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi të gjitha programet e studimit. <i>[Referenca: RVB-Bachelor në Kontabilitet.pdf; 5.4_ Model Flete palosje.PDF; 5.9- Aktivitete me studentet. PDF; https://univlora.edu.al/aktivitete/; vizita në institucion]</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p> <p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion dhe nga faqja ëeb zyrtare e UV, GVJ konkludon se studentët e programit të studimit “Bachelor në Kontabilitet” informohen nga pedagogët përkatës, sekretaria mësimore e Departamentit të Financës dhe Kontabilitetit dhe Kordinatori për Marrëdhëniet me Studentët (personel akademik pranë grupit mësimor të Kontabilitetit) për të gjitha detajet që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe elementët ndihmës në funksion të këtij procesi.</p> <p>Gjithashtu në dispozicion të studentëve janë edhe materialet informuese si fletëpalosje dhe broshura të përgatitura mbi modulet, lëndët, etj të programit të studimit të përgatitura nga UV. Në faqen zyrtare web të UV gjendet dhe manuali i përdorimit nga studentët i hapësirës së dedikuar në platformën UVMS që mundëson dhe shfrytëzimin online të informacionit. <i>[Referenca: Evidenca A- Statuti i UV-së.pdf; Evidenca C- Rregullore UV-se e ndryshuar.pdf; 1.4_ Rregullore e programit te studimit Bachelor ne Kontabilitet.PDF; 3.20_Manual per perdorimin e struktures se teknologjise se informacionit_opt.pdf; https://uvms.univlora.edu.al/user/login; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>Nga takimi me përfaqësuesen e Sektorit të Këshillimit dhe Karrierës, Alumnit gjatë vizitës në institucion, rezultoi se kjo strukturë kujdesej kryesisht për informimin e studentëve mbi mundësitë e punësimit në fund të ciklit të studimeve. Struktura ishte relativisht e re në eksperiencë, e krijuar si e tillë në vitin 2018 pas riorganizimit të miratuar të strukturës organizative të UV. Ndërsa orientimi i studentëve të rinj lidhur me politikën, rregulloret dhe procedurat e studimit në UV, mundësitë për mbështetje financiare etj realizohet nga specialisti i shërbimit ndaj studentëve në Fakultetin e Ekonomisë, (pjesë e Sektorit të Kurrikulave dhe Shërbimit ndaj Studentëve) në bashkëpunim me këshilltarin akademik të departamentit përkatës. <i>[Referenca: 3.3_Vendim senati Nr 8 date 14.02.2018.pdf; 3.8_Shkresa Nr. 2051 date 14.02.2018.PDF; vizita në institucion]</i></p>

<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p> <p>Kriteri 5 Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>GVJ konstaton se sekretaria mësimore, pedagogët e departamentit të Financës dhe Kontabilitetit dhe në mënyrë më të dedikuar Koordinatori për Marrëdhëniet me Studentët i programit të studimit (njëkohësisht këshilltari akademik i studentëve), luajnë një rol të rëndësishëm në informimin dhe përditësimin e studentëve lidhur me zhvillimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të këtij programi studimi.</p> <p>Nëpërmjet faqes ëeb zyrtare të UV dhe hapësirës së dedikuar në platformën UVMS, studentët e këtij programi studimi mund të informohen edhe në distancë lidhur me strukturën e vitit akademik, orarin mësimor, mund të regjistrohen në leksione dhe seminare sipas programit të studimit, të konsultojnë vlerësimet sipas lëndëve që kanë frekuentuar, orarin e provimeve, etj, si dhe të informohen lidhur me infrastrukturën dhe aktivitete të tjera të organizuara në nivel universiteti. <i>[Referenca: Evidenca C- Rregullore UV-se e ndryshuar.pdf; 2.3_Kordinatori i Programit te Studimit.pdf; 3.20_Manual per perdorimin e struktures se teknologjise se informacionit_opt.pdf https://uvms.univlora.edu.al/user/login; vizita në institucion]</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi V.4 Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm</p>							
<p>Kriteret</p> <p>Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.</p> <p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p> <p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p> <p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se UV mban dhe disponon statistika mbi numrin e studentëve të regjistruar dhe diplomuar sipas programeve dhe cikleve të studimit. Sekretaria mësimore e Departamentit të Financës dhe Kontabilitetit mbledh, regjistron dhe përditëson të dhënat lidhur me studentët e regjistruar në këtë program studimi, për ecurinë mësimore të tyre gjatë ciklit të studimeve dhe diplomimin e tyre. Regjistrat në sekretari (themeltar, i arritjeve akademike dhe ai i lëshimit të diplomave) janë të formuar sipas standardeve shtetërore. Pranë sekretarisë depozitohen edhe dokumentacioni i përgatitur nga personeli akademik lidhur me frekuentimin e studentëve dhe procesverbalet e vlerësimeve sipas lëndëve.</p> <p>Gjatë vizitës në sekretari, GVJ verifikoi me zgjedhje dosjet personale dhe të ecurisë akademike të dy studentëve të programit të studimit “Bachelor në Kontabilitet) dhe konstatoi plotësinë e tyre.</p> <p>Të dhëna për regjistrimin e studentëve në këtë program studimi janë:</p> <table border="1" data-bbox="659 1939 1401 2033"> <thead> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>Te regjistruar</th> <th>Te diplomuar</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2016-2017</td> <td>46 studentë</td> <td>23 studentë</td> </tr> </tbody> </table>	Viti akademik	Te regjistruar	Te diplomuar	2016-2017	46 studentë	23 studentë
Viti akademik	Te regjistruar	Te diplomuar					
2016-2017	46 studentë	23 studentë					

		2017-2018	19 studentë	akoma	
		2018-2019	13 studentë	akoma	
		2019-2020	11 studentë	akoma	
	<p>Gjithashtu u verifikuan me zgjedhje regjistrat e sekretarisë për ciklin e studimeve 2016-2019 dhe rezultoi që: nga 46 studentë të regjistruar për herë të parë në këtë program studimi në vitin 2019 janë diplomuar 23 studentë. Shifrat e regjistrimeve në këtë program studimi gjatë harkut kohor 2016-2019 flasin për një rënie të rëndësishme të numrit të regjistrimeve, nga 46 studentë në vitin 2016 në vetëm 11 studentë në vitin 2019. Të gjithë studentët e regjistruar në këtë program studimi janë të regjistruar me numër matrikullimi. [Referenca: Evidenca A- Statuti i UV-së.pdf; Evidenca C- Rregullore UV-se e ndryshuar.pdf; vizita në institucion]</p>				
<p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>GVJ konstaton se ruajtja dhe menaxhimi i të dhënave statistikore të studentëve realizohet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe kërkesat e statutit dhe rregulloreve të UV. Pranë sekretarisë mësimore informacioni ruhet në formatin letër dhe në sistemin e menaxhimit informatik ruhet në versionin elektronik. Të dyja mënyrat e ruajtjes lehtësojnë kontrollin e të dhënave nga personat e autorizuar dhe japin siguri lidhur me respektimin e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale. [Referenca: Evidenca A- Statuti i UV-së.pdf; Evidenca C- Rregullore UV-se e ndryshuar.pdf; 3.20_Manual per perdorimin e struktures se teknologjise se informacionit_opt.pdf; vizita në institucion]</p>				
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Duke ju referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se institucioni nëpërmjet njësave bazë analizon profilin dhe cilësinë në hyrje të studentëve (nota mesatare), si dhe bën një statistikë të cilësisë (nota mesatare) dhe të kalueshmërisë (në %) sipas lëndëve dhe programeve të studimit (analizat vjetore të departamentit), por nuk ka raporte apo statistika mbi cilësinë në dalje të studentëve dhe punësimin e tyre.</p> <p>Gjithashtu, struktura që menaxhon kryesisht të dhënat statistikore të studentëve dhe ndjek përcjelljen e tyre tek njësitë bazë, strukturat e tjera të UV dhe institucione si MASR, INSTAT etj, rezulton të jetë Drejtoria e Edukimit për Ciklin e Parë dhe të Dytë. Kjo strukturë edhe pse e pajisur me një Specialist të Regjistrimit të Statistikave është riorganizuar në vitin 2018 dhe është ende në proces konsolidimi të aktivitetit.</p> <p>Duke ju referuar kësaj situate, GVJ gjykon se ka nevojë për një ndarje më të qartë të detyrave dhe përgjegjësisve në strukturat/njësitë e riorganizuar, si dhe ka nevojë për një harmonizim dhe strukturim më të përshtatshëm të raporteve periodike të përgatitura prej tyre. [Referenca: 2.12_Raporti vjetor 2018-2019 i Departamentit te Finances dhe Kontabilitetit.PDF; 3.3_Vendim senati Nr 8 date 14.02.2018.pdf; vizita në institucion]</p>				
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	
			<p>X</p>		

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, rezultojnë se UV ka mundur angazhimin e përfaqësuesve të studentëve në Senatën Akademik të UV, në Komisionet e Përhershme, në Këshillin e Etikës si dhe ngritjen e Këshillave Studentore në nivel Fakulteti dhe në nivele Universiteti, në përputhje me legjislativën në fuqi, statutin dhe rregulloren e UV. <i>[Referenca: Evidenca A-Statuti i UV-së.pdf; Evidenca C- Rregullore UV-se e ndryshuar.pdf; 3.9_Vendim Senatit, Nr. 54, Datë 13.10.2017.PDF; 3.10_Vendim Senati nr. 28 date 22.05.2018.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>GVJ konstaton se aktualisht UV përdor sistemin e pyetësorëve/ anketimeve me studentët për vlerësimin e procesit akademik dhe stafit pedagogjik sipas lëndëve, programeve dhe cikleve të studimit që ata ndjekin. Për të mundur përfshirjen e të gjithë studentëve në këtë proces pyetësori i miratuar nga Senati Akademik i UV, integrohet në platformën UVMS. Procesi i plotësimit të pyetësorëve monitorohet nga Sektori i Shërbimeve Teknologjike dhe Zhvillimit, me qëllim garantimin e sigurisë dhe plotësisë së procesit.</p> <p>Përpunimi i të dhënave vijohet nga Njësia e Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional dhe përfundon me hartimin e Raportit të Analizës dhe Vlerësimit të Pyetësorëve, i cili u komunikohet më pas të gjitha njësive bazë për një analizë aktive të rezultateve. <i>[Referenca: Evidenca K & L- Raport mbi rezultatet e pyetesorit studentor per vitin akademik 2017-2018, & 2018-2019.pdf; 3.6_Vendim Senati nr. 21 date 08.05.2018.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p> <p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Duke ju referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në UV, rezultojnë se në hartimin dhe ndryshimet e bëra në vite në programin e studimit “Bachelor në Kontabilitet” është mbajtur parasysh ngarkesa akademike e studentëve. Gjithashtu shpërndarja e krediteve dhe syllabuset e lëndëve janë të strukturuar në mënyrë të tillë që lehtësojnë procesin e transferimit të studentëve si nga jashtë UV ashtu dhe ndërmjet degëve brenda FE të UV.</p> <p>Rezultatet e pyetësorëve të organizuar nga Njësia e Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional, publikohen në faqen zyrtare të UV dhe janë objekt diskutimi në të gjitha strukturat e UV. Në takimin me stafin akademik të programit të studimit, GVJ konstatoi se rezultatet e detajuara të pyetësorëve diskutohen mbi bazë departamenti dhe bëhen pjesë e analizës vjetore dhe planit të masave për përmirësim që ndërmerr departamenti. <i>[Referenca: Evidenca I & J- Raporti vjetor i UV per vitin 2017-2018 & 2018-2019.pdf; 1.1_Plani strategjik_Departamentit te Finances dhe Kontabilitetit.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit</p>	<p>Rregullorja e UV dhe Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në Kontabilitet, parashikon të drejtën e ankimimit, për të gjithë studentët lidhur me procesin dhe rezultatin e kontrollit të dijeve, brenda 48 orëve nga marrja</p>

<p>të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>e rezultatit të provimit. Fillimisht ankesa i paraqitet me shkrim përgjegjëses së departamentit, e cila vijon me verifikimet. Në raste ekstreme ankesa kalon për verifikim pranë Dekanit cili brenda 48 orëve pasuese ngre një komision ad-hoc për verifikimin e pretendimeve të studentit dhe realizimin e vlerësimit përfundimtar. Ndryshimet, në rastet kur ka të tilla, reflektohen në një procesverbal të ri.</p> <p>Gjithashtu studentët mund të përdorin edhe platformën UVMS për të shprehur mendimin e tyre në pyetësorët përkatës lidhur me cilësinë e procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve. <i>[Referenca: Evidenca C-Rregullore UV-se e ndryshuar.pdf; 1.4_ Rregullore e programit të studimit Bachelor në Kontabilitet.PDF; 3.14_Vendim i Senati Nr. 94, date 13.10.2017.pdf; vizita në institucion]</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi V.6 Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p> <p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Në Statutin dhe rregulloret e UV dhe të programit të studimit përcaktohen procedurat dhe njësitë/strukturat e dedikuara në shërbim të studentëve si sekretaria mësimore e programit të studimit; koordinatori për marrëdhëniet me studentët; si dhe strukturat pranë Drejtorisë së Edukimit për Ciklin I dhe II.</p> <p>Sekretaria mësimore dhe Koordinatori për Marrëdhëniet me Studentët i programit të studimit, luajnë një rol të rëndësishëm në informimin dhe përditësimin e studentëve lidhur me zhvillimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të këtij programi studimi.</p> <p>Koordinatori për Marrëdhëniet me Studentët i programit të studimit është njëkohësisht këshilltari akademik i studentëve për problematikat e ndryshme që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit, si dhe bën raportimin e tyre në departamentin përkatës.</p> <p>Si rezultat i riorganizimit të vitit 2018 UV pranë Drejtorisë së Edukimit për Ciklin I dhe II janë në funksion të informimit dhe shërbimit të studentëve dy struktura të posaçme: Sektorin e Kurrikulave dhe Shërbimit ndaj Studentëve dhe Sektorin e Këshillimit të Karrierës, Alumni dhe të Aktiviteteve Kulturore dhe Sportive. Specialisti i shërbimit ndaj studentëve në Fakultetin e Ekonomisë, si pjesë e Sektorit të Kurrikulave dhe Shërbimit ndaj Studentëve shërben si referues për informimin dhe orientimin e studentëve lidhur me politikën, rregulloret dhe procedurat e studimit në UV, mundësitë për mbështetje financiare, shlyerjen e detyrimeve financiare etj.</p>

	<p>Specialistët e Sektorit të Këshillimit të Karrierës, Alumni dhe të Aktiviteteve Kulturore dhe Sportive, synojnë që nëpërmjet organizimit të aktiviteteve të ndryshme të nxisin jetën kulturore, artistike, sportive të studentëve gjatë viteve të studimit dhe të përgatisin sa më mire studentët vitit të fundit për tregun e punës.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca A- Statuti i UV-së.pdf; Evidenca C- Rregullore UV-se e ndryshuar.pdf; 1.4_ Rregullore e programit te studimit Bachelor ne Kontabilitet.PDF; 3.3_Vendim senati Nr 8 date 14.02.2018.pdf; 3.8_Shkresa Nr. 2051 date 14.02.2018.PDF; vizita në institucion]</i></p>
--	--

<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p> <p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>GVJ konstaton se shërbimi I këshillimit për studentët në UV ofrohet nga Sektori i Këshillimit të Karrierës, Alumni dhe të Aktiviteteve Kulturore dhe Sportive dhe në nivel program studimi nga Koordinatori për Marrëdhëniet me Studentët.</p> <p>Siç u përmend edhe më sipër ky koordinator është njëkohësisht këshilltari akademik i studentëve për problematikat e ndryshme që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit, si dhe bën raportimin e tyre në departamentin përkatës.</p> <p>Specialistët e Sektorit të Këshillimit të Karrierës, Alumni dhe të Aktiviteteve Kulturore dhe Sportive këshillojnë studentët për të gjitha hallkat e procesit mësimor synojnë përgatitjen e tyre për tregun e punës. Nëpërmjet organizimit të aktiviteteve të ndryshme si open day për karrierën, panairë pune, seminare për përgatitjen e CV/aplikimit për punë, përdorimin e rrjeteve sociale profesionale, etj, synohet të rritet pjesëmarrja aktive dhe të promovohen studentët, si dhe të rriten mundësitë e punësimit të tyre.</p> <p>Programi i studimit “Bachelor në Kontabilitet” nuk parashikon kryerjen e praktikave profesionale por nëpërmjet bashkëpunimeve të ndryshme me institucione publike dhe private, Sektori i Këshillimit të Karrierës, Alumni etj, synon edhe angazhimin profesional të studentëve gjatë muajve të verës. I krijuar rishtazi në vitin 2018, ky sektor ka një eksperiencë relativisht të kufizuar në mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave mbi punësimin e të diplomuarve të këtij programi studimi.</p> <p>Aktualisht në faqen zyrtare web të UV ndodhet një hapësirë e dedikuar Alumni që shërben për regjistrimin dhe publikimin e të diplomuarve në vite të UV. <i>[Referenca: Evidenca A- Statuti i UV-së.pdf; Evidenca C- Rregullore UV-se e ndryshuar.pdf; 3.8_Shkresa Nr. 2051 date 14.02.2018.PDF; https://univlora.edu.al/alumni/; vizita në institucion]</i></p>
---	--

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se në UV Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë realizohet kryesisht nga Njësia e Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional (NJSCVI) me 3 specialistë, pranë Drejtorisë së Sigurimit të Cilësisë dhe Zhvillimit Institucional (DSCIZHI). E krijuar në vitin 2016 sipas vendimit të Senatit Akademik të UV, struktura aktuale e NJSCVI është rezultat i riorganizimit të strukturës organizative të vitit 2018.</p> <p>Hartimi dhe zhvillimi i politikave për sigurimin e brendshëm të cilësisë është përgjegjësi kryesore e drejtuesit të DSCIZHI. Gjithashtu, rezulton se ky drejtues ka për detyrë edhe zhvillimin e një sistemi raportimi të UV, si dhe pjesëmartjen në rishikimin e kurrikulave dhe programeve aktuale të studimit dhe në vlerësimin e propozimeve për programet e reja. GVJ nuk konstatoi ndonjë politikë të posaçme të kësaj drejtorie përveç asaj lidhur me analizën e pyetësorëve të studentëve.</p> <p>Statuti i UV parashikon edhe ngritjen e Komisioneve të Përhershme të Sigurimit të Cilësisë në nivel universiteti dhe njësie kryesore. Gjatë takimit me përfaqësues të kësaj Drejtorie, GVJ konstatoi se këto komisione nuk janë plotësuar ende dhe se rregullorja e funksionimit të kësaj Drejtorie është në proces miratimi nga Senati Akademik. <i>[Referenca: Evidenca A- Statuti i UV-së.pdf; Evidenca C- Rregullore UV-se e ndryshuar.pdf; 3.2_Vendim senati Nr.84 dt. 12.12.2016.pdf; 3.3_Vendim senati Nr 8 date 14.02.2018.pdf; 3.8_Shkresa Nr. 2051 date 14.02.2018.PDF; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Njësia e Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional rezulton e krijuar rishtazi, pas riorganizimit të strukturës organizative të UV në vitin 2018. Funksionimi dhe organizimi i saj bazohet në statutin e UV dhe është ende në proces plotësimi i rregullores dhe i strategjisë përkatëse të aktivitetit. Aktualisht fokusi kryesor i punës është analiza dhe vlerësimi i pyetësorëve të studentëve për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi në UV. <i>[Referenca: 3.8_Shkresa Nr. 2051 date 14.02.2018.PDF; Evidenca K & L- Raport mbi rezultatet e pyetesorit studentor per vitin akademik 2017-2018 & 2018-2019.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>UV i është nënshtruar procesit të vlerësimit të jashtëm nga ekspertët e ASCAL për akreditimin institucional dhe ka marrë vlerësimin përfundimtar pozitiv, të shoqëruar me disa rekomandime, nga Bordi i Akreditimit. Në përgjigje të rekomandimeve, UV ka hartuar dhe miratuar nga strukturat përkatëse planin e masave për plotësimin e këtyre rekomandimeve. GVJ konstaton se me riorganizimin e vitit 2018 janë realizuar një pjesë e këtyre rekomandimeve, si dhe vlerëson angazhimin e të gjitha strukturave të UV për plotësimin e pjesës së mbetur. GVJ nuk konstatoi përdorime të vlerësimeve analitike krahasuese apo të instrumenteve të tjera në funksion</p>

	të plotësimit të këtij kriteri. Gjithashtu vlerëson se sistemi i raportimit aktual që përdor UV ka nevojë për një harmonizim dhe strukturim më të përshtatshëm për ta bërë atë më të lexueshëm. <i>[Referenca: 3.7_ Vendim i Senatit Nr. 29 Datë 22.05.2018.pdf; 6.1_Rvendimi i Bordit te Akreditimit.pdf; 6.3_Shkresa_Info ne funksion te akreditimit.pdf; vizita në institucion]</i>			
Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.	<p>Aktiviteti i Njësisë së Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional bazohet në planin vjetor të Drejtorisë përkatëse, me një sistem raportimi gjashtëmuor dhe kryesisht në formën e një raporti analize mbi rezultatet e pyetësorit të studentëve për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo program studimi në UV.</p> <p>Në takimet e zhvilluara gjatë vizitës në UV, GVJ konstatoi se NJSCVI nuk merret me rishikimin e kurrikulës së programit dhe syllabuseve përkatëse pasi gjykohej se ky proces i takonte një strukture tjetër – Sektorit të Kurrikulave dhe Shërbimit ndaj Studentëve (SKSHS). Ndërkohë që nga takimi me përfaqësues të zyrës SKSHS rezultoi se kjo zyrë merrej me grumbullim dhe katalogimin formal të syllabuseve sipas programeve dhe cikleve të studimit, por nuk merrej me rishikimin e cilësisë së tyre pasi gjykohej se kjo ishte e drejtë dhe përgjegjësi ekskluzive e departamentit përkatës.</p> <p>Duke ju referuar kësaj shtate, GVJ gjykon se ka nevojë për një ndarje më të qartë të detyrave dhe përgjegjësi në strukturat/njësitet e riorganizuar. Mungesa e eksperiencës në rastin e strukturave të krijuara rishtaz, si dhe mbështetja e aktivitetit kryesisht në analizën e rezultateve të pyetësorit të studentëve në gjykimin tonë vështirëson krijimin e një kulture cilësie në rang institucioni. <i>[Referenca: 3.11_Shkresa Nr 11711 Prot. date 02.11.2018.pdf; 3.8_Shkresa Nr. 2051 date 14.02.2018.PDF; vizita në institucion]</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxëniet.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se në UV parashikohet që monitorimi, shqyrtimi, mbikëqyrja dhe rishikimi i programeve të studimit të ciklit të parë të realizohet nga disa struktura:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Njësia e Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional; ▪ Drejtoria e Edukimit të Ciklit I dhe II; ▪ Komisionet e Sigurimit të Cilësisë në nivel Fakulteti; ▪ Zv/Dekani Akademik i Fakultetit përkatës.

	Aktualisht komisionet në nivel fakulteti ende nuk janë funksionale. <i>[Referenca: Evidenca A- Statuti i UV-së.pdf; Evidenca C- Rregullore UV-se e ndryshuar.pdf; 3.2_Vendim senati Nr.84 dt. 12.12.2016.pdf; 3.9_Vendim Senatit, Nr. 54, Datë 13.10.2017.PDF; 3.10_Vendim Senati nr. 28 date 22.05.2018.pdf; vizita në institucion]</i>			
<p>Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p> <p>Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Në takimet me stafin akademik të programit të studimit dhe drejtuesen e departamentit që administron këtë program studimi, GVJ konstaton se UV përdor procedura periodike dhe formale për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programeve të studimit në nivel departamenti mbi baza vjetore dhe semestrale.</p> <p>Çdo fillim viti akademik në departament miratohen syllabuset e lëndëve dhe reflektohen propozimet e pedagogë për ndryshime në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi. Në mbledhjet e departamentit në fund të çdo semestri mësimor analizohet ecuria dhe mbarëvajtja e programit të studimit.</p> <p>Në nivel universiteti, metodologjia kryesore që përdoret në UV për verifikimin e cilësisë së zhvillimit të programit mësimor, është analiza sasiore e rezultateve të pyetësorëve të studentëve. Format i pyetësorit miratohet nga Senati Akademik i UV dhe në versionin aktual përmban 14 pyetje me aternativa përgjigje dhe 2 pyetje të hapura mbi lëndët dhe pedagogët e përfshirë në procesin mësimor. <i>[Referenca: 2.12_Raporti vjetor 2018-2019 i Departamentit te Finances dhe Kontabilitetit.PDF; Evidenca K & L - Raport mbi rezultatet e pyetesorit studentor per vitin akademik 2017-2018 & 2018-2019.pdf; vizita në institucion]</i></p>			
<p>Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p> <p>Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.</p>	<p>Duke ju referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në UV, rezulton se të gjithë të interesuarit, në të gjitha nivelet, informohen lidhur me rezultatet e vlerësimeve me pyetësorë nëpërmjet raporteve të përgatitura nga Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit Institucional.</p> <p>Struktura e raportit aktual sqaron bazën ligjore dhe metodologjinë e raportit, evidenton gjetjet dhe problematikat më të rëndësishme dhe jep disa rekomandime për përmirësim dhe njësitë bazë vijnë me planin e masave në përgjigje të rekomandimeve. <i>[Referenca: 2.12_Raporti vjetor 2018-2019 i Departamentit te Finances dhe Kontabilitetit.PDF; Evidenca K & L - Raport mbi rezultatet e pyetesorit studentor per vitin akademik 2017-2018 & 2018-2019.pdf; vizita në institucion]</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.3	
Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në informacionin e

<p>periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p> <p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se në UV aktiviteti i Njësies së Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional (NJSCVI) bazohet në planin vjetor të Drejtorisë përkatëse, me një sistem raportimi gjashtëmuor dhe kryesisht në formën e një raporti analize mbi rezultatet e pyetësorit të studentëve për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi në UV.</p> <p>Aktualisht pyetësori është uniform për të gjitha programet e studimit që ofron UV dhe Njësia është duke shqyrtuar mundësinë e realizimit të pyetësorëve të dedikuar sipas fushave akademike dhe cikleve të studimit. Vlerësimet e NJSCVI janë pjesë e informacionit të paraqitur në dosjen e vetëvlerësimit të institucionit si dhe përdoren nga njësitë bazë dhe strukturat e tjera në analizat vjetore përkatëse.</p> <p>Siç u përmend edhe më parë, mbështetja e aktivitetit të vlerësimit të brendshëm kryesisht në analizën e rezultateve të pyetësorit të studentëve në gjykimin tonë jep një vlerësim jo të plotë dhe të pamjaftueshëm të ecurisë së programit të studimit dhe aspekteve të tjera të lidhura me të. <i>[Referenca: Evidenca K & L - Raport mbi rezultatet e pyetësorit studentor per vitin akademik 2017-2018 & 2018-2019.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstytucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Në takimet me stafin akademik të programit të studimit dhe drejtuesen e departamentit që administron këtë program studimi, GVJ konstatoi se UV përdor disa procedura periodike për vlerësimin e realizimit, të mbarëvajtjes dhe të cilësisë së programit të studimit në nivel departamenti të tilla si: vëzhgime të zhvillimit të mësimit në auditor, analiza e rezultateve të studentëve në fund të çdo semestri si dhe rishikime vjetore të syllabuseve.</p> <p>Është në proces përdorimi i formularëve për vlerësimin e performancës së personelit akademik dhe ndihmës me objektiv kryesor përmirësimin e metodave të matjes së cilësisë në institucion. <i>[Referenca: 2.12_Raporti vjetor 2018-2019 i Departamentit te Finances dhe Kontabilitetit.PDF; 3.4_Vendim Senati nr. 52 date 20.04.2017.PDF; 3.5_Vendim Senati nr. 53 date 20.04.2017.PDF; 5.8_Plani i masave mbi alanizën e pyetesoreve per vitin akademik 2018-2019.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky</p>	<p>Duke ju referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në UV, GVJ nuk konstatoi ndonjë përdorim sistematik të metodave apo intrumentave të tjerë të tërthortë për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit.</p> <p>GVJ gjykon se mospërdorimi i metodave dhe instrumentave të tjerë alternativë në vlerësim, nisur dhe nga mungesa e eksperiencës së strukturave të krijuara rishtaz, cënon cilësinë e procesit të vlerësimit.</p> <p>GVJ vlerëson se duhet të formalizohet dhe bëhet traditë eksperiencia e organizimeve të tilla si workshopi me temë “Studentët dhe tregu i punës” i vitit 2019, rezultat i bashkëpunimit të disa strukturave të UV, me përfaqësues të institucioneve publike dhe private, ekspertë dhe Alumni. <i>[Referenca: vizita në institucion]</i></p>

program.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.4
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p> <p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Duke ju referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në UV, GVJ konstaton se kuadri rregullator i UV (statuti & rregullorja e UV, vendimet e Senatit Akademik dhe dokumentat e politikave të miratuara) si dhe ndryshimet në strukturën organizative të vitit 2018 parashikojnë dhe garantojnë përfshirjen e të gjithë aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm në sigurimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit.</p> <p>GVJ vlerëson se nevojitet një ndarje më e qartë e detyrave dhe përgjegjësi për strukturat/njësitë e krijuara apo ristrukturuara pas riorganizimit të vitit 2018 – rasti i Sektorit të Kurrikulave dhe Shërbimit ndaj studentëve dhe i Njësisë së Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional (NJSCVI). Gjithashtu, GVJ gjykon se është e nevojshme që të harmonizohet dhe formalizohet më mirë raportimi mes strukturave/njësi të krijuara apo ristrukturuara. <i>[Referenca: Evidenca A- Statuti i UV-së.pdf; Evidenca C- Rregullore UV-se e ndryshuar.pdf; 3.3_Vendim senati Nr 8 date 14.02.2018.pdf; 3.8_Shkresa Nr. 2051 date 14.02.2018.PDF; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p> <p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Në takimet me stafin akademik të programit të studimit dhe drejtuesen e departamentit që administron këtë program studimi, GVJ konstatoi se UV garanton përfshirjen dhe aktivizimin e tyre në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë së programit të studimit duke respektuar integritetin akademik dhe duke shmangur çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit akademik, ndihmës dhe studentëve.</p> <p>Në mënyrë periodike njësia bazë përditësohet dhe kontribuon në procesin e vlerësimit të brendshëm me analiza, sugjerime dhe plane masash mbi raportimet e bëra nga NJSCVI. Në kodin e etikës së UV sanksionohen parimet e etikës akademike dhe publike të detyrueshme për të gjithë aktorët e brendshëm të UV. Përveç parashikimeve të përfshira në kuadrin rregullator të UV, që prej vitit 2017 funksion dhe një adresë elektronike e posaçme për adresimin e ankesave dhe shqetësimeve të studentëve dhe personelit akademik lidhur me standardet dhe etikën akademike, procesin e mësimdhënies etj. <i>[Referenca: Evidenca C- Rregullore UV-se e ndryshuar.pdf; Evidenca E- Kodi i Etikës.pdf; 2.12_Raporti vjetor 2018-2019 i Departamentit të Finances dhe Kontabilitetit.PDF; 3.14_Vendim i Senatit Nr. 94, date 13.10.2017.pdf; 5.8_Plani i masave mbi analizën e pyetësoreve për vitin akademik 2018-2019.pdf; vizita në institucion]</i></p>

<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Duke ju referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në UV, GVJ konstaton se pjesëmarrja e aktorëve të jashtëm në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë së programeve të studimit është sporadike.</p> <p>GVJ vlerëson se duhet të formalizohet dhe bëhet traditë eksperiencia e organizimeve të tilla si workshop-i me temë “Studentët dhe tregu i punës” i vitit 2019, rezultat i bashkëpunimit të disa strukturave të UV, me përfaqësues të institucioneve publike dhe private, ekspertë dhe Alumni.</p> <p>GVJ gjykon se integrimi i formalizuar i ekspertizës nga bashkëpunëtorët dhe ekspertët e jashtëm është i domosdoshëm për të rritur cilësinë e procesit të vlerësimit në mënyrë objektive,</p> <p><i>[Referenca: RVB-Bachelor në Kontabilitet.pdf; vizita në institucion]</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

Standardi VI.5
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë

<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p> <p>Kriteri 2. Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në UV, GVJ konstaton se kuadri rregullator i institucionit parashikon publikimin në faqen zyrtare ëeb të tij, të të gjitha veprimtarive përfshirë edhe ato për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë në nivel universiteti.</p> <p>Informacioni në nivel njësie bazë përcillet tek struktura përkatëse nëpërmjet shkresave zyrtare në pajtim me kuadrin rregullator të institucionit, ndërsa studentët informohen përmes komunikimeve në platformën UVMS.</p> <p>Gjatë kohës së vizitës së GVJ në UV, faqja zyrtare web ishte në funksionim të kufizuar për shkak të disa përditësimeve të rëndësishme në proces realizimi. GVJ konstaton se publikimet aktuale të UV në lidhje me rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, respektojnë lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. <i>[Referenca: 3.6_Vendim Senati nr. 21 date 08.05.2018.pdf; https://univlor.edu.al/politikat-e-privatesise/; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Duke ju referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në UV, GVJ konstatoi se në rastin e Raportit të përgatitur nga NJSCVI mbi analizën e pyetësorëve të studentët, ky raport shoqërohej me rekomandime për përmirësimin e cilësisë të cilat janë diskutuar më pas në nivel njësie bazë dhe njësie kryesore. Në nivel njësie bazë, rezultatet analizohen me stafin akademik dhe sugjerohen masa në përputhje me gjetjet. Në përfundim të diskutimeve në nivel njësie bazë dhe kryesore, si dhe bazuar në propozimet e bëra prej tyre, hartohet në nivel universiteti, plani i masave që miratohet nga Senati Akademik. <i>[Referenca:</i></p>

	<i>Evidenca K & L - Raport mbi rezultatet e pyetesorit studentor per vitin akademik 2017-2018 & 2018-2019.pdf; 5.8_Plani i masave mbi analizën e pyetesoreve per vitin akademik 2018-2019.pdf; 5.2_Vendim Senati nr. 17 date 28.03.2019.pdf; vizita në institucion]</i>			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	GVJ nuk konstatoi ndonjë sistem vlerësimi të posaçëm për matjen e efektivitetit dhe ndikimit të këtyre veprimtarive për përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit. GVJ gjykon se një sistem monitorimi i formalizuar dhe i strukturuar në mënyrë të përshtatshme do të garantojë efektivitetin e veprimtarive të realizuara në kuadër të përmirësimin të cilësisë të programit të studimit.			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Duke ju referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në UV, GVJ konstaton se veprimtaritë periodike me personelin dhe studentët në funksion të këtij kriteri lidhen me prezantime në auditore, publikime në faqen zyrtare web të UV dhe platformën UVMS, si dhe publikime në rrjetet sociale, me qëllim ndërgjegjësimin dhe përfshirjen aktive të tyre në sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. <i>[Referenca: RVB-Bachelor në Kontabilitet.pdf; vizita në institucion]</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Kontabilitet” të Institucionit të Arsimit të Lartë – Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë.

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Cilësia dhe përkushtimi i personelit akademik dhe ndihmës të institucionit.
2. Infrastruktura fizike dhe organizative e përshtatshme për një proces mësimor efektiv, krahasuar me numrin aktual të studentëve.
3. Imazhi ndërkombëtar i UV dhe ekspertiza e krijuar nga bashkëpunimet ndërkombëtare dhe multidisiplinare.

Pika të dobta:

1. Numri i vogël i studentëve të regjistruar në këtë program studimi dhe nota mesatare e ulët në hyrje.
2. Institucioni nuk ka kryer një studim të mirëfilltë tregu lokal apo rajonal për të përcaktuar nevojat specifike për specialistë të fushës së kontabilitetit.

3. Mungesa e analizave financiare sipas programeve të studimit dhe mos përcaktimi i qartë i kostos për student as në nivel institucioni.
4. Ndarja jo e qartë e detyrave dhe përgjegjësiwe mes strukturave/njësive të krijuara rishtazi në 2018 dhe raportim jo fort i formalizuar dhe harmonizuar mes strukturave/ njësive.
5. Kurrikula e programit të studimit nuk ofron praktikë mësimore të detyrueshme, edhe pse kosto e realizimit të saj kundrejt numrit aktual të studentëve nuk do të ishte e rëndësishme për UV.
6. Mungon përdorimi i metodave dhe instrumentave të tjerë alternativë në vlerësim (përveç pyetësorit të studentëve) si dhe angazhimi i bashkëpunëtorëve dhe ekspertëve të jashtëm në procesin e vlerësimit është sporadik.

Rekomandime:

1. Të krijohet një program i përbashkët bachelor Financë & Kontabilitet me mundësi specializimi në dy profile në vitin e tretë, në linjë me praktikën më të mira ndërkombëtare të programeve bachelor të studimit dhe me trendin *de facto* në rënie të numrit të studentëve.
2. Të përfshihet lënda “Auditim” me zgjedhje për profilin “Kontabilitet” dhe praktika mësimore e detyrueshme për programin e studimit, me qëllim plotësimin e spektrit të objektivave të vendosur në programin e studimit.
3. Të ndërmerret sa më shpejt një studim tregu për kërkesat për programe studimi në nivel zone gjeografike (rajoni), në përgjigje dhe të ndryshimeve demografike të ndodhura në vitet e fundit.
4. Të bëhen analiza financiare më të plota me bazë programi dhe njësi kryesore ku të evidentohet qartë kosto mesatare për student.
5. Të qartësohen detyrat dhe ndarja e përgjegjesive mes strukturave/njësive ndihmëse të krijuara rishtazi në vitin 2018, si dhe të harmonizohet dhe formalizohet më mirë raportimi mes tyre.
6. Të përfshihen në planet e punës të strukturave/njësive ndihmëse përkatëse, si dhe të realizohen, në mënyrë të rregullt aktivitete me aktorët e jashtëm për përmirësimin e vazhdueshëm të kurrikulës dhe syllabuseve të programeve mësimore.
7. Të unifikohen formatet e syllabuseve të programit të studimit dhe të përditësohen me vitin e botimit të literaturës bazë dhe ndihmëse.

Conclusions of the Evaluation of the study program of the first cycle, Bachelor in “Accounting” at the HEI “Ismail Qemali” University, Vloira.

Strengths and affirmations:

1. The quality and the commitment of the academic and support staff engaged at the study program “Bachelor in Accounting”.
2. The adequate infrastructure and facilities for effective teaching and learning, given the current number of students.
3. The international image of the institution and the expertise created by international and multidisciplinary cooperations.

Weak points:

1. The small number of students enrolled in this study program and the quality of incoming students.
2. The institution has not conducted a proper market research (local or regional) to determine the real demand for accounting specialists.
3. Lack of financial analysis according to study programs and unclear definition of cost per student even at the institutional level.
4. Unclear division of tasks and responsibilities between newly established structures / units (in 2018) and poorly formalized and harmonized reporting between these structures / units.
5. The curriculum of the study program does not offer compulsory teaching practice, although the cost of its implementation against the current number of students would not be important for UV.
6. There is a lack of use of alternative methods and instruments in the assessment process (with the exception of the student questionnaire), while the engagement of external collaborators and experts in the assessment process is sporadic.

Recommendations:

1. To create a joint "Finance & Accounting" bachelor program with specialization opportunities in two profiles in the third year, in line with the best international practices in this field and in response to the *de facto* downward trend in the number of students.
2. To include the "Audit" course as part of elective curriculum for the "Accounting" profile and the compulsory teaching practice, in order to achieve the spectrum of objectives set in the study program.
3. As soon as possible to conduct a market research for the demand about study programs at the geographical area (region) level, in response to the demographic changes that have occurred in recent years.
4. Conduct a more complete financial analysis according to the study programs, to main units of UV and with clear evidence of the cost per student.
5. Clarify the division of tasks and responsibilities between newly established structures / units (in 2018) and improve the reporting practice between these structures / units.
6. To be included in the work plans of the respective structures / auxiliary units, as well as to carry out, on a regular basis, activities with external actors for the continuous improvement of the curriculum of the study program.
7. Unify the syllabus formats of study program and update them with the year of publication of the basic and auxiliary literature.

Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT			X	
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE			X	
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE			X	
VLERËSIMI TËRËSOR			X	